

Mr. Rejhan Neziri

**ISLAMI DHE MUSLIMANËT
NË PERËNDIM / ZVICËR /
(Përmbledhje artikujsh)**

Kreuzlingen, 2004

Editor:
mr. Rejhan Neziri

Nga anglishtja:
mr. Rejhan Neziri

Nga gjermanishtja:
Xhelal Qazimi

Boton:
Bashkësia Islame Shqiptare "Hëna e Re"
Kirchstrasse 5 f, 8280 Kreuzlingen
Zvicër

Tel. & fax: 0041 71 672 38 98

Shtypi:
X STUDIO d.o.o.e.l. Tetovë

HYRJE

Ç'është Evropa? Është ajo një entitet gjeografik, një përzierje e kulturës judo-krishtere apo prodhim i një feje sekulare? Ç'është identiteti i Evropës? Kush janë muslimanët e Evropës? Ç'identitet kanë ata? Ç'është dhe a mund të flitet për një "Islam evropian"?

Rëndësia e ndikimit dhe kontributit të Krishterizmit mbi kulturën e asaj që sot quhet Evropë, është e pamohueshme. Edhe Islami ka qenë një realitet i Evropës mbi 1000 vjet. Të trija traditat e besimit monoteist, të Judaizmit, të Krishterizmit dhe të Islamit, janë të huaja për sa i përket Evropës. Të trija këto fe burimin e kanë në Lindjen e Mesme dhe prapëseprapë kanë patur një ndikim të thellë mbi kulturën evropiane. Për shumë vite të tëra, Krishterizmi me përzierjen e tij ekzotike të traditës hebreje dhe me pretendimin e tij për të qenë universal, ka qenë feja e një pakice të margjinalizuar. Shën Pali kishte bindjen se johebrenjtë mund të bëheshin të krishterë pa mos qenë e nevojshme që një herë të bëheshin hebrej, duke iu nënshtruar ritit të rrethprerjes (synetimit). Në fillim kjo bindje nuk gjeti përkrahjen edhe të liderëve të hershëm të krishterë, mirëpo më vonë kjo u pranua si një dogmë qendrore. Kjo i ndihmoi Krishterizmit të zhvillohej në një fe botërore. Përhapja e Krishterizmit gjithashtu u ndihmua edhe nga situata politike dhe kulturore e kohës.¹ Perandoria romake, me Pax Romanën e saj, ishte një botë stabile ku dominonte gjuha dhe kultura greke. Krishterizmi u bë fe shtetërore e Perandorisë romake me konstituimin e Perandorisë bizantine. Përkundër lidhjeve të ngushta me Hebraizmin, Krishterizmi është zhvilluar në mënyrë të pavarur brenda botës greko-romake. Të krishterët, hebrenjtë i shohin si të ndryshëm por që kanë lidhje të ngushtë me ta, sepse ata i luten të njëjtit Zot, të cilin ata e quajnë "Zot dhe At i Jezu Krishtit", që është, sipas besimit krishter, i njëjti me "Zotin e Abrahamit, Isaacut dhe Jacobit" të hebrenjve.

Kur'ani shpesh e thekson faktin se mesazhi thelbësor i tij nuk është diçka e re dhe se marrëdhëniet e muslimanëve me *ehli-kitabët* (ndjekësit e shpalljeve më të hershme), në esencë janë të njëjta. Islami është e njëjta fe nga i njëjti Zot, Krijues i Ademit dhe Zot i Abrahamit, Isaacut dhe Jacobit. "*Thuaj: Ne i kemi besuar All-llahut, edhe asaj që na u zbrit neve, edhe asaj që i është zbritur Ibrahimit, Ismailit, Is-hakut, Jakubit dhe pasardhësve. Edhe asaj që i është dhënë Musait dhe Isait, edhe asaj që i është zbritur të gjithë peygamberëve nga Zoti i tyre. Ne nuk bëjmë kurrfarë dallimi në mes tyre dhe ne vetëm Atij i jemi dorëzuar*" (Alu Imran: 84). Muslimanët, si burrat ashtu edhe gratë, e ndajnë të njëjtën detyrë jetësore: ta njohin Zotin, t'i shërbejnë Zotit dhe t'i plotësojnë urdhrat e Zotit. Gjithë kjo do të ndihmojë në sigurimin e barazisë, lirisë, drejtësisë, mëshirës dhe prosperitetit në tokë.

Prezenca e muslimanëve ka qenë një faktor konstant në historinë evropiane qysh nga shek. VII e.r., pas paraqitjes së Islamit. Muslimanët kanë qenë tregtarë, ndaj edhe *da'ij* (misionarë) anëmbanë botës. Brenda disa dekadave nga vdekja e Muhammedit a.s. (632), ndjekësit e tij i tejkaluan kufijtë e Arabisë dhe u futën në Persi dhe Bizant, që ishin dy perandori të cilat e kishin ndarë më dysh Lindjen e Mesme dhe të cilat kishin futur nën kontrollin e tyre hapësira e territore të gjera. Në Evropë, muslimanët vijnë përmes Spanjës (711 e.r. / 94 h.) dhe Sicilisë (831 e.r. / 215 h.) dhe më vonë përmes Ballkanit (shek. XI e

¹ Për më tepër hollësi shih Karl Blei, *Freedom of Religion and Belief: Europe's Storey*, Holandë, 2002.

këtej).² Qysh atëherë bashkësitë muslimane kanë jetuar në pjesë të ndryshme të Evropës. Kanë kaluar periudha të gjata të sundimit musliman në Spanjë (Andaluzi), Sicili dhe Ballkan, si dhe qendra të veçara autonome të muslimanëve në Francë, Zvicër, Gjermani dhe Italinë Jugore.

Menjëherë pas rënies së Murit të Berlinit, Evropa kishte një popullatë të dukshme muslimane. Me shekuj të tërë muslimanë kishte në Evropën Lindore, që s'ishte njësoj edhe në Evropën Perëndimore, ku numri më i madh i imigrantëve arriti në vitet '60 dhe '70 e këndej. Sipas statistikave të fundit, Franca ka afro 5 milionë muslimanë, gjysma prej të cilëve qytetarë francezë. Ata që nuk kanë nënshtetësi franceze, kryesisht vijnë nga Algjeria, Maroku dhe Tunizia. Në Gjermani ka 4 milionë muslimanë, prej të cilëve 3 milionë vetëm turq. Belgjika dhe Holanda kanë nga 1 milion muslimanë. Britania e Madhe llogarit që numri i popullatës muslimane atje të jetë afro 2 milionë, të cilët kryesisht vijnë nga Pakistani, India, Bangladeshi dhe Lindja e Afërt. 65 % e tyre kanë nënshtetësi britaneze. Në vitin 1987 Spanja ka patur 150 mijë marokenë plus shumë të huaj të tjerë. Në vitin 1999 numri i tyre është rritur në 250 mijë, shumica prej të cilëve kanë hyrë fshehurazi. Statistikat më të vonshme të Italisë numërojnë gjithsejt 522 mijë imigrantë. Prej tyre 130 mijë nga Maroku, 59 mijë nga Shqipëria, 48 mijë nga Tunizia, 33 mijë nga Senegali, 25 mijë nga Egjipti etj. Statistikat që kanë të bëjnë me numrin e muslimanëve prezentë në Itali, nuk i përfshijnë imigrantët ilegalë që vijnë nga Afrika Veriore, të huajt e natyralizuar dhe italianët vendorë të konvertuar në Islam. Vendet si Bullgaria, Hungaria dhe ish Jugosllavia kanë patur bashkësi muslimane që nga rënia e tyre nën sundimin e Perandorisë Osmane.³

Viteve të kaluara ka patur një fluks të tërë refugjatësh dhe azilkërkuesish, të cilët i braktisnin vendet e tyre për shkak të mosrespektimit të të drejtave njerëzore ose për shkak të situatës ekonomike e cila i ka shtyrë banorët e atyre vendeve të kërkojnë një ardhmëri të re në Evropë.⁴ Pa këtë fluks mërgimtarësh, Islami do të kishte mbetur disi i marginalizuar në Evropë. Mëgjithëkëtë, tani prania e Islamit nuk mund të injorohet, ngase ai dita-ditës bëhet faktor i rëndësishëm shoqëror dhe fetar anekënd Evropës. Shoqëria evropiane përnjëmend është bërë multifetare, diçka që më parë as që është parë e as që është dëshiruar të jetë. Ç'është arsyeja që i shtyri gjithë këta muslimanë të mbërrijnë në Evropë? Ka të ngjarë që gjithë kjo ka të bëjë me procesin e migrimit – njerëzit e lëshojnë një pjesë të botës dhe shkojnë e vendosen të jetojnë në një pjesë tjetër të saj, ashtu siç ka ngjarë gjatë gjithë historisë.

Dekadave të fundit Islami ka mbërritur në shumë pjesë të Evropës me anë të njerëzve të cilët, me kalimin e disa viteve, vijnë të jetojnë, të punojnë dhe të gjejnë strehë në këto vende për arsye të nduarnduarta. Kjo më parë ka qenë një mbërritje graduale dhe e vazhdueshme, sesa një vërshim i përnjëhershëm. Gjithashtu, duhet mbajtur mend faktin se gjithë procesi i derdhjes së Islamit në Evropë sot mbështetet nga procesi i bashkëpërfshirjes progresive dhe reciproke ndërmjet popullatës muslimane dhe asaj me prejardhje krishtere. Numri i njerëzve që vijnë në Evropë, sot me të madhe varet nga ecuria e ekonomisë së saj. Kur gjërat janë në rregull, atëherë mbërrijnë shumë imigrantë; kur shfaqen probleme të natyrës ekonomike dhe politike, atëherë dukshëm bie edhe numri i imigrantëve.

Pas Luftës II Botërore, Evropa ka patur nevojë për krah pune të lirë për ta ngritur ekonominë e saj, për çka pasojnë disa valë migrantësh: vala e parë ka qenë gjatë periudhës së

² Për detaje të mëtejshme shih raportin e përkohshëm të Khurshid Ahmedit, *Muslims in Europe*, të paraqitur në The Islamic Council of Europe, prill, 1976, të botuar nga The Islamic Foundation, Leicester, UK.

³ Konferenca Botërore mbi Fetë (World Conference on Religions) ka përgatitur një hartë për European Religious Population for Peace-Europe (WCRP EU) në lidhje me Këshillin e Liderëve Fetarë të WCRP EU në dhjetor, 2002. Shih: www.religionsforpeace.org.

⁴ Shih Qadir Bukash, *The Bubble of Refugee Protection*, Londër, 2002, f. 12. (Sipas tij, prej gjithsejt 22 milionë refugjatësh 7 milionë janë vetëm në Evropën Perëndimore).

rindërtimit menjëherë pas luftës, vala e dytë ka qenë gjatë shpërthimit ekonomik në vitet '60, e treta ka qenë në vitet '70, sidomos pas krizës ekonomike të shkaktuar nga rritja e çmimit të naftës në vitin 1973, dhe vala e katërt e viteve '80, kur kemi një rritje definitive të numrit të imigrantëve që kërkonin strehim politik ose që mbërrinin nëpër rrugë ilegale për arsye të ndryshme. Gjatë gjithë kësaj kohe është bërë shumë punë për përcaktimin e rëndësisë relative të pranisë së muslimanëve këtu, për të mësuar saktësisht prejardhjen e tyre, për të vlerësuar menaxhimin pak a shumë të suksesshëm me rastin e vendosjes së tyre në një mjedis të ri, për t'i vlerësuar organizatat e tyre kombëtare, regjionale apo ndërkombëtare si dhe kërkesat e tyre kulturore e fetare. Pas një periudhe vihet re se njerëzit tanimë vinin këndeje jo vetëm për të kërkuar punë, por ngase donin të ribashkoheshin me familjet e tyre, të cilat tanimë gjendeshin në Evropë. Pas kësaj, ata formuan shoqëritë e tyre brenda shoqërive lokale tanimë ekzistuese – me rrezikun konsekuent për getoizim. Në shumë vende evropiane, tanimë mund të flasim për gjeneratën e tretë e të katërt të fëmijëve të mërgimtarëve.

Një temë tjetër për çka flitet vite të tëra këndeje, është ajo që quhet "Islami evropian". Kjo përflitet sidomos ndër gjeneratën më të re, më të edukuar e arsimuar, e cila gjatë kohë nuk ka patur lidhje direkte me vendin nga kanë ardhur prindërit e tyre. Ata mendojnë se ligji është ai që duhet të jetë referencë dhe kriter, ndaj dhe një analizë më e përafërt do të tregojë se në shumicën e vendeve evropiane, kushtetutat në fuqi, pavarësisht prej interpretimeve joadekuate e ndoshta edhe tendencioze të bëra nga zbatues të kushtetutave, u lejojnë muslimanëve që në masë të madhe të jetojnë në përputhshmëri me identitetin e tyre. Nga njëra anë, muslimanët duhet të insistojnë në zbatimin e drejtë e të saktë të ligjit ndaj të gjithë qytetarëve e të gjitha feve. Në anën tjetër, ata duhet të ballafaqohen me përgjegjësitë e tyre dhe, brenda kornizës së gjerë të lirisë që e gëzojnë në Evropë, t'u ofrojnë bashkësive muslimane kurse, qarqe dhe të gjitha llojet e tjera të institucioneve dhe organizatave të cilat për qëllim parësor kanë ruajtjen e fesë dhe spiritualitetit islam, përhapjen e kuptimit më të mirë të mësimave islame dhe të rrethanave ku jetojnë, të mësohet e bartet porosia e Islamit dhe përfundimisht muslimanët përnjëmend të kyçen në shoqëri. Ata nuk i pengon asgjë të mos e bëjnë këtë.

Kjo në të njëjtën kohë nënkupton edhe zhvillimin e një qëndrimi të ri e të vetëbesueshëm të bazuar në vetëdijen e qartë mbi dimensionet thelbësore të identitetit islam.

Kjo ndjenjë muslimanët duhet t'i çojë drejt një vlerësimi objektiv dhe të drejtë të mjedisit ku jetojnë. Të vetëdijshëm për porositë e fesë së tyre, muslimanët nuk duhet ta shpërfillin masën e rëndësishme të përshtatjes a akomodimit, që është një veçori e dalluar e Islamit. Kjo është ajo që ua ka mundësuar muslimanëve të vendosen në Lindjen e Mesme, në Afrikë e në Azi, dhe në emër të Islamit të njëjtë e të vetëm, zbatimit të tij t'i japin një trajtë dhe dimension specifik...Të përsërisim, nga aspekti i formës së zbatimit, duhet të ketë një Islam evropian, mu ashtu siç ekziston Islami afrikan apo ai aziatik. Të përshtatesh, nga pikëvështrimi islam dhe për sa i përket gjeneratave të reja të muslimanëve, nuk do të thotë të heqësh dorë, por të ndërtohet. Ata duhet t'i shfrytëzojnë përparësitë e metodave më efikase (në arsim, në organizim të punës etj.) si dhe të zbulimeve shkencore e teknologjike (që për nga natyra nuk janë në kundërshtim me mësimet islame) me qëllim që, të pajisur me mjetet e nevojshme, të ballafaqohen me mjedisin ku jetojnë. Këto të arritura i takojnë mbarë trashëgimisë njerëzore dhe janë pjesë e shoqërive perëndimore, ndaj edhe muslimanët, sidomos ata që jetojnë në Perëndim, nuk mund t'i shpërfillin këto dhe thjeshtë t'i hedhin si joislame. Mësimi islam është i qartë: nga aspekti i punëve shoqërore (*mu'amelat*) të gjitha mjetet, traditat, mjeshtritë dhe zakonet të cilat, vetvetiu ose për nga aspekti i përdorimit të tyre, nuk bëjnë ndesh me rregullat e Islamit, jo vetëm që janë të pranueshme, por edhe për nga vetë definicioni janë islame. Prandaj, në kuadër të mjedisit evropian, muslimanët duhet të bëjnë zgjedhjen në përputhje me

identitetin e tyre. Në këtë mënyrë, ata do ta zhvillojnë dhe formësojnë tabllonë e identitetit të tyre të tanishëm e të ardhshëm evropian.⁵

Janë, pra, këto disa nga pyetjet që na përfytyrohen në kujtesën tonë, lidhur me treshin e termave: Perëndimi-Evropa, Islami dhe muslimanët. I nxitur nga kureshtja për të mësuar diçka më tepër lidhur me praninë e Islamit dhe të muslimanëve në Evropë në përgjithësi dhe në Zvicër në veçanti; për t'i gjurmuar problemet dhe vështirësitë me të cilat ndeshen këta muslimanë dhe alternativat që ofrohen për zgjidhjen a zbutjen e tyre; për ta kuptuar qëndrimin e vendorëve ndaj këtij elementi paksa më të ri krahasuar me të tjerët; për t'i hulumtuar mundësitë e një afrimi dhe bashkëjetese të bijve të Ibrahimit a. s. apo të pjesëtarëve të feve ibrahimiane, sidomos tani në kohën kur Islami dhe muslimanët janë në fokus të vëmendjes së perëndimorëve, në qendër të vlerësimeve sa pozitive e objektive po aq edhe negative e subjektive, madje edhe tendencioze si të individëve, grupeve apo shoqërive të tëra, e pash të rrugës që të bëj përmbledhjen e disa artikujve që do t'u përgjigjeshin deri diku këtyre pyetjeve që nuk më lenin të qetë, pyetjeve që gjithsesi dikush duhej dhënë përgjigje. Kam zgjedhur artikuj të dijetarëve e mendimtarëve muslimanë e jomuslimanë për të qenë më objektiv në të kuptuarit e këtyre problemeve, duke kujtuar se të gjitha këto tema të përmbledhura këtu do të përbëjnë një sintezë të mjaftueshme për momentin. Gjithsesi, nuk pretendoj që me anë të këtij edicioni ta kem thënë fjalën përfundimtare lidhur me Islamimin dhe muslimanët në Perëndim. Për më tepër lexuesin shqiptar do ta kisha porositur t'u kthehet e t'i lexojë burimisht veprat në vijim: Tariq Ramadan, *To Be A European Muslim*; po ai, *Western Muslims and the Future of Islam*, Hišam Džait, *Evropa i Islam*; Sigrid Hunke, *Allahs Sonne über dem Abendland-Unser Arabischen Erbe*, Syed Abul Hasan Ali Nadwi, *Muslims in the West-The Message and Mission*; Ekmeluddin İhsanoğlu, *Zapad i Islam ka dijalogu*; Murad Wilfried Hofmann, *Islam 2000* etj.

Më në fund, për mundësinë e daljes në dritë të këtij edicioni, para së gjithash e ndjej veten të detyruar t'i falënderoj vetë autorët e këtyre temave e artikujve, të cilët, kush gojarisht e kush me shkrim, më dhanë leje për përfshirjen dhe botimin e artikujve të tyre në këtë përmbledhje. Në veçanti do t'i falënderoja z. Hamit Duran, z. Francis Piccand dhe znj. Amira Hafner al-Jabaji, të cilët me shkrim shprehën gatishmërinë për t'i botuar temat e tyre dhe të cilët më kanë ofruar disa sugjerime të tyre të çmueshme në këtë drejtim.

Së dyti përzemërsisht falënderoj shokun tim të palodhur prof. Xhelal Qazimin, i cili nuk kurseu kohë e mund për të m'i përkthyer nga gjuha gjermane në një shqipe të kulluar temën e z. Hamit Duran dhe komunikatën e Entit Federal për Statistikë.

Së treti falënderoj Bashkësinë Islame Shqiptare "Hëna e Re" në Kreuzlingen, e cila e mori përsipër botimin e këtij edicioni, pa të cilën ky botim do të ishte vonuar tej mase.

mr. Rejhan Neziri
Imam në Kreuzlingen
korrik, 2004

⁵ Tariq Ramadan, *To Be A European Muslim*, bot. The Islamic Foundation, Leicester, 1999, f. 197-198.

PËRMBAJTJA:

Hyrje	iii
Përmbajtja	vii
KAPITULLI I	
ISLAMI DHE MUSLIMANËT NË PERËNDIM	1
Tariq Ramadan	
Imigrimi, integrimi dhe politika e bashkëpunimit	2
M.A.Bari	
Muslimanët në Perëndim: ndërmjet getoizimit dhe asimilimit	6
Akbar S. Ahmed	
Muslimanët në Perëndim	10
Tariq Ramadan.	
Hyrje në "Tendencat islame" në Evropë dhe në botë	16
KAPITULLI II	
ISLAMI DHE MUSLIMANËT NË ZVICËR	23
Hamit Duran	
Muslimanët në Zvicër	24
Francis Piccand	
Islami në Zvicër: dialogu midis kulturave	30
Amira Hafner al-Jabaji	
Fillimet e një dialogu të vështirë	35
Francis Piccand & Amira Hafner al-Jabaji	
Islami në Zvicër: Diskutimi	39
Enti Federal për Statistikë i Zvicrës	
Peizazhi fetar në Zvicër, në thyerje	46
Rreth disa autorëve	55

KAPITULLI I

ISLAMI DHE MUSLIMANËT NË PERËNDIM

IMIGRIMI, INTEGRIMI DHE POLITIKA E BASHKËPUNIMIT*

- Muslimanët e Evropës i gjejnë vend vetvetes -

Përmbledhje

Imigrantët janë të mirëseardhur kur nevojitet puna e tyre, mirëpo refuzohen sapo të ndjehen pasojat e ndonjë krize ekonomike. Qoftë në Evropë (siç tregon rritja dhe zhvillimi i Frontit Nacional në Francë), qoftë në Azinë Juglindore (shih artikullin e Solomon Kane dhe Laurent Passicoussset), ata shpejtë bëhen kuaj të belarave. Megjithëkëtë, ka shenja se jemi në rrugën drejt një integrimi të vërtetë të muslimanëve që jetojnë në Evropë. Për të qenë të sigurt në suksesin, duhet që qeveritë evropiane me vetëdije të plotë t'i hedhin poshtë parullat e së djathtës ekstreme, kurse populli t'i braktisë shikimet thjeshtëzuese ndaj Islamit.

Në Evropën e mesjetës, Islami i ka dhënë një kontribut të madh racionalizmit, sekularizmit dhe modernizmit të mendimit perëndimor. Megjithëkëtë, prania e tanishme e Islamit në Evropë është një dukuri e vonshme, që daton qysh para 60 apo 70 vitesh. Shikuar nga aspekti historik, kjo prani është shumë e vonshme. Minoriteteve të tjera nacionale dhe fetare (si çifutëve dhe të krishterëve ortodoksë, t'i përmendim vetëm dy grupe) u janë dashur shekuj të tërë diskutimi dhe konflikti para se t'i gjenin vend vetvetes dhe para se t'i fitonin të drejtat e tyre në vendet e porsazbuluara. A është e arsyeshme të pritet që problemet e muslimanëve të zgjidhen brenda kohës së një a dy gjeneratave? Për më tepër, valët e para të migrantëve muslimanë kanë qenë punëtorët nga Afrika Veriore, Turqia, India dhe Pakistani, të cilët përgjithësisht kanë qenë të varfër, të shtyrë në mërgim për shkaqe e nevoja ekonomike. Niveli i edukimit dhe pasiguria e statusit të tyre e kanë bërë të pamundur që ata të mendojnë në kontekst të një Islami evropian. Ka qenë arritja e gjeneratës së dytë e të tretë ajo që e ka ndryshuar mënyrën në të cilën këta mërgimtarë e kanë parë praninë e tyre në vendet pranuese. Kjo u bë e qartë në Francë, edhe pse në Britani mërgimtarët kanë treguar prirje për të mbetur brenda bashkësive të tyre, duke riprodhuar disa nga strukturat shoqërore të vendeve dhe regjioneve nga kishin ardhur. Faktori i tretë ka qenë ndikimi i ngjarjeve ndërkombëtare. Duke filluar me revolucionin iranian të vitit 1979, këto ngjarje kanë patur një efekt marramendës në formën siç e kanë parë e kuptuar njerëzit Islamit në Evropë, çka ka shkaktuar perceptime dhe përfytyrime negative që janë përhapur pastaj gjithandej. Që nga afera Salman Rushdi e deri te teprimi i talibanëve, që nga dhuna e vrasjet në Lindjen e Mesme e deri te tmerret e përditshme në Algjeri, të gjitha këto kanë prodhuar një atmosferë frike e lemerie. Kjo është theksuar edhe më tej në kontekstin e krizave sociale që e përshkojnë Evropën si rezultat i papunësisë, margjinalizimit dhe dhunës urbane. Kjo është ajo çka e bën kaq të vështirë – disa do të thonin të pamundur – diskutimin mbi praninë e Islamit në Evropë. Sidomos atëherë kur, nën presionin e krizave, kjo ngatërrohet me problemin e imigrimit. Vërtet mund të flitet për një lloj "Islamofobie", siç shihet në titullin e një studimi mjaft të rëndësishëm, të autorizuar nga Runnymede Trust në Britani më 1997.⁶ Imazhi i muslimanëve është djallëzuar, çka e pengon zhvillimin serioz të dinamikave që ndikojnë në bashkësitë e tyre në Evropë. Megjithëkëtë, gjenerata e dytë dhe e tretë kanë luajtur një rol determinues (përcaktues) në zhvillimin e të

* Ky është një artikull i shkruar burimisht në gjuhën frënge nga autori dhe i botuar në të përmuajshmen *Le Monde Diplomatique*, prill 1998, kurse ne e kemi marrë nga vepra e tij, *To Be A European Muslim*, f. 249-255.

⁶ Komisioni për muslimanët britanezë, i drejtuar nga profesor Gordon Conway, *Islamophobia: A Challenge for Us All*, Runnymede Trust, tetor 1997.

menduarit të njerëzve brenda bashkësive të ndryshme muslimane në Evropë, për arsye që në shikim të parë duken si kontradiktore me njëra-tjetrën.

Ndikimi i gjeneratës së dytë

Shkalla e religjiozitetit ndër muslimanët e rinj është relativisht e ulët, çka nënkupton se për shumikë prej tyre integrimi në vendet ku kanë mërguar, në të vërtetë do të thotë asimilim.⁷ Kjo rënie në shprehjen e jetës fetare i ka detyruar liderët e xhamive të gjeneratës së parë si dhe liderët e shoqatave islame që ta rishikojnë e rimendojnë mënyrën e punës së tyre.

Liderët fetarë, të cilët kanë qenë ose nëpunës qeverish ose militantë islamikë në ekzil, kanë qenë të detyruar t'i adaptohen situatës së të rinjve të tyre, ta flasin gjuhën e tyre, ta rimodelojnë mënyrën e arsimit fetar dhe t'i ridefinojnë strukturat e aktivitetit të tyre social dhe kulturor. Në krahun tjetër, tendenca e përtërirë për respektimin e fesë që e përfshiu një pakicë të rinisë, çoi në krijimin e një numri të madh shoqatash islame. Në një kohë prej 15 vitesh, numri i tyre u dyfishua, ndoshta edhe e trefishua. Forca që qëndronte pas kësaj ishte rinia muslimane, e cila dita-ditës bëhej më aktive, si dhe ata të moshës tridhjetëvjeçare, të lindur në Evropë ose shpesh edhe studentë që kishin mbaruar studimet nëpër universitetet evropiane. Dhënia dhe angazhimi i tyre ka shkaktuar ndryshime të dukshme në mënyrën e të menduarit të shumë njerëzve, sepse ata konsiderojnë se kanë të drejtë të jenë në Evropë dhe presin njohjen e të drejtave të tyre civile (qytetare). Kjo ka krijuar një hendek midis brezave, sepse, ndryshe nga gjenerata e parë e mërgimtarëve, këta të rinj janë të gatshëm të krijojnë role për vetveten në nivelin intelektual dhe shoqëror. Dinamizmi i tyre dhe kultura e tyre evropiane i ka shtyrë më të vjetrit (shpesh ish anëtarë të lëvizjeve islame në Afrikën Veriore, Lindjen e Mesme dhe Azi) për ta rivlerësuar me gjithë mend mënyrën e veprimit të tyre si dhe qëndrimin e tyre intelektual në relacion me Evropën. Mbi të gjitha, kjo ka shkaktuar debate të rëndësishme brendapërbrenda komunitetit musliman, sidomos ndër dijetarët më të vjetër islamë (*ulema*). Kur janë konsultuar për çështje të së drejtës islame (*fikh*), *ulemaja* gjithashtu është detyruar t'i rivlerësojë pozicionet e saj, duke dhënë mendime të reja juridike (*fatva*), të cilat janë më tepër në pajtim me realitetin e jetës në Perëndim. Prezenca gjithnjë në rritje e shoqatave, siç janë *Young Muslims* (YM) dhe *The Islamic Society of Britain* (ISB) në Britani, krahas *Jeunes Musulmans de France* (JMF) dhe *Association des Etudiants Islamiques en France* (AEIF) në Francë si dhe shumë të tjera kudo nëpër Evropë, ka ngritur shumë çështje, përfshirë edhe nevojën që *ulemaja* të mbërrijë te kornizat teologjike dhe juridike të referimit që do të jenë më të qarta dhe më të adaptueshme në kontekstin evropian. Kështu pra, gjatë viteve 1980 – 1990, është parë një vetëdije në rritje e nevojës për një ripërtëritje të të menduarit islam në Evropë. Muslimanët e rinj tanimë janë evropianë dhe, drejtpërdrejt ose tërthorazi, po parashtrojnë pyetje që kërkojnë përgjigje të qarta. A duhet Evropa akoma të konsiderohet, sipas terminologjisë së *ulemasë* së shek. XIX, si *daru'l-harb* (territor lufte), përkundër *daru'l-Islamit* (territorit në të cilin muslimanët jetojnë si shumicë, në siguri dhe nën legjislaturën e tyre të veten)? Me fjalë të tjera, a është e mundur për muslimanët të jetojnë në Evropë? Në qoftë se po, atëherë si do të duhej muslimanët të silleshin ndaj sistemeve juridike kombëtare të vendeve në të cilat po jetojnë? A është e lejuar për një të ri musliman të kërkojë shtetësi evropiane dhe të luajë një rol të plotë si qytetar i vendit të vet? Deri më tani, ekspertët e së drejtës islame nuk kanë dhënë ndonjë përgjigje të hollësishme, globale dhe thelbësore lidhur me këto pyetje.

⁷ Afro 60 % deri 70 % e të anketuarve thonë se agjërojnë Ramazanin, mirëpo vetëm 12 % deri 18 % i falin pesë kohët e namazit; 75 % deri 80 % ose nuk e flet gjuhën e vet burimore, ose e flet shumë dobët.

Gjatë viteve 1990, janë mbajtur një sërë takimesh ku janë diskutuar çështje teologjike dhe juridike. *Ulemaja* nga bota islame i është bashkëngjitur debatit me *imamët* dhe intelektualët që jetojnë në Evropë, për t'i trajtuar çështjet thelbësore e fundamentale.⁸ Për sa i takon së drejtës islame, janë arritur rezultate të mëdha. Janë formuluar pesë parime kryesore, të cilat tani paraqesin bazën e një konsenzusi të vërtetë midis ekspertëve islamë dhe bashkësive islame në Evropë:⁹

1. Muslimani, qoftë rezident qoftë qytetar, duhet ta shohë veten si palë që ka lidhur kontratë, morale apo shoqërore, me vendin në të cilin jeton, ndaj dhe duhet t'i respektojë ligjet e atij vendi.

2. Legjislatura evropiane (e cila për nga natyra është sekulare) u lejon muslimanëve që t'i ushtrojnë së paku bazat e fesë së tyre islame.

3. Koncepti i moçëm i *daru'l-harbit*, i cili nuk është nxjerrë as nga Kur'ani e as që është pjesë e traditës së Muhammedit a.s., shikohet si i vjetëruar; janë sugjeruar koncepte të tjera si mënyra për ta lexuar e vlerësuar më pozitivisht praninë e muslimanëve në Evropë.

4. Muslimanët duhet ta shohin veten si qytetarë në kuptimin e plotë të fjalës dhe duhet të marrin pjesë në jetën shoqërore, organizative, ekonomike dhe politike të vendeve ku ata jetojnë, duke kërkuar njëkohësisht që të respektohen edhe vlerat e tyre personale.

5. Në legjislaturën evropiane si tërësi asgjë nuk i pengon muslimanët, apo ndonjë qytetar tjetër, që të mos sjellin vendime e alternativa në përputhshmëri me fenë e tyre.¹⁰

Thyerja e shablloneve të vjetra

Krahas zhvillimit të kësaj kornize teorike, dukshëm vërehet edhe ripërtërirja e identitetit musliman. Përkundër presioneve që u nënshtrohen, të rinjtë muslimanë po bëjnë shumë me qëllim që të sigurojnë respektimin e identitetit të tyre nga ana e sistemeve juridike nacionale. Shumë shpesh diskriminimi vjen nga interpretimi i ngushtë dhe i shtrembër i ligjeve që mund të jetë ksenofobik për nga natyra, siç është vërejtur në raportin e Fondacionit Runnymede. Sakaq, shihet një energji dhe lidhshmëri në rritje ndër shoqatat muslimane. Kjo, njëkohësisht, u jep vlerë më të madhe edukimit dhe participimit qytetar, që shihen si faza të pashmangshme në fitimin e të drejtave legjitime. Në nivelin lokal, janë organizuar takime ku janë diskutuar çështje të ndjeshme, shpesh në bashkëpunim me organizata specialiste. Një shenjë tjetër e përcaktimit për thyerjen e izolimit është edhe përdorimi i shtuar i gjuhës së vendit nikoqir gjatë konferencave dhe namazeve të xhumasë. Në Britani, e ballafaquar me lëvizje tradicionaliste me ndikim (si p.sh. barelvitët dhe deobanditët), shoqatat rinore si *The Federation of Students' Islamic Societies* (Federata e Shoqatave Islame të Studentëve -

⁸ Dhjetë *ulema* nga bota islame janë takuar në qershor 1992, e pastaj në korrik 1994, në Institutin Evropian të Shkencave Shoqërore në Château-Chinon, me qëllim që të hartojnë një kornizë juridike islame për praninë e muslimanëve në Evropë. Në Britani, *The Islamic Foundation* ka ndërmarrë një sërë nismash në këtë drejtim qysh nga viti 1990. Londra gjithashtu ka qenë dëshmitare, në mars 1997, e themelimit të *European Council for Judicial Opinions and Research* (Këshilli Evropian për Mendime Juridike dhe Kërkime). Shih buletin *Sawt Uruba* (Zëri i Evropës) i botuar arabisht nga *The Federation of Islamic Associations of Europe* (Federata e Shoqatave Islame në Evropë), Milano, maj 1997. (Në gjuhën shqipe në vitin 2003 nga Shtëpia Botuese 'Furkan' është botuar pjesa e parë e përmbledhjes së fetvave të këtij Këshilli – R. N.).

⁹ Grupet si *Hizbu't-tahrir*, *el-Muvahhidun* dhe *el-Muhaxhirun* në mënyrë agresive bëjnë thirrje për një zbatim të reduktuar të së drejtës së Sheriatit në Evropë. Përkundër popullaritetit të stërmadhuar që ua japin mediat, këto grupe në fakt janë shumë të izoluara.

¹⁰ Nga aspekti i mundësisë që detyrat të cilat i parasheh ligji të bien ndesh me parimet islame (një situatë që afërsisht është shumë e rrallë), ekziston nevoja për t'u bërë kërkime e studime me qëllim që të identifikohen parimet prioritare dhe / ose mundësitë për adaptim.

FOSIS) dhe *Young Muslim* (YM) po i luftojnë tendencat getoiste. Duke pranuar se sistemi multikulturor anglo-sakson përgjithësisht e ka bërë të mundur ruajtjen e identitetit kulturor të popullatës indo-pakistaneze të Britanisë, ata duken të vendosur të luftojnë kundër diskriminimit që buron nga faktori geto. Islami evropian gjithashtu duket se po gjen rrugë për të mbetur politikisht dhe ekonomikisht i pavarur. Disa xhami dhe institucione të mëdha akoma janë të varura nga disa qeveri, mirëpo gjithnjë e më shumë shoqata islame po pavarësohen tërësisht, kështu që shumë faktore tani po ndërtohen me fondet e mbledhura brenda vetë bashkësive të tyre. Aktivitetet e rinisë muslimane mbështeten ose nga vetëfinancimi ose nga subvencionet që i ofrojnë qeveritë evropiane,¹¹ kurse kjo nënkupton një shkallë pavarësie. Në Evropë, bashkësitë islame i ikin një situatë ku njerëzit e shquar luftojnë për atë se cili ka të drejtë të flasë si përfaqësues zyrtar i bashkësive të ndryshme nacionale. Ky është një zhvillim pozitiv, që i hap mundësinë përfaqësimit të njëmendtë, çka buron prej anëtarësisë së gjerë të bashkësisë, ku anëtarët i zgjedhin përfaqësuesit e tyre, ku ekziston pavarësia politike dhe financiare, sidomos nga fakti se tani brenda këtyre bashkësive vërehet një prirje e fuqishme drejt pluralizmit. Megjithëse nuk duhet nënçmuar rezistenca që i bëhet kësaj prirjeje, prapëseprapë është bërë një progres i dukshëm në formimin e Këshillit Islam në Spanjë, Këshillit të Lartë në Belgjikë dhe Këshillit Islam në Britani, të themeluar në nëntor 1997. Treguesi final i ndryshimeve të thella që janë në rrjedhë e sipër është numri i projekteve artistike dhe kulturore që i përfshijnë muslimanët e Evropës. Në Britani, Spanjë dhe Francë, grupe të ndryshme punojnë për krijimin e një kulture të vërtetë islame evropiane. Përderisa disa prej tyre kufizohen duke imituar format dhe zhanret e njohura (rep, shfaqje veriete, teatër popullor etj.), të tjerët krijojnë sineteza mahnitëse. Këto shprehje artistike dalëngadalë po shkëputen prej temave të tyre të theksuara arabe, turke apo indo-pakistaneze dhe po përpunohen t'i rikrijojnë vlerat islame brenda zakoneve kombëtare dhe shijeve kulturore. Së shpejti mund të presim paraqitjen e një sineteze akoma më origjinale, krijimin e një identiteti musliman evropian, që do të mund të pranohet nga masa e gjerë. Megjithëkëtë, realitetet e diskriminimit, mosbesimit dhe refuzimit të përditshëm nuk janë zhdukur, ndaj shumë muslimanë po kalojnë shumë vështirë në Evropë. Rruga drejt bashkëjetesës i ngjan një fushe të minuar, jo aq shumë për shkak të sistemeve diskriminuese juridike, por për shkak të një paragjykimi të përhapur gjithandej kinse Islami dhe muslimanët, sipas vetë definimit, nuk janë "të aftë për integrim".

Kjo tregon për nevojën urgjente të arsimimit dhe informimit. Perceptimet e thjeshtëzuara popullore mbi Islamin e pengojnë në masë të madhe publikun e gjerë që të mos e vërejë progresin e madh që është bërë në fushën e integritimit. Ka shumë iniciativa që tanimë i kanë hapur dyert në këtë drejtim: organizimi i dialogjeve të hapura, përpjekjet e bëra nga vetë muslimanët për ta prezantuar vetveten (tubimet e dialogut ndërfaqësor, ditët e hapura, debatet universitare etj.) si dhe refuzimi i stereotipeve (kallëpeve) nga ana e disa intelektualëve dhe gazetarëve. Dyert mund të jenë të ngushta, mirëpo ato i hapin rrugë një ardhmërie të respektimit të ndërsjellë. Në vend që të mendojmë ftohtë dhe formalisht për një integrim pasiv të muslimanëve, me entuziazëm duhet të presim një kontribut pozitiv të muslimanëve në ndërtimin e një Evrope të re. Prezenca e tyre është një burim pasurimi: kjo kontribuon në reflektimin (përsiatjen) e vendit të shpirtërores në shoqëritë e sekularizuara si dhe në promovimin egalitar (barazimtar) të pluralizmit fetar dhe kulturor. Në kuptimin më të gjerë, muslimanët janë aleatë natyrorë të të gjithë atyre të cilët e sfidojnë shoqërinë në çështjet e kuptimit, etikës dhe drejtësisë shoqërore.

¹¹ Më 1997, shoqatat islame në Britani dhe Francë me sukses janë kandiduar në programin "Një shpirt për Evropën", të organizuar nga Komisioni Evropian. Shih vjetarin e Komisionit, *Annual Report - 1997*, Sekretariati i Përgjithshëm i Komisionit Evropian, Bruksel.

MUSLIMANËT NË PERËNDIM: NDËRMJET GETOIZIMIT DHE ASIMILIMIT

Që nga momenti kur çelësat e Granadës islame iu dorëzuan Ferdinandit dhe bashkëshortes së tij, fati i muslimanëve u vulos për t'u bërë viktimë e shekujve që vinin, jo vetëm në Evropë por edhe gjetiu nëpër botë. Spanja u spastrua prej muslimanëve, kurse trashëgimia e tyre afro tetëqind vjeçare e historisë së civilizimit u çrrënjos me hakmarrje të thellë. Edhe pse turqit osmanlinj bënë një lëvizje përpara në Evropën Lindore dhe për disa shekuj me radhë mbetën fuqia e vetme ushtarake, prapëseprapë nuk mundën ta ndalnin spiralën e tatëpjetës së ummetit. Stagnimi i brendshëm lindi një epokë të nënshtrimit e të poshtërimit të muslimanëve nga ana e armiqve evropianë. Me humbjen e frymës islame, u lëkund edhe gjallëria e krijimtaria e muslimanëve. Ato u zëvendësuan nga dogma dhe pasiviteti. Pesëqind viteve të fundit muslimanët kanë zënë një vend të dorës së dytë në punët dhe planet e botës. Madje edhe pas pesë dekadash të dekolonizimit, bota muslimane është konsumuese e ekonomisë së tregut dhe e ideve hedoniste të Perëndimit. Bashkësia muslimane, me thesarin e Kur'anit në duar, po i afrohej fundit thuaja në të gjitha sferat.

Mbarë bota islame, përveç disa vendeve formalisht të pavarura, që i ishin nënshtruar kolonializmit evropian, si “bashkësia më e mirë” (Alu Imran, 3:110) ka përjetuar një metamorfozë të mrekullueshme. Sot në Perëndim, shumica e muslimanëve, përveç atyre të vatrës së nxehtë të Ballkanit, janë ‘imigrantë’ nga tokat ish-koloniale të Azisë e Afrikës. Efekti i hegjemonisë koloniale po fanitet gjithandej brenda ummetit islam, jo vetëm në formën e varësisë materiale e të disharmonisë së brendshme po edhe në servilizmin intelektual dhe shkurajimin psikologjik. Nga ana tjetër, shumë muslimanë po jetojnë me trauma të luftës, të dhunës, të varfërisë, të mosdurimit fisnor e sektar në vetë shtetet e tyre. Shumica e bashkësisë muslimane janë të çorientuar e të shkëputur nga e kaluara e bujshme dhe e ngulitur e tyre.

Psika muslimane akoma është nën ndikimin e ndërlikueshmërisë historike. Në njërin skaj kemi pjellën e imagjinatës koloniale të cilët me zell po i trumpetojnë zërit të mjeshtërve të tyre, kurse në skajin tjetër janë masa e izoluar, e drejtuar përbrenda, të cilët këmbëngulin në atë që ata e kuptojnë si të kaluar (histori) të tyre. Kurse sfiduesit e *status quo*-së i gjen të kapur midis këtyre dy skajeve.

Efekti i tatëpjetës së muslimanëve është ngritja e dallgëzimi i xhahilijetit modern i cili njerëzimin po e largon gjithnjë e më tepër nga e Vërteta dhe Drejtësia. Për pasojë, kjo e ka grabitur paqen nga sipërfaqja e dheut. Njeriu e ka ulur vetveten nga pozita e mëkëmbësit të Krijuesit në një status që nuk i ka hije dinjitetit njerëzor. Njerëzimi po vuan nga një krizë e pashoq identiteti. Edhe muslimanët po ballafaqohen me probleme shumëfarëshe, si në Lindje ashtu edhe në Perëndim. Duke qenë në ballë të të arriturave marramendëse materiale dhe shkencore, Perëndimi ka një joshje hipnotike për popujt e varfëruar të ‘botës së tretë’. Shpërthimi intelektual që shkaktoi të menduarit e lirë dhe kreativitetin gjatë Rilindjes ia arrin kulmin me Revolucionin industrial dhe me monopolin teknologjik të Perëndimit mbi pjesën tjetër të botës. Kjo akoma vazhdon kështu e patejkaluar. Sido që të jetë, pas Luftës II Botërore politika e dominimit brutal ushtarak mbi botën është zëvendësuar me një metodë ‘humane dhe civilizuese’ të shtërngimit e detyrimit. Kjo u ka dhënë atyre një mbështetje psikologjike mbi të tjerët. Meqë Perëndimi akoma vazhdon t'i zптоjë vendet udhëheqëse të punëve të botës, e jo vetëm në forcën ushtarake e politike po edhe në zotësitë intelektuale dhe organizuese, për miliona njerëz të vendeve të tjera mbetet si një botë e ëndërrave.

Megjithëkëtë, sikur të gjitha perandoritë e së kaluarës edhe Perëndimi e ka shpikur monstrumin (përbindëshin) e vet, miklimin e materializmit ekstrem. Poça po nxehet së tepërmi që njeriu t'i vazhdojë veçoritë e tij ekskluzive. Bashkësia muslimane ka frikën më të madhe. Gjatë dekadave të kaluara, si bashkësi në zgjerim dhe që i kërkonte të drejtat e veta, asaj i janë hapur caqe të reja sfide. Në tokat e mjeshtërive të tij të mëhershëm gjenerata e parë ka pësuar ndërlikime të pafund psikologjike gjatë përshtatjes me mjedisin 'e huaj'.

Në krahun tjetër, gjeneratat e mëvonshme po përpiqen me gjithë shpirt për të rënë në ujdë me dy botët 'e kundërta me njëra-tjetrën' – me jetën tradicionale muslimane të drejtuar përbrenda dhe me stilin e jetës perëndimore të materializuar e ndërlikuar tej mase. Sistemi i sekularizuar edukativo-arsimor si dhe dinamikat e gjera shoqërore kanë patur ndikim kolosal mbi zhvillimin e ummetit islam. Armiqësia e hapur ndaj vlerave hyjnore si dhe promovimi i relativizmit e shturjes morale kanë patur pasoja shkatërrimtare. Përhapja e kulturës së konsumit dhe e industrisë së zbavitjes e dëfrimit po e bren e bluan frymën e padjallëzisë së njerëzve më të rinj. Shfaqja e reklamave erotike nëpër vende publike dhe qarkullimi masiv i revistave e tablove pornografike po i thërrasin njerëzit drejt shturjes e prostitucionit. Feminizmi radikal, modelizmi, lavdërimi i seksit jashtëmartesor dhe homoseksualizmit janë bërë vegla dhe makineri e modernitetit. Efekti i gjithë kësaj është erozioni moral, çintegrimi i strukturës familjare, keqtrajtimi i fëmijëve dhe sëmundje të tjera sociale. Linja të shumta ndihme dhe muhabetesh po i joshin të rinjtë, përfshirë edhe muslimanët, dhe po kontribuojnë në çorientimin rapid social.

Nga ana tjetër, shfaqja e ummetit islam është për të mirën e përgjithshme të njerëzimit. Kjo kërkon një vizion të gjithmbarshëm e të plotë, duke manifestuar sjellje shembullore në punët e përditshme. Muslimanët për shembull e marrin jetën e peygamberit Muhammed a. s. dhe të shokëve të tij të cilët plotësisht dhe në çdo aspekt i takonin kësaj shoqërie. Ata jo vetëm që merrnin pjesë në punët e shoqërisë, por edhe luanin rolin kryesor në zbutjen dhe pakësimin e nevojave shpirtërore dhe materiale të njerëzve në përgjithësi. Ata u bënë model roli për pjesën tjetër të bashkësisë.

Muslimanët kudo që janë po përjetojnë një transformim të brendshëm. Muslimanët që jetojnë në Perëndim, duke qenë në zemër të qytetërimit dominant materialist, kanë përpara vetes një barrë shumë të madhe. Përgjegjësia e parë dhe kryesore e tyre është të krijojnë një bashkësi të fortë të veten, të mbështetur në vlera të përgjithshme dhe në pjesëmarrje më të gjerë të të gjitha sekteve e kategorive të muslimanëve. Meqë vizioni islam mbështetet në shërbimin ndaj All-llahut xh. sh., lidhja e dashurisë dhe e vëllazërisë është një parakusht për një forcë kohezive e cila do ta sfidojë xhahilijetin e papërmbajtur të ditëve moderne. Përtëritja e një shoqërie njerëzore të pasur nga aspekti shpirtëror tani është një detyrë e ngutshme dhe e madhe. Në qoftë se muslimanët në Perëndim arrijnë të krijojnë një shoqëri të hapur që do të ketë ngrohtësi e dhembshuri për të gjithë, që do t'i mbjellë identitet e krenari gjeneratës së saj më të re dhe që do të silllet me përgjegjësi e maturi, kjo do të paralajmërojë fillimin e një epike të re.

Lufta e muslimanëve për të krijuar njëfarë infrastrukture nëpërmjet themelimit të xhamive, qendrave e shkollave islame, ushqimeve hallall etj., edhe përkundër kufizimeve dhe detyrimeve të skajshme, është një dukuri inkurajuese. Ata, peizazhit perëndimor i kanë sjellur një pamje të re dhe kanë trasuar rrugën për shoqëri pluraliste në shumë vende perëndimore. Këto janë produkte të përkushtimit, vendosmërisë dhe dashurisë së pastër që shumica e muslimanëve e kanë ndaj Islamit. Mirëpo, fatkeqësisht, shumica e këtyre kontributeve madhështore janë të pjesshme. Si rrjedhojë, këto qendra të punëve të mira të pakoordinuara kanë ndikim të vogël kombëtar. Shumë shpesh, ato po dëmtohen e shëmtohen nga jotoleranca sektare, gjuhësore dhe fisnore. Mungesa e akomodimit dhe mendjegjerësisë po i hedh përtoke këto të arritura të fituara me shumë mund. Kjo hera-herës del fatale për bashkësinë. Bërësit e së famshmes politikë "përçaj e sundo", gjejnë kënaqësi nga kjo situatë.

Karshi kësaj sfide të brendshme, bashkimi është e vetmja zgjidhje. Por fatkeqësisht kjo është një punë shumë e rëndë dhe e lodhshme. Bashkimi është një synim i lakmuar i ummetit islam i cili mund të arrihet vetëm nëpërmjet mirëkuptimit më të gjerë, qëndrimit pozitiv ndaj të tjerëve, hapjes dhe pranimit të larmisë së qenieve njerëzore. Për ta realizuar bashkimin e veprimit, bashkimi i zemrës është elementi kyç. Kjo mund të arrihet vetëm me bekimin e Allahut xh. sh. Organizatat dhe institucionet me mirëkuptim dhe ndjeshmëri duhet ta marrin mbi vete barrën e iniciativës në këtë drejtim. *“Ndiqmoni njëri-tjetrin në mirësi e devotshmëri dhe mos e ndiqmoni njëri-tjetrin në gjynah dhe armiqësi!”*, (el-Maideh, 5:2).

Në këtë situatë të lemeritshme, ka muslimanë që pak i njohin rrethanat ku jetojnë. Ekziston padituri, apati dhe fatalizëm i zi. Ka edhe të atillë që, nga frika dhe urrejtja ndaj Perëndimit, tentojnë të fshehen nga realiteti e të mbyllën brenda getove të tyre. Ka njerëz që i dorëzohen lakmisë dhe letargjisë në shkallë të shpërpjesëtuara. Të tjerët që dëshirojnë të bëjnë diçka kapin qasje e metoda shumë të ngushta e thjeshtëzuese. Nga ana tjetër ke elitën e fuqishme, mbeturinën e krijuar nga fuqitë imperiale në vendet muslimane, të cilët e mbrojnë asimilimin (shkriren) e tërësishëm në kulturën sekulare liberale të Perëndimit. Këta janë apologjetët, ‘zotërinjtë e murmë’ të së sotmes të cilët e përfaqësojnë shtyllën e pestë brenda ummetit islam.

Marrë në përgjithësi, edhe pse ekziston shpresa në forcën e brendshme të ummetit, përpara nesh ndodhen prapësi çrregulluese. Duhet të përkujtojmë se, kur një popull që bart synim hyjnor, zgjedh të vetëkënaqet dhe të tregojë ngurrim e rezistencë ndaj punëve të botës, rezultati do të jetë poshtëria dhe vuajtja. *“Nëse ju nuk marshoni përpara, Ai (Zoti) do t’ju ndëshkojë me dënim të dhimbshëm dhe do t’ju zëvendësojë me një popull tjetër. Ju nuk mund t’i sillni aspak dëm Atij. All-llahu është i Zoti për të bërë çdo gjë”*, (et-Teubeh, 9:39).

Në këtë detyrë të frikshme alternativat e muslimanëve janë shumë të kufizuara: **getoizimi**, **asimilimi** dhe **mbrojtja**. Gjatë historisë, shumë popuj kanë humbur ngase kanë parapëlqyer të mbeten të mbyllur e të veçuar nga popujt ‘nikoqirë’. Si rezultat, ata ose janë fshirë nga faqja e dheut ose janë ‘spastruar etnikisht’ në njëfarë mase. Beni Israilët (Populli i Musait) e Egjiptit, hebrenjtë e Evropës para holokaustit dhe, në njëfarë mase, muslimanët e Spanjës përbëjnë rastet arketipe. Edhe shembujt e asimilimit janë gjithashtu të shumtë. Shumë do popuj e kanë humbur identitetin e tyre dhe janë gllabëruar nga tetëkëmbëshi (oktapodi) kulturor i qytetërimit dominant përgjatë dekadave e shekujve. Këtu mund të përmenden zezakët e Perëndimit dhe muslimanët e Ballkanit. Vetëm tani vonë, këta popuj kanë treguar një tendencë për ta mbrojtur identitetin e tyre, por me një çmim shumë të lart.

Alternativa më e mirë që të mund një bashkësi të mbijetojë e të prosperojë është ruajtja e vlerave dhe parimeve të saja unike kudo që të jetojë. Shembuj për këtë kemi tregtarët muslimanë të Lindjes së Largët dhe nacionalistët evropianë të periudhës kolonialiste. Mbrojtja është e lidhur me fuqinë, qoftë materiale qoftë morale apo shpirtërore. Në kulmin e përhapjes së Islamit muslimanët kanë qenë të pajisur me të dyja këto fuqi. Më vonë, kur muslimanët gradualisht po e humbnin fuqinë materiale, mbrojtja shpirtërore ka qenë faktor kyç për hapjen e fronteve të reja. Që nga shekulli XVIII e këndeje perëndon edhe kjo dhe Evropa e mbron vetveten në plan të parë me fuqinë materiale.

Mbrojtja dhe ruajtja funksionon kur bashkësia ndërvepron me të tjerët. Ndërveprimi (interaksioni) është shkalla e parë për të marrë pjesë në punët e përgjithshme, publike. ‘Bashkësia mysafire’ atëherë bëhet pjesë e ‘bashkësisë nikoqire’, e integruar, jo e asimiluar. Ata atëherë punojnë për një fitim të ndarë bashkërisht, për një pajtueshmëri të përbashkët (Alu Imran, 3:64). Ky urdhër kur’anor mund të implementohet vetëm atëherë kur bashkësia muslimane merr pjesë aktive në ‘gëzimin e së mirës dhe në ndalimin e së keqes’. Kriteret e së mirës dhe së keqes bazë janë të përbashkëta për secilin. Kur bashkësia muslimane përnjëmend

ngritet në një shkallë të lartë morale dhe me efikasitet merret me çështjet që kanë të bëjnë me të gjithë, vetëm atëherë plotësohet kuptimi i bashkësisë më të mirë (Alu Imran, 3: 110).

Në një botë të xhahilijetit, ku paqa është në zhdukje e sipër, ummeti musliman gjendet në udhëkryqin e fatit të vet. Muslimanët e Perëndimit kanë një përgjegjësi të madhe mbi supet e tyre. Ardhmëria e tyre në masë të madhe varet nga zotësia e tyre për t'u bërë ballë sfidave të kohës. Muslimanët tani janë një pakicë e rëndësishme e Perëndimit. Ata kanë burime materiale të pafund dhe trashëgimi të ndryshme kulturore dhe qytetërimore. Islami është ngushëllimi final për shpirtin njerëzor, sepse është "*fe e natyrores*" (er-Rum, 30:30). Çdo qenie njerëzore lind si musliman me një natyrë të bashkëlindur të së mirës në vetvete. Muslimanët janë të bekuar në kuptimin se burimi origjinal i Islamit, Kur'ani dhe Sunneti, akoma janë të ruajtur në formën e tyre të paprekur e të pastër pa kurrfarë tjetërsimesh e falsifikimesh, që s'është rast me tekstet e feve të tjera.

Në këtë kontekst mund të themi se muslimanët e Perëndimit mund të luajnë një rol të rëndësishëm për të ardhmen e njerëzimit. Ata mund të jenë katalizatorë (përsheptues) të një ndryshimi hyjnor duke e brumosur ardhmërinë e njeriut në një milenium të ri. Ajo çka është e rëndësishme është besimi i paluhatshëm, njohuritë e thella dhe realizimi i asaj që e shprehin. Mbetet të shohim nëse këta muslimanë mund ose jo ta marrin mbi supet e tyre këtë barrë profetike.

MUSLIMANËT NË PERËNDIM*

Profesor Akbar S. Ahmed i në këtë artikull e shqyrton gjeneratën më të re, përvojën amerikane kundruall asaj evropiane si dhe integrimin e muslimanëve në shtetet perëndimore.

Në mijëvjeçarin e fundit, Perëndimi Islamit e ka konsideruar si "të tjerët", si "diçka atje larg". Përgjithësisht kjo akoma është kështu: pjesa më e madhe e popullatës muslimane jeton në Afrikë dhe Azi. Mirëpo sot, ky botëkuptim i thjeshtë është komplikuar me prezencën e mbi dhjetë milionë muslimanëve në Perëndim. Afro pesë a gjashtë milionë muslimanë jetojnë në Evropë dhe afro katër a pesë milionë në Amerikë; numrat e prerë mund të mos jenë të saktë, sepse imigrantët dhe të konvertuarit herë-herë nuk duan ta deklarojnë identitetin e tyre dhe është vështirë t'i fusësh ata brenda këtyre shifrave. Muslimanët që jetojnë në Perëndim, për nga aspekti teologjik janë në harmoni me qëndrimet kur'anore. Shumë herë Kur'ani thekson se prona e Zotit nuk është e kufizuar me Lindjen a Perëndimin; ajo përfshin gjithçka. *"Të All-llahut janë edhe Lindja edhe Perëndimi. Dhe kahdo që të ktheheni, aty është ana e All-llahut. Vërtet All-llahu është i gjerë (në bujari) e i dijshtëm"* (el-Bekara:115). Kështu që muslimanët mund ta praktikojnë fenë e tyre ndaç në Kajro a Kaliforni, ndaç në Londër apo Lahor.

Prandaj, ne kemi nevojë për një kornizë të re referimi. Nuk mund më të shikohet çështja si Islami përballë Perëndimit; tanimë kemi Islamit dhe Perëndimin ose Islamit në Perëndim. Për rritjen e rëndësishme të kësaj bashkësie muslimane mund të gjykojmë sipas xhamive: edhe Franca edhe Gjermania kanë afro një mijë (1000) xhami, Anglia afro pesëqind (500), edhe pse shumë prej tyre mund të jenë vetëm nga një a dy dhoma. Xhamitë qendrore të Londrës dhe Uashingtonit e simbolizojnë këtë rritje: xhamitë janë përplot adhurues, ato janë ndërtuar bukur dhe përbëjnë boshtin e aktivitetit shoqëror dhe fetar të muslimanëve.

Mirëpo, megjithëse nuk ka pengesa teologjike për muslimanët e Perëndimit, nuk mund të thuhet e njëjta edhe për ato sociologjike dhe politike. Prania e muslimanëve në Perëndim u ka hedhur benzinë ndjenjave antiislame. Vajzat e reja të mbuluara me *hixhab* në Francë janë bërë lëndë e lajmeve kombëtare armiqësore; muslimanët që në Angli kërkojnë shkolla të ndara janë në qendër të debateve të nxehta kombëtare; çështja Selman Rushdi vazhdon t'i fusë muslimanët dhe shumicën në një konfrontim plot vrer.

Kjo atmosferë e ngarkuar e ka inkurajuar rritjen dramatike të racizmit në vitet '80. Kjo u simbolizua nga Le Peni në Francë. Popullariteti i tij eskaloj aq furishëm, sa shumë politikanë e injoruan mesazhin e tij. Së shpejti, madje edhe zyra të dalluara të kryeministrit francez filluan të flisnin për "imigrantët e qelbur e të ndyrë". U bë modë të flitej për imigrantët me përçmin e përbuzje të hapur. Politikanët bënin thirrje për kontrollat të rrepta imigrimi, madje edhe për deportim. Ky lloj qëndrimi publik ishte fare i paimagjinueshëm një gjeneratë më herët, kur gjethi i fikut (dora e paqes) i humanizmit evropian i kishte mbuluar shprehjet e tilla raciste.

Pavarësisht një atmosfere me armiqësi në rritje në disa vende perëndimore, disa faktorë të tjerë e kanë mprehur ndjenjën e identitetit të muslimanëve. Kjo është arsyeja përse ngrihet

* Ky artikull për herë të parë ka dalë në dritë si pjesë e librit *Living Islam, From Samarkand to Stornoway*, të Akbar S. Ahmedit, botuar nga BBC Books Limited, Woodlands, 80 Wood Lane, London, U.K. W120TT©1993.

kaq pluhur. Ajo e shpjegon platformën për politikanët e çiftit të Le Penit. Atmosfera politike ndërkombëtare, e cila është ndryshuar në mënyrë dramatike viteve '70, u ka mundësuar muslimanëve ta gjejnë vetveten. Kjo ishte periudha kur mbreti Fajsal i Arabisë Saudite e përdori naftën si një armë islame, kurse Imam Homeini në Iran dhe gjeneral Zijaulhakki në Pakistan flisnin për revolucionin islam dhe islamizimin. Ky lloj i lidershit politik e nxiti revivalizmin islam ndër bashkësinë muslimane, kudo që jetonin ata nëpër botë.

Gjenerata më e re

Një gjeneratë më e re e imigrantëve muslimanë po rritet në Perëndim; afro gjysma e tyre tanimë kanë lindur në Perëndim për dallim prej prindërve të tyre, të cilët kanë migruar këtu viteve '50 dhe '60. Të rinjtë e kanë refuzuar integrimin dhe asimilimin që shpesh e kanë dëshiruar prindërit e tyre. Ata nuk janë më imigrantë të dëgjueshëm, të padukshëm dhe mirënjohës për pranimin që u është bërë; ata duan ta nxjerrin vetveten në pah. Në këtë situatë shpesh i është vënë fitili çështjes së racës dhe fesë, pasi racizmi gjithnjë në rritje i ka detyruar ata drejt një ndjenje më të madhe identiteti fetar.

Kah mesi i viteve '60, kur isha në Kembrixh, nuk kishte vend për të falur namazin e xhumasë. Tani, viteve 1990, ka tri xhami dhe pa stërmadhim ato mbushen plot e përplot me xhemat ditëve të xhumaja. Në sesione të ndryshme të konferencave *Siiratun-Nebijj* (për nder të Pejgamberit a.s.), të organizuara nga Shoqata pakistaneze në Kembrixhshir, të cilat i kryesoja unë, merrnin pjesë afro 200-250 muslimanë, bashkë me familjet e tyre. Një dukuri e këtillë duket se po ndodh gjetiu nëpër botë. Në vitin 1989 kur po udhëtoja për në Havai për një konferencë, më erdhi një ftesë të ligjëroja pas namazit të akshamit në xhaminë e saponduar në Seattle. Aty të pranishëm ishin afro 200 muslimanë; shumica prej të cilëve femra – përsëri një shenjë e kohëve tona. Pyetjet që m'u parashtruan dukshëm u fokusuan mbi rolin e muslimanëve si pakicë.

Këtu duhet parë edhe faktorin ekonomik. Gjenerata më e re është arsimuar më mirë se prindërit e saj, të cilët në Britaninë e Madhe, për shembull, kanë pas ardhur kryesisht për të zënë punë të ulta si konduktorë autobusash apo punëtorë fabrikash. Muslimanët e rinj tani konkurrojnë për të zënë vende në universitet me ambicie për t'u bërë doktorë a inxhinierë. Ata duan ta gëzojnë jetesën e mirë të Perëndimit, duke poseduar shtëpi e vetura të kohës.

Jo të gjithë analistët janë të bindur se shenjat e aktivitetit musliman janë dëshmi e shëndetit dhe qëndrueshmërisë islame. Disa trende që shihen ndër gjeneratën e re të muslimanëve, kanë shkaktuar pesimizëm te disa qarqe muslimane. Muslimanët më të vjetër që jetojnë në Perëndim janë të brengosur se mos po dobësohet kultura e tyre me kalimin e kohës. Për shembull, dr. Muzzemmil H. Siddiki i referohet një studimi të kryer së shpejti lidhur me bashkësitë muslimane të imiguara në Perëndim, i cili ka treguar se për çdo gjeneratë që kalon gjithnjë e më tepër po shihet rrënie në ndjekjen e ngushtë të vlerave të posaçme islame.

Është vërejtur se një numër i vogël muslimanësh kujdeset për pesë kohët e namazeve ditore. Disa nuk ndjehen keq për pirjen, dehjen dhe dansin. Disa vajza muslimane mendojnë se nuk ka asgjë të keqe që të martohen me jomuslimanë për sa kohë që ata e duan dhe kujdesen për njëri-tjetrin. 70 deri 80 % e të gjithë muslimanëve nuk i takojnë asnjë xhamie apo qendër islame, dhe as që çajnë kokën për këtë. Shumica mendojnë se vendet muslimane (sidomos ato të pasurat me naftë) duhet t'u ngrëjnë atyre xhami, kurse këta të mos kontribuojnë as një përqind prej të ardhurave të tyre për qendrat dhe organizatat islame. (Siddiki 1991: 12-13)

Përvoja amerikane përballë asaj evropiane

Ekzistojnë disa dallime të rëndësishme midis SHBA-ve dhe Evropës, të cilat na ndihmojnë ta kuptojmë më mirë fenomenin e muslimanëve që jetojnë në Perëndim dhe të cilat gjithashtu nxjerrin në pah dallimet më të trasha historike midis SHBA-ve dhe Evropës. Dallimi kryesor është përbërja shoqërore dhe ekonomike e bashkësisë muslimane. Në SHBA ajo është e klasës së mesme të doktorëve, inxhinierëve, akademikëve. Kjo i jep bashkësisë muslimane një vetëbesim më të madh shoqëror dhe një ndjenjë pozitive të përkatësisë. Në Evropë, kryesisht, bashkësia muslimane mbetet e mbyllur në klasën ose edhe në nënklasën punëtore. Dështimi i saj në skenën politike është spektakulare: edhe pse Britania ka thujse dy milionë muslimanë, ata nuk kanë mundur të fitojnë një vend të vetëm në Parlament. Ç'është më e keqja, liderët e tyre kanë prirje të ndahen, sidomos për sa i përket asaj se ku duhet hequr vijën midis integritit dhe identitetit tradicional musliman; ata duken më të interesuar ta akuzojnë njëri-tjetrin sesa ta përfaqësojnë bashkësinë muslimane. Një dallim tjetër është se SHBA-të kanë një shtrirje më të gjerë gjeografike; muslimanët nuk janë të përqëndruar në një shtet apo qytet. Në Evropë ka një tendencë përqëndrimi; Bradfordi i Anglisë është një shembull. Përqëndrimi u mundëson liderëve të atij qyteti të caktuar të dalin si zëdhënës. Gjatë krizës Rushdi, liderët e Bradfordit vazhdimisht janë konsultuar nga media dhe, merret vesh, kanë folur në emër të gjithë komunitetit. Kjo ia mundësoi medias t'i thjeshtësojë çështjet e lidhshme, vlerave, strategjisë dhe organizimit të muslimanëve. Shumë më vonë populli kuptoi se edhe pse zëdhënësit e Bradfordit përgjithësisht e kanë reflektuar opinionin e përgjithshëm të muslimanëve, ata kurrsesi nuk kanë qenë liderë të zgjedhur apo të pranuar unanimisht nga e gjithë bashkësia muslimane e Anglisë.

Përqëndrimi i muslimanëve në bashkësi të veçanta ka një konsekuencë tjetër. Bashkësia muslimane mund t'i importojë nga shtëpia dhe t'i përjetësojë karakteristikat e saj sektare dhe etnike. Tensionet tradicionale sektare në Pakistan ndërmjet *barelvijve* dhe *deobandisëve* janë bartur njësh në Britani. Për një të huaj dallimet midis këtyre sekteve janë pështjelluese dhe vështirë të kuptueshme. Lejomëni t'ju tregoj një shembull. Për *barelvijtë* (të cilët kryesisht vijnë nga provinca pakistaneze e Penxhabit), Pejgamberi a.s. është një figurë mbinjerëzore, prezenca e të cilit është gjithandej rreth nesh në të gjitha kohët; ai është *hadir* - prezent; ai nuk është njeri prej mishi e gjaku, por është *nur* - dritë. *Deobandisët*, të cilët gjithashtu e përnderojnë Pejgamberin a.s., mbajnë qëndrimin se ai ka qenë *insan-i kamil*, njeri i përkryer, por akoma vetëm njeri, i vdekshëm. Kjo na sqaron arsyen përse Kalim Siddiki në Britani, duke kërkuar implementimin e *fetvasë* kundër Salman Rushdiut për fyerjet ndaj Pejgamberit a.s., përkrahjen dhe simpatinë më të madhe e gjeti ndër *barelvisët*, sidomos në rrjetin e xhamive që ata i organizonin.

Evropa ka ndryshuar shumë në lidhje me imigrantët e saj dhe kulturën e tyre. Për shembull, që nga fillimi i viteve '50 deri kah fillimi i viteve '90, ka ndodhur një numër i madh zhvillimesh në Britani në të gjitha nivelet e shoqërisë: nga shtatë karri restorane në shtatë mijë, nga disa xhami në 500, nga asnjë prezentues dhe gazetar televiziv nga Afrika e Azia në duzinë, nga vetëm pak autorë afrikanë e aziatikë që shkruanin në anglisht në një sërë prej tyre që kanë fituar Çmime për Libër. E gjithë kjo ishte për të mirë; kultura britanike u pasurua po aq më shumë. Mirëpo, është lehtë ta kuptosh frikën e britanezëve se ndoshta shumë gjëra kanë ndodhur shumë shpejtë. Mbi të gjitha, Britania është një shoqëri thellë konservative dhe ishullare (e ngushtë) dhe kurrë më parë nuk kanë përjetuar një ndikim të huaj dhe nga vise kaq të largëta. Kjo frikë lehtë i ushqeu ndjenjat e armiqësisë racore. Muslimanët në SHBA janë të vetëdijshëm se ata janë atje sipas zgjedhjes së tyre. Ata kanë zgjedhur vetë të bëhen amerikanë. Amerika, para së gjithash, është një vend kazani, ku çdokush është idealisht i barabartë. Kjo nuk mund të shihet te rasti i muslimanëve të Evropës. Shumë prej tyre mendojnë se janë në Evropë thjesht pse prindërit e tyre kanë migruar ose kanë qenë të

detyruar të migrojnë atje për arsye ekonomike. Kjo i bën ata qytetarë të zhgënjyer e të tëhuajësuar.

Muslimanët e Evropës kanë një lidhje të drejtpërdrejtë me periudhën koloniale. Britania e ka sunduar Azinë Jugore (Indinë Britanike), ndaj dhe për këtë arsye shumica e muslimanëve të saj janë nga Pakistani, India dhe Bangladeshi (prej rreth dy milionëve grupi më i madh i vetëm nacional është pakistanez). Marokanët dhe algjerianët janë dyndur në Francë (të parët përbëjnë rreth gjysmë milioni dhe të dytët një milion prej krejt tri milionë muslimanëve sa ka Franca). Meqë Gjermania dhe Turqia kanë patur një miqësi qysh nga Lufta I Botërore, turqit kanë shkuar në Gjermani (shumica prej një milion e gjysëm muslimanëve sa ka Gjermania janë turq). Holanda ka afro gjysmë milion muslimanë, të cilët rëndom janë prej surinami. Në Portugali, shumica e muslimanëve janë prej kolonive të mëhershme në Indi ose Francë jugore; në Spanjë ata janë prej Maroku ose Algjeri. Në Itali, ku vlerësohet të jenë afro 200 000 muslimanë, kryesisht janë prej Libie.*

Si në SHBA ashtu edhe në Evropë, idetë e etnisë lokale gjithashtu kanë ndikuar në vetëdijen e muslimanëve. Rritja e fuqisë së zezë në SHBA i ka ndihmuar krijimit të një lloj vetësigurie, identiteti, mburrësisë së fryrë në bashkësinë muslimane të atjeshme. Muslimanët zezakë si Mallkollm X dhe Muhammed Aliu në vitet 1960 janë bërë simbole të krenarisë muslimane. Kjo nuk ka ndodhur në Evropë. Atje nuk ka patur superyje pas të cilëve do të shihje turmë njerëzish. Shumica dërmuese e muslimanëve të Evropës kanë qenë marginalizuar në punët me pagë të ulët dhe ka patur pak figura intelektuale ose mediale që kanë folur në emër të muslimanëve.

Këtu duhet marrë parasysh edhe faktorin gjeo-politik. SHBA-të, në përgjithësi, janë neutrale për sa u përket muslimanëve të atjeshëm. Kështu, derisa ajo shihet si një shtet anti-Libian, anti-Iran ose, së fundi dhe mjaft famoze, anti-Irakian, në të njëjtën kohë ajo shihet si një aleat i Egjiptit, Arabisë Saudite dhe Pakistanit. Prandaj, marrëdhëniet e saj varen nga strategjia e saj gjeo-strategjike. Atje më pak shihen paragjykimet racore apo imperiale, të cilat shpesh e ngjyrosin syrin e fuqive evropiane.

Integrimi i muslimanëve në vendet perëndimore

Ekziston një ide e përgjithshme se prezenca e muslimanëve në Evropë ka filluar mbas Luftës II Botërore; kjo ide është ushqyer nga stereotipet e medias dhe polemikat raciste lidhur me muslimanët që e kanë pushtuar dhe vërsuar Evropën. Mirëpo, rrënjët e imigrimit të muslimanëve këtu, shkojnë pas shumë larg. Origjina e bashkësisë muslimane në Gjermani mbështetet në marrëdhëniet e ngushta midis Gjermanisë dhe Perandorisë Osmane përgjatë periudhave të luftës e të paqes. Madje edhe më herët, muslimanët janë vendosur në shtetet jugore të Gjermanisë pas rrethimit të dytë të Vjenës më 1683. Pas kësaj periudhe mbretërit prusianë shpesh kanë angazhuar në radhët e tyre edhe ushtarë muslimanë. Është e njëjta linjë e cila ia ka mundësuar sulltanit osman të udhëheqë ngritjen e xhamisë pranë varrezave të muslimanëve në Berlin më 1866. Prandaj, marrëdhëniet ekonomike dhe diplomatike midis Turqisë dhe Gjermanisë kanë rrënjë të thella. E njëjta pikturë vlen edhe për Francën dhe Britaninë, ku shumë imigrantë kanë mbërritur këtu gjatë shekullit XVIII. Detarë të shumtë nga Afrika dhe Azia janë vendosur në Londër dhe në porte të tjera. Ne kemi njohuri për popullimin e hershëm të jemenasve (Halliday 1992). Xhamitë e para janë hapur për këta detarë, kurse më vonë hapen xhami në Woking më 1889 dhe Liverpool më 1891. Xhamia e

* Lexuesi mund të ketë vërejtur mospërputhje të shifrave lidhur me numrin e muslimanëve në artikujt e prezentuar këtu. Kjo, mendojmë, është pasojë e viteve kur janë shkruar artikujt si dhe e mungesës së të dhënave të sakta nga ndonjë institut relevant për këtë çështje- (R. N.).

Liverpoolit nuk e mbijetoi shpërthimin e Luftës I Botërore. Në vitin 1935 xhamia e Wokingut e shpall hyrjen e saj në Islamin Sunnit (më herët ajo ka qenë e lidhur me ahmedijët). Marmaduke Picthall dhe Abdullah Jusuf Aliu, përkthimet e Kur'anit në anglisht të cilëve vazhdojnë të lexohen sot e kësaj dite nëpër gjithë botën, të dytë kanë qenë të lidhur me këtë xhami. Në vitin 1944 mbreti George VI e inauguron Qendrën Kulturore Islame në një vend pranë Regent's Parkut në Londër, në këmbim të një vendi në Kajro për një katedralë të re anglikane. Me kalimin e kohës atje do të ndërtohet xhamia kryesore e Britanisë.

Franca tregon një model akoma më të theksuar të imigrimit sesa Britania para vitit 1945. Muhammed Aliu i Egjiptit, shekullin para këtij, i ka nxitur studentët, dijetarët dhe njerëzit e biznesit egjiptianë për të shkuar në Francë. Para Luftës I Botërore imigrantë nga Algjeri, kryesisht të fisit Kabyle, janë dyndur në regjionin Marseille për të punuar në industrinë e rafinimit dhe përpunimit të vajit të ullirit. Në shenjë mirënjohjeje për këtë francezët lejuan hapjen e një xhamie në Paris më 1926. Gjatë Luftës II Botërore qeveria Vichy në vitin 1942 nga Afrika Veriore importon punëtorë për t'u ndihmuar gjermanëve në përpjekjet e tyre për luftë. Në kohën e regjistrimit të popullsisë më 1954, në Francë ka patur 200 000 algjerianë. Imigrimi në përgjithësi është bërë nga vetë qeveritë evropiane, të cilat aktivisht i inkurajonin njerëzit e kolonive të tyre të mëhershme të emigronin për në "mëmëdhe" për shkak të nevojës për punëtorë në rikonstruktimin e pasluftës. Për shembull, në Britani, në kohën e punësimit të plotë gjatë viteve 1950 ishte vështirë të rekrutoje njerëzit për të punuar në punët më të ulëta e më të rënda; për këtë shkak dhe qeveritë kërkonin t'i tërhiqnin aziatikët dhe indianët perëndimorë për në Britani me qëllim që t'u ofronin atyre punët më të këqija, ato të cilat ata nuk mund t'i mbushnin me britanikë vendorë. Kjo ndodhi gjithandej nëpër Evropë. Shpesh harrohet nga banorët vendas që muslimanët janë ftuar këtu aktualisht nga vetë qeveritë e tyre.

Shumica e këtyre imigrantëve nuk kanë patur për qëllim të qëndrojnë gjatë në Evropë. Mirëpo, shumica prej tyre vetëm se kanë mbetur. Në fillim problemet e tyre nuk ishin gjithaq të rënda. Mirëpo, në Evropë u bënë ndryshime të mëdha. U zhdukën kolonitë. Ekonomia stagnoi, kurse çmimet e naftës u rritën me të shpejtë. Çështja e racës tanimë mbeti në ajër. Vendet evropiane reagueshan duke sjellë ligje më të rrepta mbi imigrimin, prej të cilave Britania ishte e para që veprroi me Aktin për Imigrim të Komënuelthit në vitin 1962. Kjo nuk e pengoi imigrimin që të mos vazhdonte e të mos rritej edhe më. Tanimë kishte një dallim: tani po mbërrinin edhe bashkëshortet me fëmijët e imigrantëve.

Meqë qeveritë i kërkonin imigrantët vetëm për punët e tyre, ato u përpoqën ta kufizonin imigrimin kur burrat muslimanë filluan t'i sillnin me vete edhe familjet e tyre. Në këtë kohë qeveritë perëndimore i kishin arritur qëllimet e tyre dhe nuk ndjenin ndonjë përgjegjësi për copëtimin dhe shpërbërjen e familjeve muslimane si rezultat i migrimit.

Kur diskutojmë për muslimanët në Perëndim ne shpesh i harrojmë apo i mbyllim sytë para të konvertuarve 'lokalë'. Shumë evropianë dhe amerikanë janë të mahnitur me Islamin, sidomos me vijën e tij sufiste – mistike. Bashkësi të vogla, si ajo në Norwich të Britanisë, u bënë të famshme për tërheqjen e të konvertuarve britanikë të klasës së mesme. Në vitet 1970 ata tërhoqën vëmendjen e opinionit, sepse shumë prej anëtarëve të tyre ishin akademikë dhe intelektualë e disa prej familjeve me ndikim. Për çudi, këto grupe tani janë marginalizuar nga politikat muslimane shumë më të zhurmshme, agresive, të trazuara dhe etnike të viteve 1980 dhe 1990.

Çfarë mund të bëjnë muslimanët për ta provuar shansin e tyre në Perëndim? Janë dhënë disa përgjigje nga një dijetar krishter simpatik në SHBA (Poston 1991). Ai beson se pesë aksione kryesore janë vendimtare për mirëqenien dhe shtrirjen e ardhshme të Islamit në Amerikë:

1. Nevoja për të zhvilluar një lidrshp amerkan vendës: të konvertuarit amerikanë duhet shpejtë dhe me gjithë mend të trajnohen për pozitrat e lidrshp me qëllim që t'i ikin kategorizimit të Islamit si një 'kult' i huaj.

2. Imazhi stereotip negativ mbi Islamit duhet të transformohet me anë të përdorimit të përshtatshëm të medias.

3. Duhet t'u iket polemikave provokuese anti-krishtere në mënyrë që të mos shkaktojë një reaksion më të fortë ndër të krishterët (praktikues ose jopraktikues të fesë së tyre).

4. Muslimanët duhet të tentojnë të arrijnë qëllime më të realizueshme duke promovuar bashkëpunimin ndërmjet vete në vend që ta fokusojnë vëmendjen në homogjenizimin e grupeve të ndryshme etnike ndër muslimanët.

5. Muslimanët individualisht duhet të involvohen në aktivitetet e *da'ves* (mirëqenies sociale dhe thirrjes në fe) me qëllim që ta kontrollojnë dhe mposhtin ndikimin e fuqishëm asimilues të tendencës së përgjithshme amerikane.

Këto janë sugjerime praktike dhe të ndjeshme dhe shumica e muslimanëve nuk do të gjejnë në të diçka për ta diskutuar. Ndoshta shumë muslimanë mund të kenë arritur vetvetiu në këto përfundime, mirëpo si bashkësi ata akoma janë shumë larg implementimit të tyre. Përdërisa nuk e bëjnë këtë, nuk do të ndërpriten grindjet e zënkat si rezultat i pozitës së tyre minoritare.

Në mesin e llogarive të paragjykitimit, tëhuajësimit dhe ankthit, ekziston një tregim i suksesshëm i integritimit dhe harmonisë.

HYRJE NË "TENDENCAT ISLAME" NË EVROPË DHE BOTË*

Peizazhi i grupeve islame në Evropë nuk tregon drejtpërdrejtë – më së paku që mund të thuhet – ndonjë profil (përvijë) të qartë dhe veçanërisht precize. Pas kësaj shumësie grupimesh, zbulohen tendenca dhe rryma që mezi mund të identifikohen: Kush janë anëtarët e këtij grupi? Çfarë dëshirojnë anëtarët e këtij grupi? Ç'janë format e të menduarit të grupit të tretë? Disa nuk lodhen me dallimet e ngjyrosura dhe, pa kurrfarë rezerve, muslimanët i ndajnë në dy kampe: në njërin, "fundamentalistët" apo "radikalët" (të cilëve gjithsesi nuk mund t'u besohet), dhe në tjetrin, "të moderuarit / të maturit" (të cilët janë të vetmit që duhen përkrahur). Kjo skemë e dyfishtë e gjërave është e thjeshtë dhe e lehtë për përdorim, mirëpo në asnjë mënyrë nuk korrespondon me realitetin në terren që është shumë më i përbërë dhe më kompleks. Në këtë artikull ne dëshirojmë të hedhim një dritë paksa më precize dhe më të ngjyrosur mbi realitetin e këtyre tendencave ashtu si e prezantojnë ato vetveten në Evropë dhe të cilat, në një mënyrë më të përgjithësuar, korrespondojnë me dinamikat e botës islame si tërësi.

Parimet e klasifikimit

Është e domosdoshme të rikujtojmë, kur janë në pyetje rrymat islame si tërësi, se burimet e tyre janë të njëjta dhe se parimet bazë në të cilat mbështetet feja islame (përveç disa përjashtimeve të rralla) janë të pranura unanimisht. Në këtë kuptim, sipas kësaj, *Islami është një* dhe paraq et një kornizë boshtet bazë të së cilës mund të identifikohen dhe të cilat, përkundër larmisë së madhe të rrymave ose shkollave të mendimit, janë të pranueshme për të gjitha ato. Shpjegimi i kësaj larmie nuk mund të jepet thjesht duke përdorur numrin shumë, siç mund të lexojmë në disa studime të vonshme. Të ndeshur me pamundësinë e qartë për të sugjeruar një klasifikim juridik, politik apo ideologjik, ata përfundojnë duke e thjeshtëzuar çështjen me përdorimin e shprehjes "Islami" në shumë. Përdorimi i këtillë i shumësit, që ka patur për qëllim të sqarojë, ka sjellë më tepër probleme sesa në të vërtetë i ka shërbyer efektivisht qëllimit të saj: duke treguar larminë, ajo e ngatërron çdo lloj leximi të pikëpamjeve qartë të puqura mes vete dhe, në veçanti, ajo nuk thotë kurrgjë për kufijtë e dukshëm dhe shpesh precizë të pikëpamjeve divergjente. Futja e një shprehjeje pasi të kuptohet fakti i larmisë dhe i dallimeve, e cila nuk mund as t'i arsyetojë e as t'i sqarojë shkaqet apo artikulimet e tyre, në të vërtetë mund ta shpërujë shikuesin nga aspekti i vetë natyrës që e kanë pozicionet e kundërta. Prandaj, kjo metodë nuk prodhon ndonjë njohje të shëndoshë.

Na duket e domosdoshme ta theksojmë këtu një parim të qartë, në bazë të të cilit, një studim mbi tendencat e ndryshme vërtet mund ta gjejë rrugën e vet. Në qoftë se unanimisht është e pranuar se burimet e shpallura të Islamit në fakt janë Kur'ani dhe Sunneti (dy burimet bazë që nuk i konteston asnjë shkollë mendimi), atëherë është e rrugës që rrymat e ndryshme t'i hulumtojmë sipas mënyrës se si ato lidhen me këto Tekste. Kjo qasje, siç do të shohim, ka efekt më të madh sqarues, sepse ajo i hulumton pozicionet që kanë shkaktuar gjuhën dhe veprimin fetar, shoqëror ose politik. Kjo qasje në asnjë mënyrë nuk hedh dyshim mbi përkatësinë bazore ndaj Islamit të këtij ose atij grupi, por ajo mundohet t'i nxjerrë në shesh qëndrimet e tyre gjegjëse kundruall mënyrës së leximit të këtyre burimeve – statusin e Tekstit,

* Edhe ky është një artikull që autori ia ka bashkëngjitur si shtojcë librit të tij *To Be A European Muslim*, f. 237-247.

kufijtë e interpretimit, shkallën e fjalëpërfjalshmërisë, rolin e arsyes etj., që të gjitha këto janë masa të rëndësishme që i sqarojnë deklaratimet e ndryshme dhe dalluese të grupeve të ndryshme. Është e qartë se Islami është një, porse burimet tekstuale të tij e lejojnë një shumësi leximesh (edhe pse ato lexime, për të qenë të pranuar, duhet t'i respektojnë disa kriteret normative).

Është e pamundur që këtu t'i studiojmë të gjitha rrymat e mendimit një nga një. Ato janë të shumta dhe emërtimet e tyre ndryshojnë nga vendi në vend, madje emri i njëjtë mund të përfaqësojë tendenca diametrisht të kundërta varësisht se cilit kontinent i referohen. Prandaj, secili vend kërkon trajtim të veçantë, çka do ta ngatërronte e mjegullonte edhe më tepër çështjen. Për këtë arsye, ne do të kufizohemi në përvijimin (portretizimin) e veçorive dalluese të disa tendencave kryesore. Ato janë të përfaqësuara, në vende të ndryshme, nga grupe që veten e emërtojnë ndryshe-ndryshe. Megjithatë, ato kapen, në shkallë të lartë, mbas një leximi identik të Teksteve dhe, që këndeje, mbas qëndrimeve doktrinale dhe shoqërore që lindin si pasojë e atij leximi.

Gjashtë tendencat kryesore

1. *Tradicionalizmi skolastik*. Kjo është një tendencë që ka disa ndjekës në Evropë dhe e cila gjithashtu është e pranishme në regjione të ndryshme të botës islame. Referimi te tekstet e shpallura, Kur'ani dhe Sunneti, është bazor për ithtarët e kësaj rryme mendimi, me një veçori tipike se ata i referohen në mënyrë rigorozë, disa herë në mënyrë qartë përjashtuese, kësaj apo asaj shkolle juridike (hanefite, malikite, shafi'ite, hanbelite, zejditë, xha'ferite etj.); për më tepër, ata nuk i njohin vetvetes të drejtën për t'u dalluar nga mendimet juridike të ngritura brenda kornizës së shkollës që i takojnë. Kur'ani dhe Sunneti janë burime të ndërmjetësuar nga kuptimi dhe zbatimi që ia kanë bërë *ulemaja* e njohur e shkollës gjegjëse. Fusha e interpretimit të Teksteve është shumë e ngushtë dhe nuk lejon kurrfarë zhvillimi. Rryma të shumta, në këtë ose atë mënyrë, hyjnë brenda këtij tipi leximi të teksteve burimore: qofshin këta *deobandisët*, *barelvitët*, *ehli sunneti*, *talibanët* afganë apo *xhemati teblig*¹², ne ndeshemi me të njëjtin tradicionalizëm, i cili insiston në elementet bazë të adhurimit, në mënyrën e veshjes, në rregullat e zbatimit të Islamit dhe, duke vepruar kështu, në varësinë ndaj mendimit të *ulemasë* të kodifikuar, më dendur, ndërmjet shekujve VIII dhe XI. Këtu nuk kemi asgjë të *ixtihadit* ose përtërirjes në leximin e burimeve, sepse një gjë e tillë konsiderohet si e pabazë dhe si një liri e papranueshme ose "modernizim".

Lëvizjet e tradicionalizmit skolastik janë prezente në Evropë, në mënyrë të veçantë në Angli ndër muslimanët indo-pakistanezë ose në Gjermani ndër turqit. Gjithashtu, bashkësi të vogla të këtij tipi mund t'i hasish të shpërndara edhe nëpër vende të tjera. Para së gjithash ata janë të preokupuar me adhurimet (*ibadetet*) dhe nuk parashohin, brenda Evropës, ndonjë angazhim shoqëror, qoftë civil apo politik. Mënyra se si ata i lexojnë Tekstet dhe përparësinë që ia japin praktikës rreptë tradicionale i shtynë ata në shpërfilljen, madje edhe refuzimin, e çfarëdo një involvimi në shoqërinë evropiane, që është një fushë në të cilën thjeshtë ata nuk e shohin veten të aftë të marrin pjesë. Diskursin që ata e elaborojnë si dhe mësimet që i plasojnë

¹² Të jesh pjesë e kësaj tendence të madhe, nuk do të thotë se të gjitha grupet e ndryshme brenda saj janë të një mendjeje. Përkundrazi, referimi i tyre ndaj një shkolle të veçantë të mendimit juridik herë-herë i acaron qëndrimet përjashtuese dhe refuzuese *vis-à-vis* shkollave të tjera brenda të njëjtës tendencë. Kontestimet, qofshin historike apo doktrinale, mund të shkaktojnë kundërshtim të ashpër, siç ndodh me *deobanditët* dhe *barelvitët*. Këta të fundit kundërshtohen, nga pikëpamja doktrinale, me ithtarët e *xhematit teblig*, shkolla e mendimit të të cilëve bazohet në pranimin e lojaliteteve të ndryshme skolastike dhe të cilët për parim veprimi kanë shmëngien nga çështjet kundërtëhënëse dhe përqëndrimin në thelbin e adhurimeve.

mbështeten në të shenjtën, të reflektuar përmes prizmës së një leximi tradicional të parimeve juridike të një shkolle të dhënë ose të pranuar.¹³

2. *Tradicionalizmi "selefit"*. Kjo rrymë shpesh ngatërrohet me atë para kësaj, edhe pse dallimet midis këtyre dyjave janë të konsiderueshme. Përkundër tipit të parë, tradicionalistët "selefit" në qasjen dhe leximin e Teksteve, e refuzojnë ndërmjetësimin e shkollave të së drejtës dhe të *ulemasë* të cilëve u referohen ato. Ata e quajnë veten "selefij", ngase janë të angazhuar në ndjekjen e "selefit", që është një titull i cili u është dhënë shokëve të Muhammedit a.s. dhe muslimanëve të devotshëm të tri gjeneratave të para të Islamit. Interpretimi i Kur'anit dhe Sunnetit bëhet në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe shkon jashta kufizimeve që i kanë vënë shkollat juridike. Ajo çka e dallon tradicionalizmin e kësaj rryme është karakteri *literalist* i qasjes së tyre i cili, duke insistuar në referimin ndaj Teksteve, ndalon çdo lloj leximi interpretativ. Kjo shkollë e mendimit është pasardhëse e drejtpërdrejtë e atyre që, shumë më herët, janë quajtur *ehlul-hadith* dhe të cilët i kanë kundërshtuar interpretimet e mbështetura në kërkim të qëllimit apo synimit (*kasd*) të ndonjë porosie apo urdhri, që është një qëndrim i karakterizuar si *ehlur-re'j*.¹⁴

"Selefijtë" në të gjitha rrethanat insistojnë në domosdoshmërinë e referimit të Teksteve dhe në besueshmërinë e tyre, të cilat i citojnë sa herë kur duhet ta arsyetojnë këtë apo atë qëndrim a veprim, si në çështjet e adhurimit po ashtu edhe në ato të veshjes apo të jetës shoqërore. Vetë Teksti, në formën dhe kuptimin e tij literal (të fjalëpërfjalshëm), patjetër duhet të ndiqet dhe nuk mund të bëhet lëndë interpretimi i cili, sipas natyrës së tij, të shpie në gabim dhe në risi (herezi, *bid'at*).¹⁵

E lidhur vazhdimisht pas disa *ulemave* të përqëndruar kryesisht në Arabinë Saudite, në Jordan, në Egjipt dhe në Siri (dhe e lidhur, të shumtën e herave, pas ish studentëve të institucioneve të tyre të respektuara arsimore), qëndrimi doktrinor i *tradicionalistëve "selefit"* dhe i grupeve të tyre në Evropë është refuzimi i çfarëdo lloj involvimi në hapësirat që konsiderohen si joislame. Konceptet e *Darul-kufrit* ose *Darul-harbit*¹⁶ mbeten edhe më tej validë dhe e shpjegojnë relacionin e "selefijve" me ambientin e tyre shoqëror, i cili para së

¹³ Në botën islame këto lëvizje përgjithësisht nuk marrin pjesë në politikë. Në shumicën e vendeve muslimane ata e njohin autoritetin e qeverive ekzistuese dhe nuk u paraqiten si "opozitë". Ata mund të konsiderohen, në terminologjinë politike, si "konzervativë". Mbetet fakti se disa rryma të tipit skollistik tradicionalist kanë demonstruar, në disa situata të trazirave shoqërore, involvim përcaktues politik. Në të shumtën e herave kjo ka qenë e kufizuar në raste dhe rrethana të veçanta (në Pakistan, në Indi, në Turqi dhe në disa regjione të Afrikës). Rasti i *talibanëve* afganë është i rëndësishëm ngase, sipas mendimit të gjithë specialistëve, asgjë nuk i ka paracaktuar këta nxënës që të involvohen, siç kanë vepruar, në rrafshin politik: ata janë nxitur dhe ftuar të veprojnë kështu nga ana e Pakistanit (me pëlqimin dhe përkrahjen e SHBA-ve dhe të Arabisë Saudite).

¹⁴ Shumë herët janë paraqitur dy tendenca ndër as'habët si rezultat i ndikimit të dy figurave eminente të kësaj periudhe: Abdullah bin Omeri, i cili përgjithësisht u ka ikur interpretimeve personale dhe Abdullah bin Mes'udi, i cili gjerësisht e ka përdorur mendimin personal në qoftë se nuk ka mund të gjejë përgjigje ose rregull të qartë në Kur'an dhe në Sunnet. Më vonë këto dy qëndrime do t'i hasim ndër dijetarët (*ulema*) dhe shkollat e mendimit (*medhahib*): ata janë të njohur me emrat *ehlul-hadith* (të vendosur në Medine) dhe *ehlur-re'j* (të vendosur në Kufë të Irakut).

¹⁵ Në botën islame, kjo rrymë në radhët e saj përfshinë *ulemanë* që gëzon respekt të lartë në shkencat islame (sidomos në shkencat e *hadithit*), dijetarë autoritativë si el-Albanin, Ibni Uthejminin dhe Ibni Bazin, të njohur e respektuar anëmbanë botës për gjerësinë dhe ngurtësinë e diturive të tyre. Në rrafshin politik ata e tregojnë të njëjtin qëndrim konservativ sikurse edhe tradicionalistët e tjerë: ata pa kurrfarë kundërshtimi e pranojnë autoritetin qeveritar, çfarëdo qoftë ai, sepse është "islamik". Ata refuzojnë t'i përdorin termat si "zgjedhje", "parlament" apo "demokraci", nga arsyeja se janë terma që nuk hasen as në Kur'an e as në Sunnet. Duke refuzuar të involvohen në fushën e politikës, ata shpesh i shërbejnë, me ose pa vetëdije, legjitimitetit të qeverisë aktuale, sepse literalizmi dhe argumentet e tyre nuk kanë kurrfarë përmbajtje konkurruese politike.

¹⁶ Në historinë e hershme të Islamit, disa *ulema* kanë vizatuar një gjeografi specifike të botës, duke e ndarë *Darul-Islam*-in (shtëpia, territori islam) prej atyre që nuk kanë qenë nën pushtetin islam, të quajtur *Darul-Harb* (shtëpia, territori i luftës), duke theksuar se për muslimanët nuk është e mundur të jetojnë në *Darul-Harb*, përveç se në disa rrethana lehtësuese.

gjithash identifikohet me ndarjen dhe me praktikimin e fesë që është literalist dhe i mbrojtur nga ndikimet kulturore të Evropës.

3. *Reformizmi "selefî"*. "Selefijtë" reformistë me "selefijtë" tradicionalistë e ndajnë prirjen për t'iu shmangur kufijve që i kanë vënë shkollat juridike me qëllim që ta zbulojnë energjinë e pastër të një leximi të drejtpërdrejtë të Kur'anit dhe Sunnetit. Prandaj, edhe këta lidhen me "Selefîn", muslimanët e gjeneratës së parë të Islamit, me qëllim që t'iu shmangen komentimeve që u japin autoritet të vetëm interpretimeve që datojnë nga shekujt VIII - X. Megjithëkëtë, ajo çka i dallon këta prej tradicionalistëve – përkundër faktit se edhe këta insistojnë në domosdonë e referimit të Teksteve – është se këta tregojnë prirje për një lexim të mbështetur në qëllimet dhe synimet e së drejtës dhe të shkencës së të drejtës (*fikh*). Shumë të afërt nga ky aspekt me shkollën e *ehlur-re'jit*, këta konsiderojnë se praktika e *ixhtihadit* është një postulat objektiv, i vazhdueshëm dhe i domosdoshëm për zbatimin e *fikhut* në çdo epokë dhe në çdo vend.

Shumica e rrymave reformiste "selefite" prezente në Evropë janë paraqitur nën ndikimin e mendimtarëve reformistë të fundshekullit XIX dhe gjysmës së parë të shekullit XX, të cilët kanë gëzuar emër të madh në botën islame. Emrat më të njohur janë Xhemaluddin el-Afgani, Muhamed Abduhu, Reshid Rida, Said en-Nursi, Muhammed Ikbali, Ibni Badis, Hasan el-Benna, el-Fasiu, Malik bin Nebi, Ebul A'la el-Mevdudi, Sejjid Kutb dhe Ali Sheriati. Kësaj liste duhet shtuar edhe emrat e atyre që kanë patur ndikim të kufizuar në nivel kombëtar. Gjithashtu duhet theksuar se këta reformistë nuk i kanë ndarë të njëjtat mendime në të gjitha çështjet. Është e pamundur që këtu t'i demonstrojmë dallimet e tyre, mirëpo ajo që i bashkon ata është, qartazi, lidhja tejet dinamike me burimet e shpallura dhe dëshira e vazhdueshme për përdorimin e arsyes në trajtimin e Teksteve me qëllim që të kihen parasysh sfidat e reja të epokës së tyre si dhe zhvillimi shoqëror, ekonomik dhe politik i shoqërive.

Arritja në Evropë e intelektualëve reformistë "selefij" ka pasuar menjëherë mbas represioneve që kanë ndodhur pas pavarësimit, si në Egjipt ose Siri me Vëllezërit Muslimanë (në vitet '60 dhe '70) ose, më vonë, duke i ndjekur ngjarjet e tjera të politikës lokale si në Tunizi me lëvizjen *en-Nahdah*, në Marok me lëvizjen *el-Adl ve'l-Ihsan*, ose në Algjeri, ndër të tjerat, me ihtarët e *el-Xhez'era* ose me Vëllezërit Muslimanë. Ajo që është fshehur pas këtyre ndikimeve, ashtu siç ka ndodhur me të tjerët e botës islame si tërësi, ka shkaktuar paraqitjen e dy rrymave të ndryshme. E para, në traditën legaliste të reformistëve "selefij" më të famshëm, është ndjekja dhe përshtatja e reformizmit në kontekstin evropian. Shkolla origjinale e mendimit vazhdon të jetë pikë referimi në atë se qasja metodologjike ndaj Teksteve mbetet e hapur për mundësinë e interpretimit dhe kërkon zbatimin e domosdoshëm të *ixhtihadit* për t'iu përgjigjur konteksteve të reja të jetës. Megjithëkëtë, besnikëria ndaj mendimit dhe metodologjisë reformiste, tani e tutje mjaft e përhapur, domosdo nuk nënkupton ndonjë lloj të përkatësisë së strukturuar – mendimet e formuluar kanë shkuar përtej autoritetit të këtij ose atij grupi apo organizate. Ky mendim është zhvilluar në masë të madhe në Evropë dhe, në të vërtetë, më saktësisht në këtë aspekt i ka mbetur besnik frymës origjinale reformiste. Ai ka prirje ta mbrojë identitetin e vet musliman dhe praktikën e adhurimit, ta njohë kornizën kushtetuese të Evropës, të involvohet në rrjetin shoqëror si qytetar dhe të jetojë në besë të sigurtë me vendin të cilit i takon. Mendimi reformist "selefij" është mjaft i shpërhapur në Perëndim dhe shumë grupe të mëdha janë të ndikuara nga mënyra e tij e leximit të Teksteve, të cilën ata e huazojnë dhe adaptojnë si të nevojshme dhe me iniciativë.¹⁷

¹⁷ Në botën islame, lëvizjet legaliste reformiste "selefije" janë të angazhuara në fushën politike dhe më shpesh si opozitë. Shumica e mbrojnë idenë e një shoqërie islame shembullore e cila i respekton burimet islame – sidomos, në planin shoqëror e politik, një shtet të bazuar në të drejtën, në pluralizmin politik, në parlamentarizmin, në zgjedhjet me të drejtë të votimit të përgjithshëm – pa mos kuptuar me këtë ndonjë lloj nënshtrimi ndaj modelit perëndimor. E kanë shpallur për çështje parimi "luajtjen e lojës" së legalitetit institucional. Ata, pak a shumë kudo, edhe pse në përmasa të ndryshme, u nënshtrohen arrestimeve, torturave

4. *Selefijtë politikë dhe literalistë*. Kjo është rryma e dytë e asaj që folëm më lart dhe është rezultat i represionit të tërbuar në botën islame: në fillim të lidhur pas shkollës legaliste reformiste, disa nga *ulemaja* dhe intelektualët kanë kaluar në angazhimin politik të ashpër dhe përjashtues (derisa kanë qenë akoma në botën islame). Nga reformizmi ata nuk kanë mbajtur asgjë përpos konceptit të veprimit shoqëror dhe politik të cilin e kanë shkruar në leximin literalist të Teksteve me një trashëgimi politike, që ka të bëjë me organizimin e pushtetit, hilafetin, autoritetin, të drejtën etj. E gjithë kjo ka shkaktuar një përzierje komplekse të drejtuar kah veprimi radikal revolucionar – kjo kishte të bënte me opozitën ndaj qeverive, madje edhe në Evropë, me luftën për krijimin e "Shtetit islam" dhe përfundimisht të Hilafetit. Diskursi i tyre është i ashpër, i politizuar, radikal dhe kundërshtues i çdo lloj termi të involvimit bashkëpunues në shoqëritë evropiane, diçka që më tepër do të dukej si tradhti. Lëvizjet *Hizbut-tahrir* dhe *el-Muvahhidun (Vehhabij)* janë më të njohurat e këtij lloji në Evropë. Ata thirrin në *xhihad* dhe kundërshtim me çdo mjet ndaj Perëndimit (të cilin gjithnjë e konsiderojnë si *Darul-harb*, territor lufte). Këto rryma, të cilat zgjojnë mjaft interesim publik, megjithëkëtë përfaqësojnë më pak se 0.5 % të popullatës muslimane të banuar në Evropë.¹⁸

5. *Reformizmi "liberal" (apo racionalist)*.¹⁹ E lindur nga ndikimi i mendimit perëndimor gjatë periudhës së kolonizimit, shkolla reformiste e quajtur "liberale" apo "racionaliste" ka përkrahur zbatimin në botën islame të sistemit të organizimit shoqëror e politik, i cili është paraqitur nga procesi i sekularizimit që ka ndodhur në Evropë. Liberalët kanë mbrojtur, për shembull programi i Mustafa Kemal Atatürkut lidhur me sekularizimin e Turqisë, madje edhe ndarjen definitive të sferës së autoritetit fetar nga organizimi i jetës publike dhe politike. Në Evropë, përkrahësit e reformizmit liberal e favorizojnë integrimin asimilues të muslimanëve, duke pritur me këtë rast adaptimin e plotë në mënyrën e jetesës evropiane. Ata nuk ngulin këmbë në praktikimin ditor të fesë dhe e mbajnë qenësisht vetëm dimensionin e saj shpirtëror të jetuar në mënyrë individuale dhe në vetvete, ose, në vend të kësaj, e ruajnë lidhshmërinë me kulturën në të cilën kanë lindur. Shumica prej tyre e kundërshtojnë çfarëdo manifestimi të veshjeve dalluese, çka e konsiderojnë për sinonim të izolimit ose madje edhe të "fundamentalizmit". Duke e patur parasysh evoluimin e shoqërive, Kur'ani dhe Sunneti sipas tyre nuk mund të jenë më kornizë autoritative referimi për normat e sjelljes, ndaj është arsyeja e aplikuar ajo që duhet t'i përcaktojë kriteret e sjelljes shoqërore. Sipas kësaj, termi "liberal" i kthehet pas kuptimit që kjo fjalë e ka fituar në botën perëndimore dhe e cila i jep përparësi racionalitetit dhe mbështetet në epërsinë e individit.²⁰

dhe persekutimeve. Pozita e grupeve të ndryshme ndryshon sipas historisë së shoqërive në të cilat ato veprojnë.

¹⁸ Lëvizjet radikale politike ekzistojnë në botën islame dhe janë, thuajse kudo, grupe të vogla. Ata e tërheqin kërshërinë e mediave nëpërmjet akcioneve të tyre sensacionale dhe të dhunës.

¹⁹ Këtu e kemi zgjedhur emrin të cilin ithtarët e kësaj rryme e përdorin për ta definuar veten në Perëndim. Në botën islame, termat më shpesh të përdorur janë *'almanijun* (rrënja e së cilës shënon idenë e të qenit esencialisht i lidhur pas organizimit të punëve të kësaj bote, duke u distancuar kështu prej çfarëdo inspirimi nga Tekstet apo nga feja), ose *'ilmanijun* (rrënja e së cilës i referohet dimensionit shkencor të lëvizjes, duke nënkuptuar një lloj *scientizmi* të mbështetur në një qasje pastër racionaliste në trajtimin e punëve kolektive). Të dy këto koncepte në gjuhën arabe përdoren për ta përkthyer idenë e sekularizimit. Kundërshtarët e kësaj tendence këta i emërtojnë me emra të ndryshëm që shprehin, në përmasa të ndryshme, idenë se ky lloj i "reformizmit racionalist" në fakt është prodhim i perëndimimit të mendimit.

²⁰ Reformistët liberalë janë pakicë në botën islame, herë ndodhen në qeveri e herë në opozitën majtiste. Ata kanë shumë "agjenci" në Evropë ku shpesh prezantohen si të vetmit demokratë të vendeve islame. Arsyeja për këtë kryesisht është fakti se artikulimi i diskursit të tyre është i kuptueshëm drejtpërdrejtë dhe i pranueshëm për veshët e Perëndimit, ngase ata i përkrahin pikat dhe linjat e referimit që janë të njohura për Perëndimin. Realiteti i qëndrimeve të tyre demokratike mbetet të provohet, ngase disa reformistë të quajtur "liberalë" nuk kanë nguruar të mos i përkrahin regjimet diktatoriale si në Siri, në Tunizi ose "shfarosësit" (krahu i juntës udhëheqëse ushtarake) në Algjeri. Megjithëkëtë, preteksti për luftimin e "fundamentalizmit" (i cili, sipas

6. *Sufizmi*. Nuk guxojmë t'i anashkalojmë nga peizazhi evropian rrymat sufiste. Në të vërtetë ato janë të shumta dhe shumë të ndryshme. Pa marrë parasysh nëse ata i takojnë *tarikatis* (shum. *turuk*) *Nakshibendi*, *Kadiri*, *Shadhili* apo të ndonjë tjetri prej shumë sosh, qarqet sufiste qenësisht janë të orientuara kah jeta shpirtërore dhe njohja mistike. Kjo nuk nënkupton se ndjekësit (*murid*) e tyre nuk angazhohen në ndonjë veprimtari shoqërore apo bashkiake; në të vërtetë, e kundërta e kësaj ndodh shumë më shpesh. Tekefundit, para së gjithash bëhet fjalë për përparësitë e shpërndara në forma të ndryshme: tekstet e shpallura kanë një kuptim të thellë që kërkon, sipas mësimave sufiste, kohë për reflektim meditativ dhe për përvetësimin e tyre. Kjo është thirrje për një jetë të brendshme, larg agjitimeve dhe përçarjeve. Teksti këtu është burim final, sepse ai është rruga drejt përkujtimit (*dhikr*) dhe afrimit (*takarrub*): kjo është e vetmja rrugë drejt përjetimit të afërsisë. *Tarikatet* janë qarqe kërkimi pak a shumë të organizuara në vetvete me një hierarki të veçantë që arrihet nga ndjekësit e deri te udhërrëfyesi (*shejh*). Secili rend sufist ka modelin e vet të veçantë të veprimit.

Gjithashtu duhet të theksojmë se në Evropë ekzistojnë edhe disa vëllazëri që janë shumë të organizuara dhe drejtpërdrejt të lidhura me sistemet vëllazërore në Azi dhe Afrikën Veriore e Perëndimore. I njohur është, për shembull, kapaciteti organizativ i *muridëve* apo i *tixhanive*, të cilët veprojnë të shumtën e kohës brenda një qarku të mbyllur, por të cilët megjithëkëtë mbajnë një rrjet shumë efektiv, brenda atij qarku, për përkrahje dhe solidaritet në Evropë dhe SHBA.²¹

Ky raportim mbi tendencat kryesore të Islamit bashkëkohor është larg të qenët i plotë dhe i thelluar, mirëpo shpresojmë të ketë meritën e kthjellimit të skenës duke i demonstruar disa nuanca, përkundër leximit të tejthjeshtëzuar me kundërvënien dyjare të "liberalëve" kundër të gjithë të tjerëve – "fundamentalistëve", "radikalëve" etj. Situata është shumë më e komplikuar se kjo, kurse kufijtë shumë më të hollë: këto tendenca sigurisht që rrënjët e tyre i kanë në histori, mirëpo, para së gjithash, ato i kanë në mënyrat e tyre të veçanta të të kuptuarit të burimeve të shpallura. Për tradicionalistët skolastikë, për selefijtë tradicionalistë dhe për selefijtë e politizuar e radikalë, Tekstet, qoftë Kur'ani, Sunneti apo mendimet e dijetarëve të mëdhenj, nuk lejojnë kurrfarë interpretimi apo shtrembërimi. Arsyeja është e nevojshme për ta kuptuar Tekstin, e jo edhe për ta determinuar qëllimin e tij. Për selefijtë reformistë, Teksti sigurisht që mbetet pikë referimi, mirëpo arsyes, duke u mbështetur në rregullat e deduktimit dhe përfundimit logjik (*istinbat*), i lejohet, duke e ushtruar *ixhtihadin*, një liri e konsiderueshme për interpretim dhe shtjellim. Në anën e kundërt të pozitive të fiksuara doktrinale, reformizmi liberal, përparësi i jep përpunimit racional ku roli parësor i teksteve të shpallura është të sigurojë një orientim shpirtëror dhe rregulla të gjera etike, por gjithnjë në planin personal-individual (duke e reflektuar rolin e teksteve fetare *vis-à-vis* jetës shoqërore e politike ashtu siç është zhvilluar në Perëndim).


Dallimet që i përshkruajmë më lart, varësisht prej modelit të referimit ndaj "Teksteve / arsyes", mund të paraqiten në formë diagrame si më poshtë:

mënyrës së të menduarit të tyre, i mbulon të gjitha tendencat e tjera përveç të tyre) nuk mund ta arsyetojë aleancën e tyre me despotizmin.

²¹ Qarqet sufiste praktikisht janë apolitike në Evropë dhe të këtilla janë tiparet e tyre dalluese edhe në botën islame. Megjithëkëtë, kjo vërejtja e fundit duhet të modifikohet në masë të madhe sipas faktit se *tarikatet* sufiste shpesh kanë qenë, në ish Bashkimin Sovjetik dhe në Turqi, bastion (fortifikatë) i rezistencës së zjarrtë politike ndaj pushtimeve dhe shtypjeve koloniale. Sufijtë shpesh kanë qenë ithtarë të të ashtuquajturit Islam "paralel", që kanë refuzuar t'i binden autoritetit qeveritar me qëllim që ta ruajnë besimin e vërtetë të ndryshëm prej kompromiseve të pranuar nga ato personalitete fetare të paguara nga qeveria dhe të cilët e përfaqësonin "Islamin zyrtar".

-- Relacioni ndaj teksteve të shpallura --
Selefitët skolastikë - Tradicionalizmi politik

-- Relacioni ndaj përpunimit racional --
Reformizmi selefit - Reformizmi liberal



Diagrami 1: Tendencat kryesore islame dhe relacionet e tyre me Tekstet dhe arsyen

KAPITULLI II

ISLAMI DHE MUSLIMANËT NË ZVICËR

MUSLIMANËT NË ZVICËR*

Në referatin tim dëshiroj të raportoj mbi Islamin dhe muslimanët në Zvicër duke mos pretenduar se do të jem i plotë, nga arsyeja se njëherit do të përqëndrohem kryesisht në Zvicrën gjermanofone.

Dëshiroj të filloj me një pasqyrim të shkurtër të përmbajtjes së referatit tim. Atë, në thelb, e kam ndarë në katër pjesë. Do të filloj me një shkëputje të shkurtër historike, e cila do të na sjellë deri në ditët e sotme. Në pjesën e dytë do të hyj paksa më gjerësisht në format e organizimit të muslimanëve në Zvicër. Në pjesën në vazhdim do të merrem disi me praktikën e jetës islame në Zvicër: cilat janë problemet në sferën private dhe publike me të cilat ne muslimanët ballafaqohemi gjithnjë. Këtu nuk do të hyj fort në detaje. Përmbyllja paraqet kryesisht një vështrim të vogël mbi ardhmërinë e mundshme të muslimanëve në Zvicër.

1. Historiku i Islamit dhe muslimanëve në Zvicër

Kush do të kishte menduar se Islami qysh para më se 1000 viteve është paraqitur për herë të parë në Zvicër? Këtë dëshiroj ta dëshmoj me disa shembuj të zgjedhur nga historia. Sa për fillim, diçka lidhur me termin 'saracen', i cili gjithnjë na del përpara në këtë kontekst. Kur bëhet fjalë për saracenët, burimisht nënkuptohet një popull që banonte në Arabinë veriperëndimore dhe në Gadishullin e Sinaït. Në Mesjetë, me termin 'saracenë' përgjithësisht emërtoheshin pushtuesit arabë. Pastaj filloi të përdoret për të gjithë muslimanët, përfshirë edhe turqit.

Pikërisht me këta saracenë do të ndeshemi kur t'i hyjmë gjurmimit të historisë së zhvilluar në tokat zvicerane. Lidhur me këtë jo moti është botuar një libër që bart titullin *Die Sarazenen durchqueren die Alpen* (Saracenët i tejkalojnë Alpet) të autorit Jean-Pierre Sandoz. Disa nga faktet që unë do t'i theksoj në këtë kontekst, burojnë nga ky libër.

Në fillim duhet të përkujtojmë se kur bëhet fjalë për saracenët që e vizituan Zvicrën, në fakt duhet nënkuptuar maurët berberë, gjegjësisht muslimanët e Andaluzisë të cilët i përkisnin racës berbere të Afrikës Veriore. Për saracenët raportohet se ata para së gjithash kanë qenë vjedhës, plaçkitës e kusarë që i pritnin njerëzit në pusi. Që në vitin 936 të llogaritjes krishtere të kohës, pra aty kah viti 324 hixhri, sipas llogaritjes islame të kohës, raportohet për pushtimin e Bistumit të Kurit (Chur), me ç'rast duhet të jetë shkatërruar selia e ipeshkvisë dhe një pjesë e Graubindes të ketë rënë nën sundimin e saracenëve. Edhe në Wallis saracenët qysh herët paraqiten në skenë. Në vitin 940 është plaçkitur abacia Saint-Maurice në luginën Rhône.

Njohësit e Wallisit, në veçanti të luginës së Saasit, duhet ta njohin Allalinhornin. Konsiderohet që edhe ky emër ka prejardhje muslimane, që në të vërtetë rrjedh prej fjalës arabe 'al-ain', që ka kuptimin 'burim, gurrë, krua'. Në rrëzë të Allalinhornit shtrihet fshati Saas Almagell. Edhe kjo konsiderohet se ka prejardhje arabe: 'al-mahall', që ka kuptimin 'vend, vendbanim, mëhallë, lagje'. Ky është fshati më i lartë në luginën e Saasit, ndaj dhe me siguri ka qenë qendër e saracenëve, në njëfarë mase ka qenë një rrip midis Italisë dhe Zvicrës.

* Kjo ligjëratë është mbajtur me rastin e Kongresit I të MMS-së (Muslime, Musliminnen der Schweiz), më 3 dhjetor 1995, në hotelin Spirgarten në Zürich.

Diçka më i njohur është lokaliteti Pontresina. Ai për herë të parë paraqitet në analet e historisë në vitin 1139 dhe përsëri lidhur me saracenët, të cilët asokohe mbase do ta kenë plaçkitur. Ky qëndrim hidhet poshtë si qesharak nga disa historianë, p.sh. nga Victor Stupan në librin e tij *Pontresina*. Sidoqoftë, në këtë kontekst për ne me rëndësi është që të mbajmë mend se vërtet në këto vise kanë qëndruar muslimanët.

Në shek. XVIII Zvicra përsëri na paraqitet në kontekst me Islamin, në të vërtetë me personalitetin e Johann Ludwig Burckhardt-it, i cili rrjedh nga një familje e vjetër dhe e njohur fisnike e Baselit dhe i cili në vitet 1809-1816 me emrin 'Shejh Ibrahim' dhe me porosi të Shoqatës Londinezo-Afrikane ndërmerr një ekspeditë kërkimore-shkencore në Siri, Arabi, Egjipt dhe Nubi.

T'i kthehemi tani historisë më të re. Kah fundi i viteve 1940 në Zvicër vijnë turqit e parë. Këtu bëhet fjalë para së gjithash për elitën e atëhershme të cilët u shkolluan nëpër shkolla të larta të këtushme, pjesërisht me përkrahje shtetërore. Pas përfundimit të studimeve shumica prej tyre u kthyen përsëri në Turqi, shumë pak mbetën këtu.

Në fillim të viteve '60 deri kah mesi i të 70-tave ndodh ardhja kryesisht e 'gastarbeiterëve' (punëtorëve mysafirë) turq, të cilët pasi i tërheqin me vete edhe familjet e tyre, vendosen në Zvicër për një kohë më të gjatë. Edhe pse shumica prej tyre në fillim planifikonin të qëndronin këtu vetëm 2-3 vjet, mirëpo tani në ndërkohë janë bërë, jo rrallë, edhe nga 30 vjet.

Në bazë të regjistrimit të popullsisë të vitit 1990, numri i muslimanëve në Zvicër sillet rreth 152 000, prej të cilëve rreth 7 700 ishin me origjinë zvicerane. Nga disa njohës vlerësohet se në ndërkohë kjo shifër është rritur diku deri në 200 000, që paraqet një pesëfishim që nga viti 1970.

Si shpërndahen muslimanët në Zvicër shikuar nga aspekti gjeografik? Në pjesën gjermanishtfolëse të Zvicrës kryesisht gjenden muslimanë nga Turqia dhe ish Jugosllavia. Kjo shihet nga fakti se shumica e xhamive, larg njëra-tjetrës në këtë regjion, janë në duar të turqve. Në pjesën frankofone janë arabët nga Afrika Veriore dhe Lindja e Afërt, kurse në Tessin banojnë relativisht pak muslimanë. Lidhur me këtë duhet shënuar se edhe te ne muslimanët ekziston një lloj hendeku ndërmjet Zvicrës gjermanofone dhe asaj frankofone. Edhe ndër muslimanët e Zvicrës, një vijë ndarëse e imagjinuar kalon aty diku përmes Bernit. Nga njëra anë, kjo është rezultat i prejardhjes së ndryshme të muslimanëve, e nga ana tjetër edhe nga barriera gjuhësore. Muslimanët nga Afrika Veriore flasin frengjisht dhe një arabishtë komike – ashtu siç dëshiroj ta formuloj unë këtë. Turqit e Zvicrës gjermanofone edhe pas tridhjetë viteve pothuajse nuk e flasin gjermanishten, e të mos bëjmë fjalë për arabishten apo frengjishten.

2. Format e organizimit të muslimanëve

Në kuadër të kësaj kumtese natyrisht është e pamundur të shkohet në detaje e të trajtohen të gjitha bashkësitë islame. Prandaj, këtu dëshiroj t'i prezantoj vetëm institucionet më të rëndësishme, ku gjithashtu do të kufizohem në Zvicrën gjermanofone, pasi atë e njoh më së miri. Në fillim dua të cek se te muslimanët vendi i zakonshëm për takim është xhamia (arab. *mesxhid*). Në bazë të origjinës, xhamia nuk ka qenë vend vetëm për t'u falur e lutur, por edhe shkollë, universitet, spital ku kanë gjetur përkujdesje shpesh edhe të sëmurët mentalë, pastaj kuzhinë për të varfërit etj. Tani kjo shumëllojshmëri për fat të keq nuk haset më në vendet muslimane, e jo se jo këtu në Evropë. Në Zvicër shfrytëzohen shumë më tepër se 100

lokale si xhami,* prej të cilave vetëm në Zürich mbi 10, "në qytetin më të madh islam në Zvicër" – citat i Peter Wittwerit, ish udhëheqës i Qendrës koordinuese ndërqytetare për çështje të të huajve.

Si formë juridike e organizimeve në të shumtën e rasteve zgjedhet shoqata, sepse e drejta mbi shoqatat në Zvicër është shumë liberale. Shoqatat mund të themelohen e të shpërbëhen pa marrë vesh kush tjetër përpos të pranishmëve. Ngandonjëherë ndodh që shoqata të regjistrohet në regjistrin tregtar, mirëpo kjo paraqet një përjashtim të rrallë. Krahas shoqatave ndonjëherë për formë organizimi zgjedhet edhe fondacioni, ndërsa shoqëria / kooperativa, që te zvicëranët është një formë shumë e preferuar për ndërmarrjet vetëfurnizuese, te muslimanët është praktikisht e panjohur. Financimi bëhet kryesisht nga kontributet e anëtarëve dhe nga dhuratat. Kjo ndodh edhe me shoqatat proqeveritare. Vetëm në raste të jashtëzakonshme xhamitë financohen nga qeveritë (p.sh. xhamia e Gjenevës).

Përveç xhamive ekzistojnë edhe të ashtuquajturat *tarikate*, d.m.th. rende islame, që edhe në Zvicër janë aktive. Për shembull i këtillë është tarikati që udhëhiqet nga Shejh Nazim el-Kibriusi si dhe *tarikati Nakshibendi*, që i takon njërit prej tarikateve më të vjetra sufite, mistike islame. Karakteristike për këto tarikate është se në të shumtën e rasteve ato përqëndrohen rreth një personi, rreth udhëheqësit të tarikatit të quajtur *shejh*, dhe në bazë të orientimit të tyre mistik ushtrojnë një forcë të madhe tërheqëse të rinjtë evropianë. Në prezentimet e mia unë nuk do të hyj më thellë në këto forma të shoqërizimeve islame, nga arsyeja se depërtimi te to edhe për ne muslimanët nuk është gjithnjë aq i thjeshtë.

Për t'u kthyer në xhamitë "e zakonshme", mund të bëjmë një ndarje të përgjithshme të institucioneve të ndryshme në bazë të kriterëve vijuese: ndarje në bazë të nacionalitetit ose përkatësisë etnike dhe një shkallë më poshtë në bazë të bindjeve politike. Shumica e shoqatave dhe fondacioneve janë pak a shumë në kontakt të ngushtë me lëvizjet në vendlindje. Të këtilla janë p.sh. *Fazilet Partisi* (Partia e virtytit) e turqve dhe *Ihvanul Musliminët* (Vëllezërit muslimanë) tek arabët. Këtu duhet bërë dallimin midis shoqatave të cilat fuqishëm angazhohen politikisht dhe atyre që deklarohen si apolitike dhe që kufizohen në sferën private të jetës islame. Me këtë rast nuk do të futem më thellë në shumëllojshmërinë e organizatave islame. Kjo do t'i kalonte kufijtë e këtij raporti. Unë dua që me këtë rast të shënoj qartë se pikërisht xhamitë turke që pandehen si apolitike, në të vërtetë janë politike. Në të shumtën e rasteve këto shfrytëzohen nga qeveria turke për ta propaganduar Islamin shtetëror të Turqisë. Për fat të keq, midis xhamive të lëvizjeve të ndryshme shpesh edhe nuk ekzistojnë gjithaq kontakte. Përkundrajt kësaj, me kalimin e kohës janë krijuar edhe organizata ombrellë (kulmore), të cilat i shtjellojnë problemet që janë të përbashkëta për të gjithë muslimanët në Zvicër. Për këtë më shumë do të ndalem në pjesën e tretë të referatit tim. Që në vitin 1989 është themeluar "Gesellschaft der islamischen Organisationen in der Schweiz" (Shoqata e organizatave islame në Zvicër), shkurtimisht GIOS. Ajo në fillim numëronte nja 25 organizata të drejtimeve të ndryshme dhe nuk ndiqte qëllime politike. Qëllimi i saj ishte që gjeneratës së dytë e të tretë të emigrantëve muslimanë t'u ofrojë mundësinë e edukimit islam në gjuhën gjermane. Nga ana tjetër, kjo ishte si një adresë e parë për organizatat që kishin probleme me organet shtetërore. Ndoshta keni vërejtur se unë jam shprehur gjithnjë në kohën e kaluar. Kjo ka natyrisht arsyen e vet, ngase kohëve të fundit në GIOS nuk lëviz gjë.

Në vitin 1994, pavarësisht prej GIOS-it u themelua MMS-ja (Muslime, Musliminnen der Schweiz – Muslimanët dhe muslimanet e Zvicrës). Pastaj do të veçoja edhe "Dachverband der islamischen Gemeinden in Zürich" (Lidhja kulmore e bashkësive islame në Zürich), që u

* 10-15 viteve të fundit dukshëm është shtuar edhe numri i xhamive shqiptare, diku mbi 45 xhami; pastaj ato boshnjake dhe të muslimanëve që flasin gjuhën maqedone, etj. – (R. N.).

themelua në tetor të vitit 1995 dhe së cilës i takojnë të gjitha Bashkësitë islame të Zürichut. Kjo lidhje paraqitet si përfaqësuese e muslimanëve të Zürichut në raport me qytetin dhe kontraktin me të për ngritjen e një qendre të madhe islame në Zürich si dhe zgjidhjen e problemit të varrimit. Lidhje të ngjashme kulmore ekzistojnë edhe nëpër qytete të tjera zvicerane.*

Pavarësisht prej xhamive në Zvicrën gjermanofone ekzistojnë edhe dy revista islame në gjuhën gjermane. Njëra është "Die Barmherzigkeit" ('Mëshira'), e cila për herë të parë në dritë ka dalur në vitin 1990 dhe e cila mëton të jetë si një platformë e muslimanëve që flasin gjermanisht. Në moment ajo përbëhet nga tetë faqe A4 dhe del diku katër herë në vit. Jo prej moti ekziston edhe një revistë për fëmijë e quajtur "Die Oase-Al-Waha" ('Oaza'). Ajo tenton që përmes historisë dhe lojërave fëmijëve muslimanë t'ua sjellë sa më pranë fenë e tyre.*

Për fund dëshiroj të përmend se çdo vit mbahet nga një kamp fundjave për familjet muslimane. Kjo para së gjithash u ofron familjeve zvicerane, familjeve të tjera nga e gjithë Zvicra ose nga vendet fqinje, mundësinë që të njihen dhe të këmbëjnë përvojat e tyre. Përveç kësaj, këtu nuk mungojnë as referuesit e ftuar nga Zvicra, Gjermania dhe Austria me temat e tyre të zgjedhura, po as aktivitetet rekreative si alpinizmi e sporti.

3. Problemet e muslimanëve në jetën private dhe publike

Në pyetjen se a ndeshen muslimanët e Zvicrës me probleme, shpesh nga 'gastarbeiterët' dëgjoj përgjigjen se shumë më thjeshtë e më kollaj është të jetosh si musliman në Zvicër sesa për shembull në Turqi. Kjo përgjigje në shikim të parë duket bindëse dhe e arsyeshme, sepse në disa të ashtuquajtura vende islame, lëshimi i mjekrës ose bartja e shamisë mjafton që në disa baza të gabuara njeriu të vihet nën hije ose fundja edhe të burgoset. Nëse unë këtë çështje e peshoj si duhet, vij në përfundimin se për ne muslimanët në Evropë në përgjithësi dhe në Zvicër në veçanti, ekzistojnë probleme të shtresuara krejt tjetërfare, do të kisha thënë që gati peshojnë më shumë sesa mendohet.

Njëherit, këtu ekziston një filozofi jete dhe prezantim vlerash krejt tjetër. Edhe pse Zvicra në të vërtetë është një vend krishter, kjo shumë pak ndjehet e vërehet në jetën e përditshme. Vlerat tipike krishtere si përkushtimi ndaj Zotit, dashuria ndaj tjetrit, gjithnjë e më tepër kalojnë në prapaskenë, duke u bërë vend vlerave 'moderne' si kapitalizmit, egoizmit dhe sekularizmit. Ne muslimanët pra jetojmë në mesin e një bote, ku përparësinë më të lartë e kanë të mirat materiale, kurse për ne muslimanët në radhë të parë vijnë vlerat shpirtërore. Ne shohim se si familja, e këcënuar dhe e sulmuar nga egoizmi, gjithnjë e më tepër shtyhet në prapaskenë, ndërsa për ne muslimanët familja dhe farefisnia janë elemente qendrore të jetës sonë. Pikërisht këtë pikë shumë mirë e ka formuluar z. Rohrbach, udhëheqës i sektorit për Lindjen e Mesme pranë Institutit zviceran për mirëbesim (Schweizerischen Kreditanstalt), në një kumtesë të tij të lexuar në Paulus-Akademie. Ai tha se një musliman punon aq kohë sa i duhet për të jetuar, ndërsa pjesën tjetër të kohës e investon në familje dhe në farefisni, sepse ai beson se ardhmëria nuk mund të ndërtohet vetëm me siguri materiale. Aq më tepër, ai beson se shumë më me rëndësi është të ketë marrëdhënie të mira e të shëndosha me farefisnin dhe me

* E këtillë, p.sh., është "Dachverband islamischer Gemeinden der Ostschweiz und des Fürstentums Liechtenstein" (Lidhja e bashkësive islame të Zvicrës lindore dhe të principatës së Lihtenshtajnit), që është themeluar në mars 2003, në qytetin St. Gallen dhe e cila deri më tani ka inkorporuar në vete 17 bashkësi islame të këtij rajoni; pastaj "Vereinigung des Islamischen Organisationen ins Kanton Luzern" – VIOKL, e themeluar në vitin 2002 dhe që përfshinë 5 qendra islame, etj. – (R. N.).

* Në vitin 2003, në gjuhën shqipe ka filluar të botohet revista "El-Ahnafe", që mëton t'i shprehë idetë e shkollës juridike hanefite. Botuesi i saj është imami i Xhamisë shqiptare të St. Gallenit - (R. N.).

njerëzit e tjerë, të cilët pastaj do t'i dalin krah në rast nevoje e ngushtësie. Z. Rohrbach këtu erdhi në përfundimin se njeriu perëndimor do të bënte mirë po të punonte pak më pak dhe në vend të saj pak më tepër kohë t'i kushtonte familjes. Në anën tjetër, ai mendonte se muslimanëve do t'u bënte mirë sikur të punonin diçka pak më tepër sesa u nevojitet për jetë, që edhe në këtë mënyrë t'i gëzonin familjet e tyre. Me këtë pajtohëm plotësisht. Ndoshta me këtë rast do të shtoja se ai me këtë ka patur për qëllim muslimanët që jetojnë në Lindje. Tani, një problem tjetër që është aktualizuar kohëve të fundit, është tendenca e njohur e Perëndimit që Islamin gjithnjë e më tepër ta rishpërdorjë si një tablo armiqësore "të vjetër". Unë jam i mendimit se Islami gjithnjë ka qenë tablo armiqësore e Perëndimit, e cila kokhë pas kohe është shtyrë në prapaskenë nga tablo të reja armiqësore. Të përkujtojmë se pikërisht para 900 viteve, më saktë në vitin 1095, papa Urbani II në Sinodin për Clermont-Ferrandin, pati bërë thirrje për kryqëzata kundër "të pafeve". Kryqëzata e fundit, e shtata, është zhvilluar në vitin 1270, gjegjësisht gati 200 vjet më vonë.

Kur në prill të vitit 1995 në Oklahoma-City të SHBA-ve shpërtheu një bombë prej së cilës gjetën vdekjen afro 200 persona, nëpër mediat perëndimore filloi të dyshohej se mos kjo do të ishte një akt i muslimanëve terroristë, derisa për tmerim të shumë amerikanëve doli se ishte akt i kryer nga një amerikan. Ky është ndoshta njëri nga shembujt më të paskrupullt e më të padëgjuar se si muslimanët janë të parët që fajësohen për vepra të këqija. Por unë jam i mendimit se arsye kryesore për këtë qëndrim është një mosnjohuri e pabesueshme mbi Islamin. Kjo është prezente në radhë të parë në vetë Perëndimin, i cili më me dëshirë u drejtohet të ashtuquajturve "ekspertë të Islamit" – këtu nuk do të përmendi emra – në vend që të informohen nga vetë muslimanët. Thënë sinqerisht, nëse unë dëshiroj të di diçka për Krishterizmin, atëherë nuk shkoj te ndonjë ekspert i Krishterizmit që është musliman – as që e di se ku do ta gjeja një të tillë – por u drejtohem bashkëqytetarëve të mi të krishterë ose ndonjë prifti. Nga ana tjetër, kjo është prezente edhe te ne vetë muslimanët, që shumë pak punë publike bëjmë, shumë rrallë mbajmë "ditë të dyerve të hapura" në xhami ose diçka të ngjashme. Kësaj duhet shtuar edhe faktin që shumica e punëtorëve mysafirë muslimanë nga vetë njohja e pamjaftueshme e gjuhës, nuk janë në gjendje të japin informacione mbi fenë e tyre. Neve muslimanëve shumë na dëmton edhe morali i dyfishtë i Perëndimit, i cili gjithnjë e më shumë po duket në Perëndim. Mendoj që shprehjet si Lufta e Gjirit, ish Jugosllavia, Algjeria, Iraku etj., mjaftojnë për të treguar se çka dua të them. Ne muslimanët vëmë re se për ne nuk vlejnë të njëjtat kritere, sikur për pjesën tjetër të botës. Nëse një muslimani i bëhet padrejtësi, ekziston gadishmëria që kjo të anashkalohet e injorohet, çka nuk është rasti i njëjtë kur janë pyetje të krishterët apo çifutët.

Natyrisht se çdo musliman ka nga ndonjë problem në vendin e punës, në shkollë etj., qofshin këto të bëjnë me lutjet ditore (namazet), të cilat sidomos dimrit bien në kohë të punës, qofshin me agjërimin e Ramazanit apo me bartjen e shamive, që gjithnjë e më shumë shpie te sulmi ndaj muslimaneve të reja. Sigurisht që një pjesë e këtyre problemeve mund të zgjidhen nëse Islami përfundimisht njihet zyrtarisht si fe. Atëherë me siguri që do të gjendeshin zgjidhje të thjeshta për edukimin dhe arsimimin e fëmijëve, për blerjen e mishit hallall, për varrimin e muslimanëve nëpër varrezat e tyre si dhe probleme të ngjashme me këto.

Përfundimisht në këtë kontekst desha ta theksoj një tjetër problem, që për mua është qëndror, e kjo është mungesa e njohjes së muslimanëve me fenë e tyre. Lidhur me këtë duhet ta kemi të qartë se shumica e punëtorëve mysafirë, sidomos ata nga Turqia, kanë ardhur në Perëndim pa ndonjë edukatë e arsimim bazë mbi Islamin dhe vetëm këtu, pas një shoku kulturor të shumëcituar, kanë filluar të rivetëdijësohen për besimin e tyre. Natyrisht se jo të gjithëve, po një pjese të madhe, u është kujtuar kultura e tyre dhe kanë tentuar ta rijetësojnë atë. Meqë shumica prej tyre nuk kanë njohuri bazë, kjo ka shkaktuar që shumica prej tyre të mos mund të bëjnë dallimin midis detyrave fetare dhe traditave të mbështetura në kulturë. Shumë gjëra që shikohen si islame, në fakt burojnë nga tradita e vendit prej nga vijnë dhe nuk

kanë asnjë kuptim në kulturat e tjera islame. Këtu hyjnë, për shembull, pozita e gruas, martesat e vajzave të reja pa pëlqimin e tyre, toleranca ndaj djelmoshave dhe rreptësia ndaj vashave, e kështu me radhë.

4. Një vështrim mbi të ardhmen

Unë mendoj se prezentimet e mia kanë treguar qartë se Islami është bërë pjesë e fortë përbërëse e shoqërisë zvicerane. Si qytetarët ashtu edhe organet zvicerane duhet të ballafaqohen me muslimanët këtu në vend, deshën apo s'deshën. Këtu duhet një ndjeshmëri shumë e hollë dhe një sinqeritet nga të dyja palët. Paraqitjet me "unë kam të drejtë" dhe "unë e di më së miri", janë gjithsesi të pavend sikurse qortimi i klisheve e paragjykimeve të parafabrikuara. Të dyja palët duhet t'i pranojnë e njohin tjetërsitë dhe dallimet e njëra-tjetrës, edhe pse jo gjithmonë mund t'i kuptojnë e kapin këto. Për t'i kuptuar muslimanët vërtet ashtu si janë, duhet që edhe të tjerët të jenë muslimanë në zemrat e tyre. Mendoj se e njëjta vlen edhe për Krishterizmin. Në këtë kontekst dëshiroj edhe një herë ta citoj z. Wittwer. Ai ka thënë se qyteti i Zürichut është përcaktuar për integrimin e jo asimilimin e muslimanëve. Besoj se ky është një përcaktim që shkon në drejtim të mbarë.

Edhe hapi i njohjes zyrtare të Islamit bëhet gjithnjë e më i pashmangshëm. Sikurse thash më herët, kjo do të ndihmonte në zgjidhjen e shumë problemeve urgjente. Përveç kësaj, kjo do t'i thjeshtësonte edhe marrëdhëniet e organeve shtetërore me muslimanët. Së fundi, jam i bindur se është e pakushtëzueshme që opinionit t'i ofrohet një tablo e padeformuar mbi Islamit dhe muslimanët. Kjo, nga njëra anë, do të bëhej nga pala e muslimanëve përmes manifestimeve të ndryshme dhe kontakteve të dendura personale. E nga ana tjetër, do të duhej edhe përkrahja e autoriteteve dhe mediave. Unë do t'i kisha lutur këta me këmbëngulësi që të lirohen nga paragjykimet dhe klishetë e paramenduara dhe t'u drejtohen vetë muslimanëve e jo të vetëquajturve "ekspertë të Islamit". Për këtë, natyrisht, duhet të tejkalohet njëfarë druajtje për të vendosur, për çka jam i bindur se do të paraqesë vetëm një pasurim për të dyja palët.

ISLAMI NË ZVICËR: DIALOGU MIDIS KULTURAVE

(Ky vështrim mbi krizat me të cilat ballafaqohet pakica e marginalizuar muslimane në Zvicër ka hapur një debat të ri në Institutin Goethe të Londrës – 16 janar 2003)

Sot në Zvicër jetojnë afro 310 000 muslimanë, të cilët përbëjnë 4.5 % të popullsisë së përgjithshme. Muslimanët e Zvicrës janë mërgimtarë nga vende të ndryshme: 42 % turq, 36 % ish-jugosllavë, 4 % afrikanoveriorë, 3 % libanezë, 15 % afrikanë, aziatë dhe amerikanë²². Shumica e tyre (75 %) jetojnë në pjesën gjermanofone të vendit, kurse 14 % janë të vendosur në zonën frankofone të Zvicrës. Këto gjeneratat e dyta, të treta madje edhe të katërta të muslimanëve janë të përçarë në shumë grupime të ndryshme. Para njëzet viteve në Zvicër kishte shumë pak vende adhurimi të muslimanëve. Sot ka mbi 100 të ashtuquajtura "Qendra Kulturore Islame". Sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 2000, numri i tyre tregon rritje të trefishtë për çdo dhjetë vjet. Sipas këtyre llogaritjeve, në vitin 2025 apo 2030 muslimanët do ta përbëjnë shumicën e popullsisë. Së paku ky është argumenti të cilin disa nga politikanët tanë e përdorin për ta frikësuar shoqërinë tonë me qëllim që të aprovojë një legjislaturë restriktive për imigracionin.

Bashkësitë e copëtuara

Bashkësitë turke, boshnjake dhe shqiptare, që secila qendrën kryesore e ka në Zürich, me organizatat e tyre ndihmëse janë të përhapura në gjithë vendin. Ndarjet e brendshme politike në Turqi duket se riprodhohen edhe te degëzimet e tyre në Zvicër. Disa qendra kontrollohen nga Dijaneti, Ministria turke e fesë²³, përmes një përfaqësuesi të konsullatit turk; të tjerët janë në dorë të Milli Görüşit, një lëvizje opozitare islamike e Turqisë, ish partia Refah.²⁴

Ka disa qytetarë të paktë me origjinë nga bota arabe, por edhe këta janë pak a shumë të organizuar. Madje, Arabia Saudite dhe në një shkallë më të ulët Egjipti dhe Irani, të gjitha kanë ndikim tek ata. Ekzistojnë edhe të ashtuquajturat qendra "zyrtare"; për shembull *The Islamic Foundation of Geneva*, e cila pjesërisht finansohet nga Arabia Saudite; apo *Stiftung Islamische Gemeinschaft e Zürich*, e finansuar nga Emiratet e Bashkuara Arabe. Qeveria saudite, bashkë me shoqatat dhe institucionet bëmirëse saudite, kanë qenë aktive në ndërtimin e xhamive dhe sjelljen e imamëve e të mësuesve nëpër qytete të ndryshme evropiane, ndaj edhe e kanë propaganduar damkën e tyre të Islamit vehhabit. Sikurse këto "qendra zyrtare", ekzistojnë edhe lëvizje si Grupi *Tebliğ*, të cilët janë përkrahës të kthimit në një fe më tepër të

²² Sipas regjistrimit të popullsisë të kryer në vitin 2000 nga Enti Federativ për Statistikë i Zvicrës, rezultoi se numri i shqipfolësve është 94 937, i turqve 44 523, i arabëve 14 345 etj. – (R. N.).

²³ Republika e Turqisë nuk ka ministri të veçantë të fesë, por ka një ministër pa resor që kujdeset për punët e fesë të udhëhequra nga Diyanet İşleri Başkanlığı (Kryesia e Punëve të Fesë) – (R. N.).

²⁴ Sot kjo parti nuk ekziston më, porse prej saj kanë lindur dy të tjera: *Milli Selamet Partisi*, e kryesuar nga Rexhai Kutan, një figurë politike shumë e ngushtë me themeluesin e partisë Refah – Necmettin Erbakan; kurse tjetra është *Adalet ve Kalkınma Partisi*, e kryesuar nga Recep Tayyip Erdoğan, kryeministër aktual i Republikës së Turqisë – (R. N.).

personalizuar, apo Vëllezërit Muslimanë (*Ihvanu'l-muslimin*), që janë një lëvizje reformuese me një komponentë të fortë politike.

Shumica e bashkësive muslimane që jetojnë në Zvicër kanë një shkallë lidhshmërie me vendet nga kanë ardhur. Për shembull, ato ndarje politike islame që kanë dalë në sipërfaqe gjatë luftës civile në Algjeri në vitet 1990 e më vonë, me paraqitjen e FIS-it, janë reflektuar edhe në politikën e algjerianëve që sot jetojnë në Zvicër.

Përfundimisht, duhet të keni ndër mend se hendeku i brezave është një shkak i rëndësishëm i copëtimit brenda bashkësisë muslimane. Gjeneratat e lindura e të rritura në Evropë, fenë dhe kulturën tradicionale të prindërve të tyre përgjithësisht e shohin si prapavajtëse dhe kufizuese. Arsimimi evropian ata i bën më të aftë në gjuhët kombëtare të vendit, ndaj dhe përgjithësisht më të hapur ndaj traditave e shprehive lokale. Një hendek i tillë mund të çojë në drejtime tejet të ndryshme, duke filluar nga asimilimi në kulturën dominuese e deri te një identifikim i theksuar fetar. Mirëpo, në të dyja rastet, parashikimet dhe shpresat e gjeneratës më të re janë shumë më të ndryshme prej atyre të prindërve të tyre.

Tensione gjithashtu ekzistojnë edhe midis bashkësive, me disa grupe që rivalizojnë për epërsi e spikatje. Larmia e interesave komunale, rivalitetet për lidhshmëri dhe orientimet politike, si dhe tradita e dukshme islame e pluralizmit fetar kanë peshë të madhe në vështirësinë e muslimanëve për të zgjedhur përfaqësues zyrtarë për në qeveri. Grupet e afërta me Vëllezërit Muslimanë ndikimin e tyre e ushtrojnë mbi qendrat islame të Gjenevës, Biennit, Zürichut dhe Veveyt, kurse Liga Botërore Islame (*Rabita*), që është e finansuar nga Arabia Saudite dhe që veten e konsideron për apolitike, i mbështet xhamitë e Gjenevës, Bernit dhe Baselit. Liga Muslimane e Zvicrës tenton ta organizojë mbarë bashkësinë islame dhe pretendon se është bashkëbiseduesja e vetme me qeverinë zvicerane. Mirëpo, përkundër aktivizmit të saj, ajo akoma nuk ka arritur të formojë një asociacion që do t'i përfaqësonte të gjitha këto grupe. Për më tepër, qasja e saj rigoroze gjithherë nuk çmohet saktë, sidomos nga qendrat islame të turqve dhe shqiptarëve.

Njohja publike e Islamit

Muslimanët mbeten të marginalizuar nga aspekti kulturor. Kushtetuta zvicerane ua garanton atyre lirinë e fesë, mirëpo shumë muslimanë ankohen për mungesën e institucioneve fetare, si shkollat apo fakulteti teologjik, për të gjetur një qendër për adhurimin e tyre etj. Islami në Zvicër tregon prirje të mbetet diasporik, duke u takuar kryesisht nëpër shtëpi, garazha e dyqane. Si rezultat, muslimanët ndjejnë se autoritetet zvicerane nuk janë të ndjeshme gjithaq për vlerat fetare dhe kulturore të tyre. Në të njëjtën kohë, ata nuk i kanë ikur krijimit të përshtypjes popullore në Zvicër se ata vërtet nuk kanë për qëllim të integrohen.

Mirëpo, është me rëndësi të bëjmë dallimin ndërmjet njohjes publike në njërin anë dhe atë të autoriteteve në anën tjetër si dhe t'i shikojmë rrugët në të cilat një pakicë mund të lidhet me shtetin.

Muslimanët ankohen se nuk po akceptohen në Zvicër dhe për atë që ata e shohin si një anti-islamizëm të heshtur. Kjo ndjenjë kryesisht nxitet nga qëndrimet ekskluziviste (përrjashtuese) të disa krishterëve dhe nga ata që i përkasin vijës së fortë sekulariste. Megjithatë, një studim i bërë në vitin 1998 nga Universiteti i Gjenevës, ka konkluduar se "Islamofobia" vërtet nuk ekziston në Zvicër, përveç disa rasteve të izoluara diskriminimi (p.sh. kur janë në pyetje kushtet për garantimin e lejeve për qëndrim dhe punë).

Sido që të jetë, ngjarjet e 11 shtatorit kanë nxjerrë në dritë problemet që kanë ekzistuar edhe më herët ndërmjet kulturave dhe perceptimeve perëndimore dhe arabo-islame, duke

yshtur pretendimet për një "përplasje qytetërimesh" të përgjithshme. Me ose pa të drejtë, mbetet fakti se shumë njerëz sot tentojnë të bëjnë përzierjen e shkaqeve me pasoja të ndryshme (Islami, dhuna, obskurantizmi, terrorizmi), saqë të jesh musliman shpesh llogaritet sikur të jesh një kategori e dyshimtë. Për pasojë, shumë muslimanë zviceranë frikohen ta shprehin përkatësinë e tyre fetare.

Megjithëkëtë, gjasat që Islami në Zvicër të getoizohet në të njëjtën mënyrë sikurse në disa vende të tjera, janë shumë të vogla. Rreziku ekziston. Mirëpo Zvicra ka një traditë të gjatë të tolerancës dhe dialogut ndërfaqësor. Ne kemi katër gjuhë kombëtare dhe jemi një shoqëri multifetare. Për më tepër, sistemi ynë politik, me 26 kantonet dhe gjysmëkantonet sovraane, është i decentralizuar.

Njohja nga ana e autoriteteve

Një qëllim i patundshëm i Fondacionit Kulturor Islam në Gjenevë është se Islami duhet të shpallet fe zyrtare nga ana e autoriteteve zvicerane. Ismail Amini, kryetar i Organizatave Islame në Zürich, i bën jehonë këtij qëndrimi:

"Ky status do të na lejonte të themelonim një institucion të vërtetë; të hapnim një katedër të shkencave islame në fakultetin teologjik, një në pjesën gjermane dhe një tjetër në atë franceze të Zvicrës. Këto katedra do të finansoheshin nga autoritetet zvicerane, siç finansohen katedrat e studimeve hebraike dhe krishtere. Gjithashtu do ta mundësonte tubimin e një tatimi, sikurse tatimi priftëror për kishat; themelimin e varrezave ku muslimanët do të varroseshin sipas traditës islame".

Mirëpo, në Zvicër ka disa komplikime. Konfederata nuk e njeh ndonjërin fe në veçanti. Ajo i ka privuar dy bashkësitë fetare më të mëdha të vendit – protestane dhe katolike – nga privilegjet e tyre për sa i përket statusit civil, martesës, kompetencave dhe varrimit. Neni 72 i Kushtetutës zvicerane parasheh që "rregullimi i marrëdhënieve midis kishës dhe shtetit bie nën jurisdikcionin e kantoneve" (me fjalën 'kishë' nënkupton bashkësitë fetare në përgjithësi).

Me fjalë të tjera, secili kanton ka përgjegjësinë për t'i rregulluar marrëdhëniet e tij me bashkësitë e ndryshme fetare, edhe pse të gjitha kantonet duhet t'i plotësojnë disa të drejta elementare, e në veçanti lirinë e ndërgjegjes dhe besimit. Por, ajo që ato duhet ta njohin, duke i dhënë status legal si një entitet publik, nuk është "feja" por "bashkësia fetare". Ky është një problem serioz i muslimanëve në Zvicër, ngase ata nuk kanë ndonjë trup përfaqësues e as që janë homogjenë. Burimi i vetëm i tyre është në Kodin Civil të Zvicrës, i cili u lejon muslimanëve që të konstituohen në nivel komunal, kantonal apo federal, si një fondacion i drejtuar nga ligji i tij privat. Kjo është një e drejtë e garantuar me Kushtetutë jo vetëm për qytetarët zviceranë, po edhe për të huajt.

Si ndjehen muslimanët?

Është vështirë të dish se si ndjehen muslimanët në Zvicër. Ankesat e tyre përgjithësisht kanë të bëjnë me papunësinë dhe përjashtimin, me imazhin negativ të mediave kundër tyre dhe me vështirësitë e tyre gjatë integrimit në shoqëri, por duke i ruajtur vlerat e tyre islame. Kërkesat e tyre kryesore janë se Islami duhet të njihet e të institucionalizohet në Zvicër, duke garantuar një liri më të madhe të shprehjes fetare dhe se atyre duhet t'u mundësohet të kenë varrezat islame dhe shkollat e Kur'anit për fëmijët muslimanë.

Hani Ramadan, imam dhe drejtor i Qendrës islame në Gjenevë, pretendon se "sistemi i bazuar në demokraci dhe në të drejtat njerëzore ka krijuar një zbrazëtim politik dhe kjo zbrazëtim tani duhet të mbushet me fe". Ai shkon edhe më tej: "Kthimi në Krishterizëm do të ishte një zgjidhje, mirëpo feja krishtere tërësisht është izoluar nga shteti. Sa i përket Hebraizmit, ai ka mbetur i ngjitur për idenë e një race të zgjedhur, duke e reduktuar në mënyrë të konsiderueshme ndikimin e mesazhit të tij. Prandaj, Islami është e vetmja fe e aftë për të promovuar një besim, një moralitet, një sistem ligjesh..." dhe "një pushtet që e përkrah sovranitetin e ligjit hyjnor".

Sipas mendimit të muslimanëve më të zjarrtë, traditat dhe kultura e tyre meritojnë të merren më seriozisht në Zvicër. Autoritetet politike duhet të bëjnë përshtatjen e legjislativës ekzistuese për ta marrë në konsideratë praninë e tyre. Pyetja e vetme është: prej ku të fillohet? Ata kanë pak sens për nevojën e përvetësimit të kushteve ekzistuese dhe për punën në margjinat të legjislativës ekzistuese për ta arritur ndryshimin e përshkallëzuar.

Tariq Ramadan, vëllai i Hani Ramadanit (edhe pse përfaqëson një zë shumë të ndryshëm brenda bashkësisë muslimane) thekson se "muslimanët nuk duhet të detyrohen të veprojnë kundër ndërgjegjes së tyre". Po, t'i mund të përgjigjesh, mirëpo ku e heqësh vijën? Sapo t'i lëshohesh kësaj rruge, ti i rrezikon bashkësitë e Zvicrës që jetojnë njëra pranë tjetrës, por me ligje e zakone të ndryshme.

Nevoja për dialog: deri ku?

Do të ishte humbje kohe të mbështesësh koekzistencën paqësore ndër kombet para se ta njohësh fillimisht larminë e kulturave të tyre dhe nuk është një gabim i vogël ta vëndosh besimin e thjeshtë në përngjashmëritë e dukshme midis kulturës perëndimore dhe asaj islame.

Të gjithë pjesëmarrësit në një dialog të tillë duhet të përpiqen t'i kuptojnë bashkëbiseduesit e tyre. Po kështu, për të patur sukses, ata duhet të përpiqen ta shikojnë vetveten pak më qartë. Kjo nuk është punë e lehtë. Pikë së pari, vendet perëndimore shpesh kanë bindjen se kultura e tyre është 'model kulturë', të cilën të gjitha të tjerat duhet ta marrin për kut (masë, kriter) të modernizimit dhe progresit. Ndërkohë që akoma dhe sot, në dritën e historisë së gjatë të kolonizimit evropian të shumicës së vendeve muslimane nga ana e fuqive perëndimore, kryqëzatat vazhdojnë të mbeten simbol armiqësie që lë mbresa të gabueshme kinse populli perëndimor gjithnjë është i dhënë pas shkatërrimit të Islamit.

Sot jemi dëshmitarë të një krize në marrëdhëniet kulturore midis të dyjave. Duket se ekziston një kampanjë e orkestruar për ta errësuar e njollosur imazhin e Islamit e të muslimanëve. Rritja e ekstremizmit fetar në disa vende muslimane si dhe dhuna që e ushtrojnë disa grupe të marginalizuara u ka dhënë shkas të mjaftueshëm atyre që Islamit e portretizojnë si një fe reacionare e cila nuk mund t'i përshtatet klubit të ri të 'kombeve të civilizuar'.

Një lidhje e re pozitive do të duhej të fillonte nga njerëzit e të dyja palëve, që janë të aftë t'i shtrojnë në masë kundërpasitë dhe kujtimet e tyre, duke pranuar se bota tanimë është ndryshuar. Dialogu ekzistues midis elitës intelektuale të Perëndimit dhe të botës muslimane nuk mund t'i mbyllë sytë para krizës në të cilën kanë rënë momentalisht të gjithë besimtarët, pa marrë parasysh përkatësinë dhe deklarinimin e tyre fetar.

Në Zvicër, një proces i këtillë dialogu së paku ka filluar. Unë marr pjesë në 'Grupin Punues-Islami' të themeluar në vitin 2001 nga Konferenca e Peshkopëve të Zvicrës. Lejomëni t'ju jap disa thërmi të planeve tona momentale!

Detyra jonë e parë është të punojmë mbi një agjendë për një dialog të përbashkët të bazuar në identifikimin e vlerave të përgjithshme që i zotërojnë të dy kulturat. Inteligjencia e të dyja palëve duhet t'i shpallë luftë fanatizmit kulturor dhe fetar. Sidomos liderët fetarë janë të thirrur të angazhohen në kampanjën që e mbështet tolerancën, njohjen dhe respektin e ndërsjellë. Ka punë për t'u bërë edhe në rishikimin e teksteve mësimore të shkollave për t'i mënjeluar komentet ofenduese lidhur me kulturën, fenë apo mënyrën e jetesës së cilësdo palë dhe të sigurohemi se të gjithë janë të përfshirë në to. Është e nevojshme që te mediat të ngulitet një ndjenjë përgjegjësie gjatë projektimit të imazheve të qytetërimeve dhe kulturave të tjera, me qëllim që të angazhohen në një kampanjë pozitive dhe konstruktive për ndreqjen e dëmit të shkaktuar gjatë gjeneratave për shkak të pandjeshmërisë ndaj të drejtave kulturore të popujve të tjerë.

Më drejtpërdrejtë, duhet të jemi të aftë t'u drejtohemi udhëzuesve shpirtërorë muslimanë të arsimuar në Evropë sesa atyre vendeve me të cilat mërgimtarët i kanë humbur shumicën e lidhjeve të tyre. Dialogu duhet organizuar jo vetëm në nivel global, po edhe në atë lokal, me qëllim që të krijohen marrëdhënie të mira fqinjësore. Përfundimisht, nëse dëshirojmë që dialogu ndërfaqetar të lulëzojë, bashkësia muslimane e Zvicrës duhet të organizohet më mirë.

Reflektimet finale

Kronika e sulmeve terroriste mbi SHBA-të, ndaç nga politikanët ndaç nga mediat, i ka veçuar muslimanët si "të mallkuarit e rinj të botës", ndërsa kjo e bën dialogun akoma më të pashmangshëm. Pa dyshim se do të marrë kohë riparimi i dëmit të shkaktuar nga ky bashkim i fortë që bëhet midis Islamit dhe dhunës e terrorizmit.

Për më tepër, apeli i lëshuar nga pozicioni radikal islamist nuk mund, sigurisht, t'u përshkruhet vetëm grupeve të organizuara apo 'terroristëve'. Kjo ka të ngjarë të dalë sidomos edhe nga shumë të rinj muslimanë të pakënaqur. Në Zvicër kjo, përgjithësisht, ka ngelur në nivelin e mallëngjimit dhe nuk e ka arritur nivelin e organizimit dhe mobilizimit. Shumica dërmuese e këtyre djelmoshave nuk janë aktivë në politikë. Edhe në qoftë se janë, ata më shumë merren me çështje lokale dhe vendore sesa me konfrontime globale. Mirëpo rreziku për daljen e gjërave jashtë kontrollit mbetet aktual.

Ata muslimanë aktivë në politikën dhe shoqërinë zvicerane që kanë një profil të lartë publik shpesh marrin qëndrime konfrontuese – p.sh. lidhur me çështjen e statusit të gruas apo të Sheriatit. Kjo është një arsye tjetër shqetësimi për 'pjesën dërmuese' të muslimanëve, sepse kjo i bojadis perceptimet publike të Islamit dhe i rikonfirmon stereotipet (klishtë) raciste. Liderët bashkiakë, ndaç kur t'u flasin bashkëfetarëve të tyre ndaç publikut në tërësi, duhet të vënë theksin më tepër në Islamit si një fe paqeje dhe tolerance.

Pas tragjedisë në SHBA, si kudo në botë ashtu edhe në Zvicër, janë marrë masa të larta sigurie. Është e qartë se kjo politikë sigurie deri diku mund të arsyetohet. Mirëpo, si një qasje politike afatgjate, ajo do të provokojë tensione serioze në qoftë se nuk bëhen dallime midis lëvizjeve islame radikale dhe të moderuara.

Për fund, nuk duhet harruar se çështjet fetare kanë një kuptim ekzistencial për të gjithë besimtarët, andaj këtu qëndron një sfidë akoma më e fortë për shoqëritë tona moderne.

FILLIMET E NJË DIALOGU TË VËSHTIRË*

Muslimanët e Zvicrës, të ndryshëm, të izoluar nga njëri-tjetri si dhe nga kultura nikoqire, ballafaqohen me shumë probleme nga fusha e gjuhës, shëndetit dhe adhurimit.

Islami është bashkësia fetare që së më së shpejti po rritet në Zvicër, mirëpo si rezultat i kufizimeve të ndryshme të vendit, më pak se 10 % e tyre kanë pasaporta zvicerane.

Unë do të doja të diskutoja rreth përshkrimit që Francis Piccand ia bëri larmisë kombëtare dhe kulturore të Islamit në Zvicër duke dhënë një pasqyrë të shkurtër të fazave të imigrimit të muslimanëve. Tufa e parë e imigrantëve, e cila kryesisht përbëhej nga djem e vasha me arsimim të lartë, që kishin mbërritur në vitet e vona 50 dhe në të 60-tat, me qëllim studimi apo hulumtimi, apo edhe për arsye profesionale. Shumica e këtyre muslimanëve ishte me origjinë nga Lindja e Mesme, duke përfshirë irakianë, sirianë dhe egjiptianë. Organizata e parë studentore e arabëve muslimanë, e njohur si 'Arabian', është themeluar në Zürih në vitin 1965. Një numër i këtyre imigrantëve më vonë janë kthyer në vendlindjet e tyre.

Vala e dytë dhe më e madhe e imigrantëve muslimanë në vitet '70 dhe '80 është shkaktuar nga kërkesa e ekonomisë zvicerane për fuqi të lirë punëtore, sidomos në industrinë ndërtimore. Të njohur si 'Gastarbeiter' ose 'punëtorë mysafirë', këta imigrantë është pritur ta lëshojnë vendin pas një periudhe pune. Mirëpo shumica mbetën dhe u vendosën këtu, duke i ftuar edhe familjet e tyre t'u bashkëngjiten në Zvicër. Shumë prej tyre vinin nga Ballkani, sidomos nga Turqia dhe nga ish Jugosllavia, të cilët dukej se kishin arsimim të kufizuar.

Në vitet 1980 dhe përshkallëzisht deri më sot, imigrantët muslimanë në radhë të parë ishin refugjatë politikë ose refugjatë lufte që i braktisnin vendet e tyre për shkak të pasigurisë politike dhe konflikteve të shumta të dhunshme në botën islame: lufta ruso-afgane, lufta Iran-Irak, luftërat civile në Liban, Algjeri, Somali, Bosnjë e Hercegovinë, lufta kundër popullit kurd dhe, së fundi, lufta e Kosovës. Viteve të fundit kemi patur gjithashtu një numër në rritje të imigrantëve muslimanëve nga vendet afrikane. Shumica e imigrantëve muslimanë punojnë nëpër fabrika ose si zejtarë në industrinë e ndërtimit. Disa kanë hapur dyqane të vogla, supermarkete, bar-rostiçeri apo restorane të vogla ku mund t'i gjesht produktet dhe ushqimet nga vendet e tyre përkatëse.

Përkundër faktit se shumica dërmuese e muslimanëve të Zvicrës janë migrantë, unë nuk besoj se duhet quajtur migrantë në përgjithësi pa pranuar se këtu ekziston tanimë gjenerata e dytë, e tretë dhe dukshëm e katërta. Të veprosh kështu, do të thotë ta rirforcosh përfytyrimin publik të një kontradikte të pazgjidhshme ndërmjet të jesh musliman dhe të jesh evropian, ose të jesh zviceran. Kjo gjithashtu tregon dështimin e pranimit dhe respektimit të Islamit si një fe që ka të njëjtën vlerë sikurse Krishterimi dhe Judaizmi, në kuptimin e një besimi praktik universal. Emërtimi i të gjithë muslimanëve të socializuar në shoqërinë zvicerane si 'migrantë', e forcon një identitet kulturor të papërshtatshëm për ta.

Mirëpo, së këndejmi, larmia e bashkësive muslimane vërtet ndikon në organizimin e tyre. Kontakti midis anëtarëve të këtyre qendrave të ndryshme islame – sidomos në pjesën

* Edhe kjo është një kumtesë që autorja e ka mbajtur bashkë me Francis Piccandin në Institutin Goethe në Londër më 16 janar 2003.

gjermanofone të Zvicrës – është minimal. Për këtë unë mund të sjell dy arsye kryesore. E para është mungesa e një gjuhe bashkuese. Duhet të jemi të vetëdijshëm se shumë imigrantë muslimanë në pjesën gjermanofone të Zvicrës mezi e flasin gjuhën gjermane. Arsyeja e dytë është dallimi në traditë. Me kontaktin e paktë ose të aspaktë midis grupeve, janë ruajtur edhe të gjitha sjelljet dhe botëkuptimet tradicionale lokale. Vështirë ndodh këmbimi i botëkuptimeve dhe reflektimeve lidhur me kulturat e tyre përkatëse. Qasja pranë këtyre qendrave shpesh është e vështirë për çdo të 'jashtëm'. Madje të jesh *grua* muslimane mund të jetë një arsye për t'u përjashtuar.

Tani jemi dëshmitarë të lindjes së një dialogu krishtero-islam. Hapi i parë drejt këtij dialogu është hedhur nga ana e muslimanëve në një koniunkturë (rrethanë) të veçantë, kur ata kishin një sërë ankesash që donin t'ua adresonin autoriteteve zvicerane – zemërimet të shkaktuara nga konflikti izraelo-palestinez. Këto dialogje janë zhvilluar ose në bazë private ose janë organizuar nga shoqata studentore.

Ndërkohë, me valën e dytë të imigrimit, shpejt u rrit nevoja për vende të adhurimit. Muslimanët fillojnë të zënë me qira apartamente, të mbyllin sallat e fabrikave dhe shtëpitë e vjetra të zbratura për t'i shndërruar ato në dhoma faljeje. Muslimanët e kishin të qartë se kjo ishte vetëm një fazë kalimtare. Në vitet e vona të 70-tës, udhëheqësi i Qendrës Islame në Bern inicon planet për ndërtimin e xhamisë së parë në Zvicër. Ajo, dhomat e saj i kishte në një garazhë të konvertuar motorash në regjionin më të madh të Bernit. Autoritetet e mbështetën këtë projekt, mirëpo ai u fundos nga një plebishit mandatar.

Pas kësaj përvoje të hidhur, lindi mirëkuptimi në të dyja anët se nevojat e muslimanëve nuk mund të përmbushen pa mbështetjen e kishave zvicerane dhe të përfaqësuesve të tyre lokalë. Kishat donin të bashkëpunonin më intensivisht në këtë drejtim. Kështu që muslimanët tani kishin mundësinë t'i regjistronin dhe shprehnin shqetësimet e tyre, kurse nga ana krishtere, filloi të hapej dialogu si akademik ashtu edhe teologjik. Në vitet vijuese ky dialog u bë akoma më intensiv për ata që merrnin pjesë në të. Mirëpo kaloi një kohë e gjatë pa rezultate konkrete për bashkësinë muslimane.

Shoqata e sotme e të krishterëve dhe muslimanëve të Zvicrës

Kah fundet e vitit 1980, u ngrit çështja si të mundësohen varrezat islame. Në vitin 1990 u themelua një shoqatë, e cila në fillim u quajt 'Shoqata e të krishterëve dhe muslimanëve të Bernit', kurse më vonë 'Shoqata e të krishterëve dhe muslimanëve të Zvicrës'. Qëllimi i saj ishte ta drejtonte një transformim praktik. Në dymbëdhjetë vitet e fundit, anëtarët e kësaj shoqate çështjes së varrezave islame ia kanë bashkëngjitur edhe një sërë çështjesh të tjera: informimi i përgjithshëm mbi Islamin, martesat dhe familjet krishtero-islame, përkujdesja shëndetësore si dhe fëmijët muslimanë në shkollat e shtetit.

Komiteti i kësaj shoqate është gjysmë musliman, gjysmë krishter. Përkundër këtij pariteti në numër, nuk mund të flasim për barazinë e plotë. Shumica e anëtarëve krishterë të komitetit janë nëpunës ose të kishës romak-katolike ose të asaj protestane. Ata punojnë sipas direktivave të punëdhënësve të tyre. Ata kanë në dorë infrastrukturën dhe fondet. Ata kanë ndikim mbi popullatën dhe mbi politikën. Shumica prej tyre janë të profesionalizuar në lëmin teologjik, organizativ dhe juridik.

Anëtarët muslimanë të komitetit janë pak a shumë laikë. Përkushtimi i tyre mbështetet në përpjekjet private. Ata nuk kanë përkrahje institucionesh muslimane dhe nuk kanë mbështetje financiare. Pjesa më e madhe e anëtarëve muslimanë të komitetit janë të gjeneratës së parë dhe, edhe pse kanë jetuar në Zvicër për një kohë të gjatë, akoma kohë pas kohe paraqiten vështirësi në të kuptuarit e njëri-tjetrit në aspektin gjuhësor, kulturor dhe të

mentalitetit. Mirëpo, nuk ka hendek brezash. Të gjithë anëtarët e komitetit kanë të kryer universitete, shkolla të larta ose arsimim profesional.

Dialogu së shpejti sa ka marrë vrullin e tij në një nivel shumë konkret lidhur me pyetjet që kanë të bëjnë me martesën krishtero-islame, të ngritura nga priftërinjtë krishterë dhe nga gratë krishtere të Zvicrës. Për kishat, pyetja lind – si të ruhet respekti ndaj të dyja palëve dhe traditave në një martesë të tillë? Janë diskutuar çështje juridike lidhur me vlefshmërinë e ligjit për martesën, shkurorëzimin, arsimimin fetar të femrave etj. Vëmendje e madhe, gjithashtu, i është kushtuar edhe përvojave shoqërore dhe kulturore të imigrantëve. Të gjitha këto informata janë përmbledhur në një broshurë në gjuhën gjermane të titulluar '*Një familje – dy fe*'.

Në rend të dytë vjen përkujdesja shëndetësore. Çështjet e ngritura nga ana e mjekëve, motrave shëndetësore dhe drejtuesve të spitaleve lidhur me pacientët muslimanë, kanë çuar në përpilimin e një broshure të dytë: '*Muslimanët në spital*'. Kjo i diskuton temat aq delikate siç janë kërkesat e të ushqyerit, vendet dhe kohët për lutje, vizitat, transfuzioni i gjakut, fertilizimi artificial, autopsia, shkaktimi i vdekjes etj. Debatë lidhur me dhurimin e organeve i ka përçarë muslimanët në dy grupe. Ndërkohë, drejtues të ndryshëm spitalesh e kanë kuptuar nevojën për një dhomë lutjeje jo vetëm për muslimanët, por edhe për hindusët, çifutët, budistët dhe të tjerët. Në spitalin qendror të Bernit para një viti u themelua e ashtuquajtura 'dhoma e qetësisë'.

Broshura e tretë që e kemi botuar ne ka të bëjë me fëmijët muslimanë në shkollat zvicerane. Kjo broshurë, që u drejtohet prindërve të tyre, për momentin është në gjuhën gjermane dhe frënge. Shpresojmë që deri kah fundi i vitit ta kemi edhe në gjuhën turke, arabe dhe shqipe. Ajo e diskuton bashkëpunimin ndërmjet prindërve dhe mësuesve, kalendarin islam me festat e tij, kërkesat ushqimore si dhe pjesëmarrjen në aktivitetet sportive dhe kampet shkollore. Po ashtu, në të do të mund të gjeni një kapitull që diskuton për fëmijët muslimanë dhe traditat krishtere në shkollë.

Një shqetësim qendror i viteve të fundit ka qenë mungesa e varrezave muslimane. Në Zvicër varrezat janë nën administrimin e bashkive (administratave komunale). Kjo do të thotë se secili qytet dhe secili fshat ka rregullativat e tij të veçanta. Deri para dy vitesh, varrosja e muslimanëve mund të bëhej vetëm në Gjenevë. Kjo varrezë u themelua kah mesi i viteve 1980, kur atje e ndërta edhe xhamia. Mirëpo, atje lejohej të varroseshin vetëm ata që kishin jetuar në Gjenevë. Ajo nuk ishte paraparë për muslimanët e tjerë. Me rritjen e imigrimit musliman, problemi u bë akoma më kritik. Shumë muslimanë turq, duke paguar çmime të larta, i bartnin trupat e familjarëve të tyre për në Turqi, përkundër shkeljes së traditës islame sipas së cilës kufoma duhet varrosur brenda 24 orësh.

Para disa vitesh, Shoqata e të krishterëve dhe muslimanëve të Zvicrës shtroi kërkesën për një varrezë muslimane në Bern. Për arsye politike, u provua se ishte e pamundur të kishte një varrezë private muslimane. Mirëpo, muslimanët ia arritën t'i shfaqin nevojat e tyre: varrezat duhej të ishin të drejtuara kah Meka; trupat supozohej të varroseshin me qefin, e jo me arkivole (tabuta); varrezat duhej të ishin të përhershme. Varrosja me qefin gjithashtu nuk u lejua. Si një kompromis muslimanët pranuan të përdorin një arkivol të hollë druri të bërë nga bredhi i butë. Mirëpo varrezat e përhershme ishin ngeca më e vështirë. Në Zvicër ka prirje që të shkurtohet koha për prishjen dhe zhdukjen e një varri. Sot kjo mund të bëhet pas 25 vitesh. Tre çerekë të protestantëve sot e kësaj dite anojnë kah djegia e kufomave në kremator. Kjo praktikë nuk është e lejuar në Islam. Është me interes të përkujtohet një praktikë e përgjithshme krishtere e Mesjetës, sipas së cilës është përdorur varri i përgjithmonshëm: pas një kohe të caktuar eshtrat janë tubuar dhe deponuar në një pjesë qendrore të varrezës të quajtur 'shtëpia e eshtrave'.

Kështu, që nga viti 2000, muslimanët e Bernit mund të varrosen sipas traditave të tyre. Një fushë prej 200 varresh është në disponim të tyre në varrezën e qytetit të Bernit. Me këtë, për 50 vitet e ardhshme është zgjidhur problemi i varrimit të muslimanëve që jetojnë përreth Bernit. Me zgjidhjen e problemit të varrezave në Bern, të ndjekur nga Baseli dhe më vonë Zürichu – ku ka qenë opozita më masive politike, nuk është zgjidhur e njëjta çështje edhe gjetiu në Zvicër.

Së fundi, ne e kemi diskutuar edhe arsimimin fetar në Zvicër. Në shkollat publike, arsimimi fetar është rregulluar ndryshe-ndryshe nëpër secilin kanton. Ose shkolla organizon një klasë për të gjithë fëmijët e një feje, me nga një mësues që zakonisht është i krishter, ose bashkësia vetë e merr përgjegjësinë për arsimimin fetar. Mirëpo, edhe në rastin e fundit bile, kjo orë mbahet në shkollat publike. Për fëmijët muslimanë nuk ekziston një mundësi e këtillë. Ata ose e vizitojnë një qendër islame bashkë me prindërit e tyre, ku ata mbajnë orë të Kur'anit, ose vetë prindërit ua mësojnë fëmijëve të tyre praktikën fetare, e cila shpesh ndodh me shumë paragjykime. Megjithëkëtë, nuk ka udhëzime për standardet etike të Islamit, nuk ka ndihmë për fëmijët muslimanë t'u gjejnë përgjigje pyetjeve si muslimanë në një shoqëri joislame dhe nuk ka udhëzime për ta inkurajuar krahasimin e shumë vlerave të ngjashme të Islamit dhe Krishterimit.

Është e qartë se mësuesit e qendrave islame nuk i përmbushin standardet e nevojshme për t'ia mësuar popullit Islamin. Imamët, siç përmendi Francis Piccandi, të shumtën e herave sillen nga vende të ndryshme islame. Disa herë ata qëndrojnë këtu vetëm dy a tri vjet dhe nuk familjarizohen me rrethanat zvicerane. Shpesh ata nuk e mësojnë gjuhën e vendit dhe si rezultat paraqitet një mungesë e të kuptuarit të shqetësimeve të anëtarëve të bashkësisë. Në të ardhmen, duhet të sigurohet mundësia që imamët e Zvicrës të mund të arsimohen këtu në Zvicër, në të njëjtin nivel teologjik siç ekziston për priftërinjtë e krishterë. Standardi i mësimit të Islamit për fëmijët duhet të jetë i njëjtë sikur që është edhe për mësuesit e tjerë. Kjo do të ndodhte sikur të hapej një fakultet i shkencave islame, që do t'i ngjitej një universiteti zviceran. E ardhmja do të tregojë se si do të zhvillohet atmosfera politike në Zvicër dhe se a do ta pranojë popullata zvicerane Islamin si një fe me shumë vlera në organizmin e saj.

ISLAMI NË ZVICËR: DISKUTIMI

Kryesuar nga Farian Sabahi, folësit Francis Piccand dhe Amira Hafner al-Jabaji u përgjigjen pyetjeve të spektatorëve.

A po veçohen muslimanët ?

Spektatori i parë: Mua më duket se në Zvicër muslimanët thjesht nuk konsiderohen si njerëz me një fe specifike, porse ka njëfarë racizmi ndaj tyre. Ju thatë se disa muslimanëve fundamentalistë nuk u jepen viza apo nënshtetësi. A vlen i njëjti rregull, të themi, edhe për fundamentalistët çifutë apo ndaj ndonjë tjetri që ka mendime politike ekstreme, siç janë për shembull personat nacistë? Nga arsyeja se, sipas mendimit tim, fundamentalizmi është diçka që ekziston në çdo fe – nuk është i kufizuar me Islamin.

Farian Sabahi: Për sa u përket lejeve dhe vizave, marrja e tyre nuk është problem vetëm për muslimanët, por edhe për të gjithë imigrantët në Zvicër.

Francis Piccand: Unë pajtohem që ndoshta Islami sot ka probleme. Pas sulmeve terroriste në Shtetet e Bashkuara, mendimet janë polarizuar tej mase. Unë mendoj që liderët fetarë muslimanë duhet të sqarojnë që Islami vërtet është fe paqeje dhe tolerance. Për fat të keq, ka liderë që e thonë të kundërtën – se të kesh mëri e armiqësi është një shkrim hyjnor. Nuk është e rrugës që liderët fetarë të flasin për çështje të këtilla. Për të dëftuar se ç'thonë njerëzit në përgjithësi për fetë, e sidomos për Islamin, në Zvicër, mund t'ju sjell një krahasim. Kur erdhëm këtu në Angli prej Zvicre na u desh të vozisnim në anën e majtë të rrugës e jo në të djathtë – përse? Kur të mbërrish në një vend duhet të adaptohesh – pa e harruar kulturën dhe fenë tënde, çka është një çështje në vete.

Si mund të gjejnë shprehje vlerat islame?

Spektatori i parë: Unë mendoj që ka dallim midis ligjit të një vendi dhe vlerave të po të njëjtit vend. Një person i një partie socialiste dhe një tjetër i një partie konservatore në një vend evropian nuk i ndajnë të njëjtat vlera. Mirëpo, ekziston një ligj (e drejtë) në secilin vend të cilit duhet nënshtrohet. Po qe se ai ligj bie ndesh me vlerat apo me kulturën e një grupi njerëzish, ata kanë të drejtën të luftojnë kundër atij ligji, mirëpo ky luftim duhet të bëhet nëpërmjet sistemeve legale që ekzistojnë në demokraci. Muslimanët, sikurse çdo pakicë tjetër, duhet t'u nënshtrohen këtyre ligjeve, mirëpo në qoftë se ju kërkoni më tepër se kjo, mendoj se kjo është e padrejtë. Ata kanë të drejtë të kenë vlera të tyre të ndryshme. Ju të gjithë thatë se jeni imigrantë qysh para njëqind vjetësh dhe se kjo është një bukuri e botës së sotme, pra që të gjithë ne po i bartim vlerat tona nga vende të tjera.

Amira Hafner al-Jabaji: Unë pajtohem deri diku, mirëpo duhet të analizojmë fillimisht nëse vërtet ekziston një dallim midis vlerave të vendeve evropiane dhe vlerave të Islamit. Problemi i Hani Ramadanit është se ai flet në emër të Islamit. Kur ai thotë 'ky është mendimi im', askush nuk reagon, sepse çdokush mund të thotë ç'të dëshirojë sipas mendimit të vet personal. Mirëpo, kur ai thotë se në Islam gjërat janë kështu apo ashtu, atëherë bëhet problematike.

Në Zvicër, imamët shprehin mendime dhe vlera të ndryshme. Islami, sikurse shumë fe të tjera, është i ndryshëm dhe i larmishëm – ka shumë mendime të ndryshme brenda tij. Unë e kuptoj që shoqëria zvicerane mund të jetë shumë e re për ta kuptuar Islamin, mirëpo është gabim të merret mendimi i ndonjë personi mbi Islamin si i vetmi mendim i mirëfilltë.

Një pikturë më e gjerë mbi Islamin

Spektatori i dytë: Një faktor të cilin ne shpesh e injorojmë është se një shumicë e njerëzve tanë, 90 % ose edhe më tepër e imigrantëve muslimanë në Britani, vijnë nga zonat rurale. Unë besoj se sikur këta njerëz të nënkontinentit të Indisë të kishin shkuar në Karaçi apo Dakar, do të kishin patur vështirësi për t'u adaptuar në atë mjedis. Për shembull, mendo për ndryshimet që kanë ndodhur te një zelltar fetar në Bangladesh i cili krejt paparamendueshëm ka arritur këtu. Kjo patjetër duhet të kihet parasysh. Gjeneratat tona të treta e të katërta janë shumë të ndryshme. Ata kuptojnë, janë të lindur këtu, shprehen mjaft mirë dhe mund të ndërveprojnë në dialog.

Ka disa probleme të tjera. Ne jemi të pushtuar nga Islami fundamentalist. Derisa Bashkimi Sovjetik nuk e kishte pushtuar akoma Afganistanin, neve në sistemin arsimor britanez në Indi na thoshin se disi jemi në të njëjtën anë – në anën e Perëndimit fetar, të Amerikës e të Islamit – dhe të gjithë ne dalloheshim prej komunizmit të pazot, të pafe. Kur Bashkimi Sovjetik e pushtoi Afganistanin, shumë pak prej nesh kuptuan se Amerika ishte e interesuar ta çlironte Afganistanin për shkak se ajo e dinte se ç'flinte në Azinë Qendrore. Ne shihnim një lloj aleance midis dy popujve fetarë. Mirëpo, me rënien e Bashkimit Sovjetik, Amerikës nuk i duheshin më luftëtarë të shenjtë, me çka u mbyll edhe kjo kaptinë. Bërësit e politikës së jashtme amerikane kërkonin një lugat tjetër, që do të mbjellte mjaft mëri në Evropë e Amerikë. Faturën e pagoi Islami, ndër të tjera për shkak të kryqëzatave. Tani, nëse dëshirojmë t'i ndreqim marrëdhëniet tona, të dyja palët duhet të japin mundin e tyre.

Edhe një gjë. A jemi ne – sidomos akademikët dhe dijetarët tanë – të hapur e të drejtë për ta quajtur këtë qytetërim modern, 'qytetërim hebreo-krishter'? A nuk është e vertetë se Islami i ka siguruar bazat e Renesancës dhe Iluminizmit në Evropë? Përse nuk e quajmë këtë qytetërim 'hebreo-krishtero-islamik'? Duke e injoruar këtë të vërtetë, ndoshta ne pa vetëdije u kemi thënë popujve muslimanë se ata janë larg torruas, larg qytetërimit. Kjo mënyrë e të menduarit i ka shpënë disa njerëz së paku të thonë se ekziston një përplasje qytetërimesh. Mirëpo, nëse jemi pjesë e qytetërimit, nuk mund të ekzistojë një term i tillë. Islami ka kontribuar me të madhe, mirëpo si të gjitha qytetërimet, ka rënë. Ai ka rënë nga aspekti intelektual, duke mos arritur të prodhojë ide të reja e më të mira. Sigurisht që kjo ka çuar në rënien politike, shoqërore dhe kulturore si dhe në rënien e tërësishme të qytetërimit islam. Si rezultat, muslimanët kanë mbetur mbrapa në gjuhët moderne dhe në idetë shkencore. Ata nuk janë të njoftuar me paradigmen e re shkencore që është paraqitur.

Pas 11 shtatorit 2001, një numër i konsiderueshëm i njerëzve pranuan se muslimanët janë viktimë e shtypjes dhe shpronësimit, derisa për vetë muslimanët filloi procesi i vetëkritikës. Ka lindur ideja se në shek. XVIII, kur ka ngrirë mendja jonë, ke mundur të tërhiqesh nëse nuk ke dashur diçka. Ke ikur në shkretëtirë duke shpresuar se një ditë do të dalësh në diçka tjetër dhe më të mirë. Mirëpo, tani kur po jetojmë në një rrjet marrëdhëniesh globale, rruga e vetme që kemi përpara është të ndërveprojmë dhe të angazhohemi vazhdimisht për të krijuar hapësirë.

Gjetja e bazës së përbashkët

Spektatori i tretë: Kemi dy pika, një kritike dhe një pozitive. Në fillim, m'u duk se pak si tepër u vu theksi mbi Islamin si një problem i Zvicrës. Sigurisht, duhet të jemi realistë. Mendoj që nëse dikush e paraqet një model kulture apo feje si problematik, ai tenton të ketë një profeci (parashikim) të vetërealizueshme. Mënyra për t'u bërë ballë këtyre stereotipeve negative është theksimi i kontributit kulturor që Islami ia ka dhënë Evropës dhe qytetërimit perëndimor – duke e përtërirë pikën e përmendur më herët. Në këtë vend tani kemi një theksim marramendës të kontributit që Islami ia ka dhënë poezisë dhe filozofisë. Shën Toma Akuini, mbreti i teologëve të kishës perëndimore, i ka shumë borxh Ibni Rushdit (apo Averroes-it në latinisht), komentatorit të madh të Aristotelit në Spanjën islame. Më duket se na duhet që këtë edukim kulturor ta bartim nëpër shkolla, në një kontekst më të gjerë. Kjo është një rrugë për të përçarur një fotografi pozitive mbi Islamin.

Pika e dytë e imja ka të bëjë me dialogun e kishave krishtere me muslimanët, që duket se është e vetmja paradigmë për të shkuar përpara. Ajo për çka mund të flisni për muslimanët është se ata kujdesen për fenë e tyre sikurse edhe kishat për të veten, kështu që ata kanë një bazë për t'u kuptuar që është shumë frytdhënëse dhe që duhet pranuar nga kultura jonë papërmbajtësisht sekulare.

Këtu dua të theksoj se ndoshta këtu ka një bazë për një farë përrulësie që duhet ta kemi ne evropianët. Ne duhet të jemi një çikë më autokritikë, sepse jo të gjitha vlerat tona janë dukshëm të drejta ose tërësisht të mira.

Amira Hafner al-Jabaji: Unë shpesh dëgjoj prej njerëzve që punojnë për kishat se nuk është dhe aq rëndë ta bësh këtë dialog, sa mendojnë njerëzit sekularë. Ne jemi të një niveli për nga aspekti i besimit dhe vlerave. Për mua është shumë më vështirë të bësh dialog me njerëzit sekularë që nuk kanë fe dhe që nuk besojnë.

Francis Piccand: Ne e kemi rrahur më se një vit këtë duke tentuar t'i gjejmë temat e diskutimit dhe aktualisht është shumë vështirë të gjesh një pikënisje. Në fillim duket se Krishterimi dhe Islami kanë disa pika të përbashkëta nisëse, mirëpo dalin pengesa – nuk di pse.

Spektatori i tretë: Më kujtohet një misionar krishter i cili ishte burgosur nga ana e talibanëve pak përpara se të fillonte lufta në Afganistan. Kur u lirua ai deklaroi se e kishte patur më lehtë të bisedonte rreth Zotit me një taliban sesa me një të popullit të vet gjerman. Kështu që, mendoj se nëse vetëm pak përpiqemi, ndoshta do të gjejmë shumë pika të përbashkëta me muslimanët – shumë më tepër sesa që gjejmë disa herë me njerëzit e kulturës sonë të cilët e kanë braktisur trashëgiminë e tyre shpirtërore. Ndoshta Zvicra do të duhej t'i inkurajonte kishat të shkonin edhe më tej në këtë drejtim.

Francis Piccand: Për cilin Islam e kemi fjalën? Për Islamin e Afrikës? Atë të Azisë? Atë të Lindjes së Mesme? Islami është aq i ndryshëm sa edhe njerëzit me të cilët takohesh dhe bisedon. Nuk duhet harruar se në Zvicër ka shumë muslimanë që nuk ushtrojnë asgjë fetare. Ajo çka është me rëndësi për gjeneratën e tretë dhe të katërt të muslimanëve është të gjejnë një vend pune dhe të kenë një jetë të mirë – feja thjesht nuk është më prezente te ta.

Ruajtja e trashëgimisë dhe edukimi për në ardhmëri

Spektatori i katërt: Më interesoi shumë ajo që Amira Hafner al-Jabaji foli për pikat specifike të muslimanëve që jetojnë në Zvicër. Ju thatë se popullsia e përgjithshme e tyre përbëhet nga të rinjtë. Unë mendoj se është problem kulturor ajo që këta të rinj kanë ide aq të ndryshme lidhur me mënyrën e trajtimit të femrave. Kam bijat e mija në Zvicër të cilat ankohen për këtë gjë edhe pse ata janë shumë mendjegjerë dhe të gjithë ne i pranojmë muslimanët si njerëz të njëjtë sikurse ne. Por problemi qëndron në vlerat që ata ua mësojnë të tjerëve. Ne jetojmë në një kohë kur femrat janë aq krenare që tani në Zvicër janë të barabarta. Si do të duhej t'i edukonit fëmijët e rinj muslimanë nëpër shkolla? Do të duhej t'i mbanit ata të ndarë apo t'i integronit nëpër shkollat zvicerane dhe t'ua mësonit atyre vlerat me të cilat aq shumë mburremi?

Amira Hafner al-Jabaji: Ne e dëshirojmë një shkallë integrimi. Ne nuk duam t'ua mësojmë atyre Islamit vetëm nga ana e tij praktike. Ne nuk duam t'ua mësojmë atyre se si duhet të luten ose kuptimin e Ramazanit – këtë mund ta mësojnë nga prindërit ose në shkollat e Kur'anit apo në xhami. Ajo që na nevojitet nëpër shkolla është t'ua mësojmë standardet etike – si të sillen, ç'janë vlerat e Islamit – dhe t'u tregojmë atyre se ato nuk dallojnë shumë prej vlerave krishtere. Mirëpo akoma nuk e kemi arritur këtë. Deri më tani nuk kanë ekzistuar mundësi të këtilla për t'ua mësuar atyre këto. Ata shkojnë në xhami dhe nuk e dimë ç'mësojnë atje, ngase publiku është i përjashtuar nga vende të këtilla. Nëse askush nuk e di se çfarë duhet të mësojnë fëmijët atje, atëherë askush nuk mund ta kontrollojë atë që e mësojnë. Kjo është e rrezikshme – e rrezikshme jo vetëm për muslimanët, por edhe për jomuslimanët. Sikur kjo të bëhej haptazi, çdokush do të mund të shihte se ç'mësojnë ata dhe zviceranët jomuslimanë do të shihnin se nuk ekziston kurrfarë rreziku që fëmijëve t'u mësohet Islami. Tani është koha për t'i bindur zviceranët se ekziston nevoja që fëmijëve muslimanë t'u mësohet Islami nëpër shkollat publike.

Në gusht 2002 ne e filluam këtë në dy vende: në Kriens, që ndodhet në pjesën qendrore të Luzernit, dhe në Ebikon, që gjithashtu është afër Luzernit. Aktualisht këto janë regionet më konzervative. Ka dy shkolla fillore që kanë arsimuar femra muslimane në Gjermani për të dhënë mësimin fetar islam nëpër shkolla. Vetëm pas dy javësh, patëm tituj shumë negativë nëpër gazeta, sepse kishin zbuluar se institucioni ku ishin arsimuar këto mësuese të reja, na paska qenë shumë i ngushtë me *Milli Görüş*-in, që është një parti opozitare në Turqi. Së shpejti filluan të përdoren fjalët 'fundamentalizëm' dhe 'ekstremizëm', edhe pse projekti ishte një gjë shumë e mirë. Mësuesit, mësueset muslimane, autoritetet e shkollës, fëmijët, prindërit e fëmijëve, të gjithë ishin të lumtur. Shpresojmë që kjo ide të përhapet gjithandej, mirëpo deri më tani kjo ndodh në vende shumë të vogla.

Tejkalimi i pengesave për dialog

Spektatori i pestë: Francis Piccandi përmendi ekzistimin e grupeve të ndryshme që konkurrojnë për të tërhequr vëmendjen e bashkësive të tyre. Unë vetëm dëshiroj t'ju pyes juve të gjithëve nëse keni njohuri për atë se cila prej atyre grupeve ka fituar, në mos, për shembull, janë përhapur saudianët dhe dega e tyre e Islamit vehhabit, apo ata të Milli Görüş-it? Së dyti, a ekziston ndonjë debat midis këtyre grupeve mbi çështje të rëndësishme teologjike dhe sociale apo ata thjesht duan vetëm t'i shesin versionet e tyre?

Francis Piccand: Pyetjes Suaj të parë, do t'i isha përgjigjur se ajo është çështje parash. Qendra islame në Gjenevë finansohet nga Arabia Saudite dhe keni vende të tjera që finansohen nga Emiratet. Nuk ka fitues në këtë drejtim dhe ky është problemi për komunitetin

musliman, që nuk kanë një trup përfaqësues. Ju mund të gjeni liderë në Gjenevë dhe në Zürich që nuk pajtohen me njëri-tjetrin. Midis tyre ka dialog - herë-herë me rezultate të mira – por ka edhe konflikte. Liderët si Tariq Ramadani mundohen të thonë se i përfaqësojnë të gjithë muslimanët e Zvicrës, madje edhe ata të Evropës, por këta edhe kontestohen.

Spektatori i gjashtë: Po që se duam që dialogu të ketë sukses, së pari duhet t'i përcaktojmë parimet, qëllimet dhe objektivat tona. Ne nuk flasim për gjithçka të Islamit – Islami si fe dhe kulturë apo Islami në histori dhe politikë. Pra, cilat janë zonat ku duhet të përqëndrohemi? Për shembull, është shumë me rëndësi të përqëndrohemi në shkollat apo në politikë e në institucione të ndryshme që na mundësojnë të jetojmë së bashku. Dialogu është shumë i lehtë në qoftë se ai bëhet ndër njerëz që e dinë se ç'presin prej tij – ata që duan t'i flasin njëri-tjetrit i dinë qëllimet e tyre shumë qartë. Është shumë lehtë të vish me qëndrime individuale dhe të bëhesh bashkë shumë suksesshëm, dhe unë e mbështes këtë. Mirëpo, kjo varet nga ajo se sa të qarta janë qëllimet, si mund të jenë të qarta ata që janë në dialog lidhur me atë se ç'nevojiten shkollat – ç'nevojitet gjenerata e re. Duhet të shikojmë nëse mund të krijojmë diçka si një plan-program shkollor.

Spektatori i shtatë: Shtimi i dialogut qartë është një ide shumë e mirë, mirëpo duhet të hetohet edhe paralajmërimi i rëndësishëm, se nuk duhet t'i përfshijmë vërejtjet ofenduese. Nëse angazhohesh në bisedime me njerëz duhet t'i japish fund krahasimit dhe mospajtimit. Herë-herë ti e ndërton mendimin gjatë këtij procesi të mosmarrëveshjes. Ajo që më brengos mua është se duhet dhënë fund censurimit të ideve dhe pikëpamjeve të njerëzve. Pse nuk e zëvendësoni paralajmërimin kundër vërejtjeve ofenduese dhe t'i përfshini ato? Kjo është rruga e vetme për të patur një dialog të përshtatshëm.

Spektatori i tetë: Më intereson vallë a munden zvicëranët vendas që e kanë pranuar Islamin ta mbushin apo tejkalojnë këtë hendek midis zvicëranëve dhe Islamit. A mund këta njerëz që u takojnë të dy botëve të përdoren si ndërmjetës?

Amira Hafner al-Jabaji: Unë mund të flas nga përvoja ime – sidomos me gratë zvicërane që kanë kaluar në Islam – se ato kanë prirje të jenë më ekstremiste se imigrantet muslimane dhe mendoj se kjo shpesh ka të bëjë me çështje biografike. Askush nuk e di përse ato e ndërrojnë fenë. Ngandonjëherë ato gjejnë një partner musliman dhe martohen me të e pastaj e ndërrojnë fenë. Mirëpo nuk është lehtë të punosh me to, sepse atë që ato e dinë rreth Islamit e kanë mësuar prej burrave të tyre ose prej njerëzve të tjerë, e jo prej bazës, Kur'anit dhe Hadithit (traditës së Pejgamberit). Kjo është një vështirësi.

Spektatori i nëntë: Kuptova se ka tri grupe gjuhësh kryesore në Zvicër: italishtja, gjermanishtja dhe frengjishtja. A ka ndonjë dallim në pranimin e muslimanëve ndërmjet këtyre tri grupeve gjuhësore dhe a ka ndonjëra pjesë e Zvicrës më shumë muslimanë se tjetra, në Zvicrën gjermanofone, Zürich apo në Gjenevë?

Amira Hafner al-Jabaji: Shumica e muslimanëve të ardhur nga Afrika veriperëndimore janë vendosur në Zvicrën perëndimore ku flitet frengjisht dhe ata zakonisht e njohin gjuhën frenge qysh nga vendlindja. Këtu nuk hasen probleme sikurse në pjesën gjermanofone të Zvicrës, ku shumica e muslimanëve vijnë nga Ballkani, Turqia, Maqedonia apo Kosova e të tjera. Këta muslimanë gjithnjë e flasin gjuhën e tyre amtare dhe shpesh, për shkak të nivelit relativisht të ulët të arsimimit, nuk janë të motivuar ta flasin gjuhën lokale ose ta mësojnë gjermanishten. Herë-herë ata më mirë e flasin gjermanishten zvicërane sesa atë të lartën, letraren. Mirëpo, turqit flasin turqisht, shqiptarët shqip etj.

Gjuha vërtet është njëra prej arsyeve përse mungon marrëveshja dhe pse integrimi është aq i rëndë. Ne tani kemi bërë sugjerime në drejtim të ofrimit të kurseve gjermane për femrat muslimane. Në fillim, për shembull, pati një shkollë që përgatiti një program të vogël dhe këtë program e qarkulluan shtëpi më shtëpi. Mirëpo, femrat turke, për shembull, nuk e lexojnë atë.

Ato thjesht e hedhin atë mënjanë. Kështu ata zbuluan se më mirë është që këtë ofertë ta bëjnë nëpërmjet fëmijëve të shkollave. Fëmijët shkojnë në shkollë ku mësuesit u japin atyre informata me shkrim lidhur me mundësinë e mësimit të gjermanishtes. Kur ata i çojnë ato informata në shtëpi dhe kur nënat e tyre i lexojnë ato, përnjëherësh i ke klasat e mbushura me gra. Kështu, ndonjëherë nevojitet diçka shumë e vogël për të bërë ndryshime.

Fundamentalizmi dominon në debat

Spektatori i dhjetë: Unë kam disa pyetje lidhur me zgjidhjet që i sugjeruat ju në përpjekjet për t'u marrë me problemin e fundamentalizmit islam pas 11 shtatorit dhe me rëndësinë e mësimit të tolerancës dhe respektit si dhe me inkurajimin e një versioni tolerant të Islamit. Nga përvoja ime e prezentimit në disa qarqe të grupeve fundamentaliste islame, toni i këtyre djelmoshave shpesh është shumë kundër kësaj ideje të tolerancës. Ata kërkojnë rregulla, ata dëshirojnë të luftojnë për diçka dhe sikur toleranca e Tony Blairit i fton ata të bëhen më luftëdashës e më agresivë. Kështu që nuk jam i sigurt se sa efektiv mund të jetë inkurajimi i tolerancës, sepse mendoj që kjo shpesh shkakton kundërshtim nga ana e rinisë muslimane.

Rreth ngritjes së institucioneve islame – tani së voni kemi patur mjaft raporte në Angli për përvojën e ndërtimit të institucioneve në vitet '80. "Ndarja institucionalizuese" ishte njëra ndër frazat që përmendeshin sepse, parimisht, ndërtimi i këtyre institucioneve të ndara islame krijoi shumë ndarje në mesin e bashkësive. Në shumë raste, institucionet nuk përgjigjeshin ndaj anëtarëve të vetë bashkësive. Më intereson si do të vepronin ju në këtë drejtim në Zvicër?

Francis Piccard: Unë pajtohem plotësisht me ju për këtë radikalizëm dhe për faktin se këto ndjenja janë shumë të fuqishme. Kur unë bisedoj me muslimanët dhe kur ata thonë diçka për politikën dhe Amerikën apo Izraelin për shembull, fjalimet e tyre janë shumë të dhunshme. Vërtet duhet sa më shpejtë të bëjmë diçka. Mediat me siguri mund të luajnë rol të rëndësishëm në këtë dialog.

Sa i përket këtij polarizimi, mua më ka habitur edhe toni i disa njerëzve që punojnë në zyrat federale të Zvicrës dhe në ato të policisë. Shumë qendra ndërmjet Gjenevës dhe Zürichut tani vërtet janë nën mbikëqyrje. Fundamentalizmi nuk është vetëm islam, ai vjen edhe nga fe të tjera. Problemi është se sot mbas këtyre ngjarjeve – Bali është një shembull tjetër – muslimanët janë viktimizuar tërësisht. Hulumtuesi francez Gilles Kepel ka shkruar një libër mbi Islamizmin dhe ai thotë se ne tani jemi në një situatë të post-Islamizmit. Fundamentalizmi nuk është Islami – ai mund të jetë fundi i një forme të Islamit, ndaj cila mund të jetë e radhës? Është çështje me rëndësi të pyetemi dhe elementet përgjegjëse të të gjitha palëve duhet t'i flasim dhe ta pyesim njëri-tjetrin përse të ndodhin gjithë këto? Sot ne mund të komunikojmë dhe i kemi të gjitha kushtet për t'u munduar ta kuptojmë njëri-tjetrin, mirëpo duket se po ndodh e kundërta dhe muslimanët po viktimizohen nga ana e stereotipeve.

Spektatori i njëmbëdhjetë: Është shumë me rëndësi që ne duhet të përpiqemi t'u gjejmë ilaçin disa fenomeneve dhe të përpiqemi t'i gjejmë shkaqet e këtyre simptomeve. Kur ta shikojmë historinë e Islamit vetvetiu do të tregojë se ka qenë feja më tolerante në relacion me fetë e tjera. Spanja e Mesjetës është një shembull i mirë për këtë, me çifutët, krishterët dhe jomuslimanët që bashkëjetonin me muslimanët. Tani ç'është ajo që aktualisht e ka prodhuar dukurinë e Islamit fundamentalist prej të cilit ankohet aq shumë Perëndimi? Mendoj se është me rëndësi që edhe Perëndimi duhet ta shqyrtojë kontributin e tij dhënë kësaj shtete të sotme për më tepër se 250 vjet. Vetëm me sqarimin e kontributit perëndimor ne mund gjithashtu ta kuptojmë llojin e lidhshimit politik në botën islame, që pak a shumë mbështetet nga Perëndimi.

Spektatori i dymbëdhjetë: Mua më brengos zbalancimi i tolerancës dhe mungesa e qartësisë ndër njerëzit e thjeshtë që vijnë nga tradita krishtere për atë çka ne aktualisht besojmë. Desha t'ju pyes juve, Amira, nëse e keni vërejtur të njëjtën ndihmë dhe krah që e keni kërkuar për muslimanët t'u jetë dhënë feve të tjera. Mendoj se duhet të përshkohemi nga fundamentalizmi në moment dhe ndjej se muslimanët e thjeshtë jofundamentalistë – muslimanët tolerantë – duhet ta ngrenë më tepër zërin kundër fundamentalistëve dhe duhet të dëgjohet se veprojnë në këtë drejtim.

Amira Hafner al-Jabaji: Për muslimanët është shumë punë e lodhshme dhe e mërzitshme që gjithnjë të jenë në pozitë mbrojtëse, sepse ne vërtet kemi probleme të ndryshme. Derisa ne vërtet e kemi problemin e fundamentalizmit në një qendër ose në mesin e disa muslimanëve të paktë, kjo pakicë definitivisht nuk na përfaqëson neve të gjithëve. Muslimanët në shoqëritë joislame kanë probleme konkrete – si dëshirojmë ta ushtrojmë fenë tonë në jetën tonë, si mund ta shprehim vetveten në shoqëri, si mund të marrim pjesë në politikë, në ekonomi, në kulturë. Të flasësh vetëm mbi fundamentalizmin nuk i përfaqëson problemet që i kanë muslimanët.

PEIZAZHI FETAR I ZVICRËS, NË THYERJE*

Në regjistrimin e përgjithshëm të popullsisë zvicerane të bërë në vitin 2000, 41.8 % e popullatës deklarohen si romak-katolikë, 33.0 % si evangjelistë të reformuar. Të dyja kishat e mëdha të vendit në raport me vitin 1990, jo vetëm relativisht po edhe absolutisht kanë humbur ithtarë të tyre. Konstant mbetet pjesa e kishave të lira evangjeliste dhe e bashkësive të tjera protenstane (2.2 %), bashkësia e besimit çifut (0.2 %) dhe e kristo-katolikëve (0.2 %). Shumë është rritur numri i personave që nuk ndjejnë se i përkasin ndonjë kishë apo bashkësie fetare (11.1 %) si dhe numri i "grupeve të reja fetare" (7.1 %). Këtë e tregojnë vlerësimet e regjistrimit të popullsisë të vitit 2000 të bërë nga Enti Federal për Statistikë (Bundesamt für Statistik - BFS).

Rënia e rëndësisë së kishave vendore të Zvicrës shpjegohet me tri arsye: E para, një numër gjithnjë e më i madh i zviceranëve nuk ndjejnë se i përkasin ndonjë kishë të veçantë apo ndonjë bashkësie fetare. E dyta, është migrimi i njerëzve nga vende me tradita të tjera fetare. E treta, plakja demografike që i prek edhe kishat e vendit. Popullata e evangjelistëve të reformuar të Zvicrës është dukshëm më e moshuara.

Pafesia si stil jete

11.1 % e banorëve deklarohen se nuk i përkasin më ndonjë kishë apo bashkësie fetare. Këta janë 300 000 më tepër sesa në vitin 1990 (7.4 %). Në vitin 1970 numri i banorëve ateistë ka përbërë vetëm 1.1 %. Shkalla më e ulët e të pafeve haset te të rinjtë e moshës 14 dhe 16 vjeçare (që është mosha e krezimit) si dhe te ata të moshës 65 e më tepër vjeçare. Veçanërisht e lartë është te ata të moshës 30-50 vjeçare, të cilët gjenden në vllugun e aktiviteteve të tyre ekonomike dhe shoqërore. Meshkujt përcaktohen më dendur se femrat për mospërkatesi ndaj ndonjë kishë apo bashkësie fetare.

Ndërmjet kantoneve dhe regjioneve të Zvicrës ekzistojnë dallime të mëdha. Në zonat urbane numri i të pafeve është dyfish më i lart sesa në ato rurale. Së këndejmi, në pjesën franceze të Zvicrës numri i të pafeve është dukshëm më i madh sesa në pjesët gjermane dhe italiane. Harku i sekularizimit të fortë tërhiqet prej Gjeneve përpjetë përmes Waadtit, Neuenburgut, regjionit të Solothurnit, Baselit, Aargaus, qytetit Zürich e deri në Schaffhausen. Më së shumti të pafe ka kantoni Basel-Stadt me 31.0 %, i ndjekur nga Gjeneva me 23.0 % dhe Neuenburgu me 22.0 %. Shkalla më e ulët e të pafeve me 2-6 % është në pjesën e kantoneve katolike të Zvicrës qendrore, në St. Gallen, Appenzell Innerrhoden, në Jura, në Freiburg, në Wallis si dhe në Graubünden multikonfesionale.

* Kjo është një Komunikatë për shtyp e lëshuar nga shërbimi informativ i Entit Federal për Statistikë (Bundesamt für Statistik) i Zvicrës, Neuchâtel, 30 janar 2003.

Pluralizimi i bashkësive fetare përmes migrimit

41.8 % e popullatës deklarohen si romak-katolikë (1990: 46.2 %), 33.0 % si evangjelistë të reformuar (1990: 38.5 %). Të dyja kishat e mëdha të vendit në raport me vitin 1990, jo vetëm relativisht po edhe absolutisht kanë humbur ithtarë të tyre (- 363 000 persona). Konstant mbetet pjesa e kishave të lira evangjelite dhe e bashkësive të tjera protestane (2.2 %), bashkësia e besimit çifut (0.2 %) dhe e kristo-katolikëve (0.2 %).

7.1 % e popullatës deklarohen se i përkasin ndonjë kishë ose bashkësie tjetër fetare. Në vitin 1970 këta përbënin vetëm 0.7 %, në vitin 1990 përbënin 3.7 %. Pjesën më të madhe të këtyre "grupeve të reja fetare", që në të kaluarën në Zvicër kanë qenë shumë pak ose dobët të përfaqësuara, e përbëjnë pjesëtarët e bashkësive fetare islame me 4.3 % (311 000 persona) si dhe ata të kishës krishtere ortodokse me 1.8 % (132 000 persona). Pasonjë hindusët me 0.4 % (28 000 persona) dhe budistët me 0.3 % (21 000 persona). Gjithnjë e më shumë njerëz ndjehen të lidhur me fetë sinkretike, të cilat shfaqjen e besimit krishter e lidhin me atë të besimeve të tjera.

Ky pluralizim, në radhë të parë është pasojë e mërgimeve. Nga personat me shtetësi zvicerane vetëm 1.6 % deklarohen se i përkasin ndonjë prej "grupeve të reja fetare", kurse te të huajt ky numër përfaqësohet me 28.1 %. Dyfishimi i numrit të muslimanëve dhe i pjesëtarëve të kishës krishtere ortodokse që nga viti 1990, shpjegohet me imigrimet e bëra nga Bosnjë-Hercegovina, Serbia, Maqedonia dhe Kosova që nga zhbërja e ish Jugosllavisë. Shqiptarët e Kosovës dhe të Maqedonisë, të cilët njëherazi përbëjnë grupin më të madh të muslimanëve të Zvicrës, në radhë të parë gjithsesi përcaktohen në bazë të kombësisë dhe gjuhës e jo në bazë të përkatësisë së tyre fetare.

Pjesëtarët e "grupeve të reja fetare" përqëndrohen në Zvicrën veriperëndimore, në rajonin e gjerë të Zürichut dhe në Zvicrën lindore. Shkalla më e lartë e tyre vërehet në Basel-Stadt (10.8 %), në Glarus dhe St. Gallen (me nga 9.8 %), në Zürich dhe Schaffhausen (me nga 9.0 %) si dhe në Aargau dhe Thurgau (me nga 8.5 %). Këto "grupe të reja fetare", në tërë Zvicrën latine, përfaqësohen në shkallë prej 2.7 % në Jura dhe 7.1 % në Gjenevë, ndërsa larg nën mesataren përfaqësohet Tessina me 4.6 %.

Demografia e ndryshme e bashkësive fetare

Përkatësia ndaj një kishë ose bashkësie fetare kryesisht bartet nga prindërit të fëmijët. Prandaj, struktura demografike e një bashkësie fetare ndikon në zhvillimin numerik të saj. Kisha evangjelite e reformuar dhe ajo kristo-katolike, të cilat nuk kanë mund të përtërihen nëpërmjet imigrimit nga jashtë, janë moshuar dukshëm shumë. Te të reformuarit evangjelistë 26.2 % e anëtarëve të kishës janë të moshës 60 e më tepër vjeçare, kurse 28.0 % janë të moshës midis 40-60 vjeçare.

Kishat e lira evangjelite si dhe bashkësitë e tjera protestane janë dukshëm më të reja, më fuqishëm të orientuara në familje dhe kanë më shumë fëmijë. Vetëm 18.2 % e tyre janë të moshës mbi 60 vjeç. Këto grupe gjithashtu kanë integruar dukshëm më shumë anëtarë nga jashtë sesa kisha e reformuar evangjelite e vendit.

Struktura demografike e kishës romak-katolike është rinuar (përtërirë) mjaft nëpërmjet imigrimit nga Evropa jugore. Mbi 60 vjeçarët përbëjnë 20.2 % të besimtarëve, kurse 40 deri 59 vjeçarët 27.4 %. Natyrisht, numri i fëmijëve të romak-katolikëve ka rënë gjithashtu në nivelin e ulët të të reformuarve evangjelistë. Gjeneratat e fëmijëve janë të mëdha sa gjysma e prindërve të tyre, kështu që moshimi (plakja) në të ardhmen do të shpejtohet edhe më shumë.

Pjesëtarët e "grupeve të reja fetare" paraqesin një strukturë demografike krejt tjetër për dallim prej kishave vendore dhe grupit të të pafeve. Këta janë njerëz të rinj, me pjesëmarrje të mbi 60 vjeçarëve me vetëm 4.6 %. Numri i fëmijëve në familje është deri diku i lartë dhe gjeneratat e fëmijëve janë gati po aq të mëdha sa edhe të prindërve. Sipas kësaj, këto grupe kanë një potencial qenësish më të lartë të rritjes.

Zhduken kufijtë e vjetër fetarë, krijohen vija të reja ndarëse

Shtimi i personave të pafe, rritja e rëndësisë së feve jotradicionale, mobiliteti (lëvizshmëria) gjeografik dhe shtimi i martesave të përziara i kanë shlyer kufijtë e vjetër fetarë të Zvicrës. Në një brez të gjerë, kryesisht qytetesh, duke filluar prej liqenit të Gjenevës, përgjatë zinxhirit të Jurës e deri në liqenin e Bodnit dhe Rheintalin e St. Gallenit, nuk ka më kisha dhe bashkësi fetare qartë dominante. Protestantët janë dominantë vetëm në kantonin e Bernit (veçanërisht në Emmental dhe në pjesën perëndimore të Berner-Oberlandit), aty-këtu në Graubünden dhe në Schaffhausen, kurse romak-katolikët në Freiburg, Jura, Wallis, Tessin, Appenzell Innerhoden dhe në Zvicrën qendrore, jashtë zonës së Luzernit.

Zonat pa dominim fetar, megjithëkëtë, nuk janë homogjene. Tanimë janë krijuar vija të reja ndarëse. Pjesa franceze e Zvicrës përfaqësohet me një numër të madh personash që nuk i përkasin ndonjë kishe apo bashkësie fetare si dhe me një numër të ulët të pjesëtarëve të "grupeve të reja fetare". Zvicra veriperëndimore dhe verilindore, si pasojë e migrimeve, fuqishëm është e përfaqësuar nga "grupet e reja fetare". Në pellgun e Baselit, i cili merr një funksion ure, shtresohen të dy zonat e lartpërmendura.

Shtojca:

Tabelat:

1. Popullsia sipas fesë, kombësisë dhe gjinisë, 2000 (numri absolut dhe në përqindje).
2. Popullsia sipas fesë dhe kombësisë, dallimi midis viteve 1990-2000 (numri absolut dhe në përqindje).
3. Popullsia e kantoneve sipas fesë, 2000 (numri absolut).
4. Popullsia e qyteteve të mëdha sipas fesë, 2000 (numri absolut).
5. Kishat e lira evangjeliste dhe bashkësitë e tjera protestane, 2000 (numri absolut).
6. Grupet e reja fetare, 2000 (numri absolut).

(Grupet e reja fetare përfshijnë kishën e lindjes / ortodokse, të krishterët e tjerë, muslimanët dhe bashkësitë e tjera fetare).

Pyetja për përkatësinë fetare në regjistrimin e popullsisë

Zvicra multikonfesionale është një prej vendeve të rralla të Evropës, që në regjistrimin e popullsisë e shtron pyetjen për përkatësinë fetare. Pyetja është e vjetër dhe daton që nga regjistrimi i parë i përgjithshëm i bërë në vitin 1850. Deri në vitin 1900 për përkatësinë fetare janë pyetur vetëm katolikët, protestanët dhe çifutët. "Fetë e tjera" që nga viti 1860 janë përfshirë në një grup të mbetur, gjegjësisht "të tjerat". Asokohe është shkuar nga ajo se të gjithë banorët domosdo i takonin një feje. Në vitin 1900 për herë të parë u ofrua mundësia për precizimin e "feve të tjera". Më 1920 për herë të parë krist-katolikët u ndanë prej romak-katolikëve dhe në pyetësorin e regjistrimit të popullsisë u futën rubrikat e reja: "pa përkatësi fetare" dhe "pa përgjigje" (krahaso Bovay, "L'évolution de l'appartenance religieuse et confessionnelle en Suisse", OFS, Bern, 1997). Në vitin 1990 pyetja pësoi një ndryshim të lehtë dhe që atëherë thuhet: "Cilës kishë apo bashkësi fetare i përkisni?". Në vitin 2000 për herë të parë pyetësi hap rubrikën e zbrazur edhe për bashkësitë islame dhe kristo-ortodokse.

Gjatë procesit të sekularizimit ka rënë edhe rëndësia e përkatësisë fetare. Mirëpo, kjo akoma vlen si një indikator (tregues) i rëndësishëm i qëndrimeve, vlerave dhe i të kuptuarit të ndryshimeve shqorërore. Të dhënat e regjistrimit të popullsisë, për kishat dhe bashkësitë fetare të Zvicrës, në të shumtën e rasteve janë burimi i vetëm i informacioneve për zhvillimin dhe strukturën e pjesëtarëve të kishave. Me shtimin e feve që tradicionalisht kanë qenë shumë dobët ose aspak të përfaqësuara, pyetja për përkatësinë fetare ka fituar përsëri një aktualitet.

Që nga viti 1960 rritet numri i personave të cilët në regjistrimin e popullsisë nuk japin të dhëna për përkatësinë e tyre fetare. Në vitin 2000 numri i këtyre personave ishte 316 000 ose 4.3 % e popullsisë së përgjithshme. Posaçërisht i lartë është ky numër te të huajt me 8.7 %. Kjo korrespondon me atë se edhe përkundër garancës për mbrojtjen e të dhënave të regjistrimit të popullsisë zvicerane, deklarimi i përkatësisë fetare shpesh shikohet si çështje private. Në këtë ndikon gjithashtu edhe kuptueshmëria e shtrimit të pyetjes për personat nga qarqe të tjera kulturore si dhe vështirësia e përcaktimit të përkatësisë së fëmijës te martesat e përziera fetare. Te personat me shtetësi zvicerane e dhëna për fenë mungon në përmasa mbi mesataren te njerëzit e moshuar dhe te fëmijët. Te të huajt kjo mungon para së gjithash te familjet me fëmijë.

Meqë pyetja lidhur me përkatësinë fetare ka një komponentë të fuqishme subjektive, Enti Federal për Statistikë (EFS) heq dorë nga ajo që mungesën e të dhënave ta plotësojë me informata të shfrytëzuara nga konteksti (p.sh. në bazë të përkatësisë fetare të prindërve).

Tabela 1: Popullsia e Zvicrës sipas fesë, kombësisë dhe gjinisë, viti 2000 (numri absolut dhe në %)

	Gjithsejt		Meshkuj		Femra	
	absolut	në %	absolut	në %	absolut	në %
Popullsia e përgjithshme	7 288 010	100.0	3 567 592	100.0	3 720 418	100.0
Kishat dhe bashkësitë protestane	2 569 124	35.3	1 210 776	33.9	1 358 348	36.5
Kisha e reformuar evangjeliste	2 408 049	33.0	1 137 859	31.9	1 270 190	34.1
Kishat e lira ev. dhe bashk. tjera prot.	161 075	2.2	72 917	2.0	88 158	2.4
Kisha romak-katolike	3 047 887	41.8	1 476 026	41.4	1 571 861	42.2
Kisha krist-katolike	13 312	0.2	6 134	0.2	7 178	0.2
Kishat krist-ortodokse	131 851	1.8	64 278	1.8	67 573	1.8
Bashk. tjera krishtere	14 385	0.2	6 492	0.2	7 893	0.2
Bashk. e besimit çifut	17 914	0.2	8 774	0.2	9 140	0.2
Bashkësitë islame	310 807	4.3	169 725	4.8	141 082	3.8
Kishat dhe bashk. e tjera	57 126	0.8	28 237	0.8	28 889	0.8
Shoqatat budiste	21 305	0.3	7 881	0.2	13 424	0.4
Shoqatat hinduiste	27 839	0.4	15 692	0.4	12 147	0.3
Kishat dhe bashkësitë e mbetura	7 982	0.1	4 664	0.1	3 318	0.1
Pa përkatësi	809 838	11.1	437 863	12.3	371 975	10.0
Pa përgjigje	315 766	4.3	159 287	4.5	156 479	4.2
Popullata zvicerane	5 792 485	100.0	2 766 066	100.0	3 026 419	100.0
Kishat dhe bashkësitë protestane	2 474 882	42.7	1 163 552	42.1	1 311 330	43.3
Kisha e reformuar evangjeliste	2 332 746	40.3	1 099 936	39.8	1 232 810	40.7
Kishat e lira ev. dhe bashk. tjera prot.	142 136	2.5	63 616	2.3	78 520	2.6
Kisha romak-katolike	2 384 512	41.2	1 119 453	40.5	1 265 059	41.8
Kisha krist-katolike	12 791	0.2	5 839	0.2	6 952	0.2
Kishat krist-ortodokse	28 936	0.5	13 275	0.5	15 661	0.5
Bashk. tjera krishtere	9 471	0.2	3 972	0.1	5 499	0.2
Bashk. e besimit çifut	14 119	0.2	6 751	0.2	7 368	0.2
Bashkësitë islame	36 481	0.6	19 735	0.7	16 746	0.6
Kishat dhe bashk. tjera	19 388	0.3	8 932	0.3	10 456	0.3
Shoqatat budiste	11 124	0.2	4 220	0.2	6 904	0.2
Shoqatat hinduiste	2 096	0.0	1 095	0.0	1 001	0.0
Kish. & bash. e mbetura	6 168	0.1	3 617	0.1	2 551	0.1
Pa përkatësi	626 213	10.8	334 903	12.1	291 310	9.6
Pa përgjigje	185 692	3.2	89 654	3.2	96 038	3.2
Të huajt	1 495 525	100.0	801 526	100.0	693 999	100.0
Kishat dhe bashkësitë protestane	94 242	6.3	47 224	5.9	47 018	5.8
Kisha e reformuar evangjeliste	75 303	5.0	37 923	4.7	37 380	4.4
Kishat e lira ev. dhe bashk. tjera prot.	18 939	1.3	9 301	1.2	9 638	1.4
Kisha romak-katolike	663 375	44.4	356 573	44.5	306 802	44.2
Kisha krist-katolike	521	0.0	295	0.0	226	0.0
Kishat krist-ortodokse	102 915	6.9	51 003	6.4	51 912	7.5
Bashk. tjera krishtere	4 914	0.3	2 520	0.3	2 394	0.3
Bashk. e besimit çifut	3 795	0.3	2 023	0.3	1 772	0.3
Bashkësitë islame	274 326	18.3	149 990	18.7	124 336	17.9
Kishat dhe bashk. tjera	37 738	2.5	19 305	2.4	18 433	2.7
Shoqatat budiste	10 181	0.7	3 661	0.5	6 520	0.9
Shoqatat hinduiste	25 743	1.7	14 597	1.8	11 146	1.6
Kish. & bash. e mbetura	1 814	0.1	1 047	0.1	767	0.1
Pa përkatësi	183 625	12.3	102 960	12.8	80 665	11.6
Pa përgjigje	130 074	8.7	69 633	8.7	60 441	8.7

**Tabela 2 : Popullsia e Zvicrës sipas fesë dhe kombësisë,
dallimi midis viteve 1990 - 2000 (nr. absolut dhe në %)**

	2000		1990		Dallimi	
	absolut	në %	absolut	në %	absolut	në %
Popullsia e përgjithshme	7 288 010	100.0	6 873 687	100.0	414 323	6.0
Kishat dhe bashk. Protes.	2 569 124	35.3	2 798 012	40.7	- 228 888	-8.2
Kisha e reform. Evangje.	2 408 049	33.0	2 646 723	38.5	- 238 674	-9.0
Kishat e lira eva. dhe bashk. tjera protestane	161 075	2.2	151 289	2.2	9 786	6.5
Kisha romak-katolike	3 047 887	41.8	3 172 321	46.2	- 124 434	-3.9
Kisha krist-katolike	13 312	0.2	11 748	0.2	1 564	13.3
Kishat krist-ortodokse	131 851	1.8	71 501	1.0	60 350	84.4
Bashk. tjera krishtere	14 385	0.2	8 310	0.1	6 075	73.1
Bashk. e besimit çifut	17 914	0.2	17 577	0.3	337	1.9
Bashkësitë islame	310 807	4.3	152 217	2.2	158 590	104.2
Kish. & bashk. e mbetura	57 126	0.8	29 175	0.4	27 951	95.8
Pa përkatësi	809 838	11.1	510 927	7.4	298 911	58.5
Pa përgjigje	315 766	4.3	101 899	1.5	213 867	209.9
Popullata zvicerane	5 792 485	100.0	5 628 255	100.0	164 230	2.9
Kishat dhe bashkësitë protestane	2 474 882	42.7	2 700 119	48.0	- 225 237	-8.3
Kisha e reformuar evangjeliste	2 332 746	40.3	2 571 108	45.7	- 238 362	-9.3
Kishat e lira evangj. dhe bashk. tjera protestane	142 136	2.5	129 011	2.3	13 125	10.2
Kish.romak-katolike	2 384 512	41.2	2 434 613	43.3	- 50 101	-2.1
Kisha krist-katolike	12 791	0.2	11 356	0.2	1 435	12.6
Kish. krist-ortodokse	28 936	0.5	8 618	0.2	20 318	235.8
Bashk. tjera krishtere	9 471	0.2	6 911	0.1	2 560	37.0
Bashk. e besimit çifut	14 119	0.2	13 138	0.2	981	7.5
Bashkësitë islame	36 481	0.6	7 735	0.1	28 746	371.6
Kish. & bashk. e mbetura	19 388	0.3	7 999	0.1	11 389	142.4
Pa përkatësi	626 213	10.8	375 027	6.7	251 186	67.0
Pa përgjigje	185 692	3.2	62 739	1.1	122 953	196.0
Të huajt	1 495 525	100.0	1 245 432	100.0	250 093	20.1
Kishat dhe bashkësitë protestane	94 242	6.3	97 893	7.9	- 3 651	-3.7
Kisha e reformuar evangjeliste	75 303	5.0	75 615	6.1	- 312	-0.4
Kishat e lira evangj. dhe bashk. tjera protestane	18 939	1.3	22 278	1.8	- 3 339	-15.0
Kisha romak-katolike	663 375	44.4	737 708	59.2	- 74 333	-10.1
Kisha krist-katolike	521	0.0	392	0.0	129	32.9
Kishat krist-ortodokse	102 915	6.9	62 883	5.0	40 032	63.7
Bashk. tjera krishtere	4 914	0.3	1 399	0.1	3 515	251.3
Bashk. e besimit çifut	3 795	0.3	4 439	0.4	- 644	-14.5
Bashkësitë islame	274 326	18.3	144 482	11.6	129 844	89.9
Kishat dhe bashk. tjera	37 738	2.5	21 176	1.7	16 562	78.2
Pa përkatë.	183 625	12.3	135 900	10.9	47 725	35.1
Pa përgji.	130 074	8.7	39 160	3.1	90 914	232.2

**Tabela 3 : Popullsia e kantoneve sipas fesë,
viti 2000 (numri absolut)**

	Zvicra	ZH	BE	LU	UR	SZ	OW	NW	GL
Gjithsejt	7 288 010	1 247 906	957 197	350 504	34 777	128 704	32 427	37 235	38 183
Kish. e bashk. prot.	2 569 124	532 183	642 297	42 926	2 074	16 401	2 492	4 431	16 786
Kish. e reform. evan	2 408 049	497 986	607 358	39 426	1 809	15 140	2 255	4 024	16 058
Kish. e lira eva. dhe bashk. tjer. protest.	161 075	34 197	34 939	3 500	265	1 261	237	407	728
Kish. rom-katolike	3 047 887	380 440	153 357	248 545	29 846	92 868	25 992	28 132	14 246
Kisha krist-katolike	13 312	1 435	1 064	471	22	46	14	17	11
Kish. krist-ortodok.	131 851	29 592	9 153	7 801	525	2 758	464	418	873
Bashk. tjera krisht.	14 385	2 503	1 355	564	35	136	23	68	22
Bash. e besim. çifut	17 914	6 461	807	399	7	51	5	13	7
Bashkësitë islame	310 807	66 520	28 377	13 227	683	5 598	985	812	2 480
Kish. dhe bashk. tje	57 126	13 358	9 566	2 883	112	763	131	127	374
Shoqatat budiste	21 305	5 878	2 662	875	44	272	41	27	202
Shoqatat hinduiste	27 839	6 024	5 991	1 715	46	429	82	70	154
Kish. & bash. tjera	7 982	1 456	913	293	22	62	8	30	18
Pa përkatë.	809 838	165 324	74 162	20 681	818	6 331	1 212	2 162	2 479
Pa përgji.	315 766	50 090	37 059	13 007	655	3 752	1 109	1 055	905

	ZG	FR	SO	BS	BL	SH	AR	AI	SG
Gjithsejt	100 052	241 706	244 341	188 079	259 374	73 392	53 504	14 618	452 837
Kish. e bashk. prot.	17 590	36 819	67 292	51 103	111 097	37 025	27 495	1 449	127 929
Kish. e reform. evan	16 377	34 401	72 427	47 107	104 881	34 250	25 675	1 343	119 439
Kish. e lira eva. dhe bashk. tjer. protest.	1213	2418	3865	3996	6216	2775	1720	106	8490
Kisha rom-katolike	61 873	170 069	106 263	46 802	83 034	17 790	16 307	11 888	236 733
Kisha krist-katolike	64	162	1 876	519	1 088	83	45	2	330
Kish. krist-ortodok.	2 620	1 961	3 561	4 783	3 336	1 712	1 568	215	12 709
Bashk. tjera krisht.	216	265	654	657	854	137	131	21	700
Bash. e besim. çifut	148	138	91	1 421	318	23	41	4	231
Bashkësitë islame	4 248	7 389	13 165	12 643	11 053	4 254	1 528	503	27 747
Kish. dhe bashk. tje	972	901	2 060	2 316	2 279	486	179	23	3 286
Shoqatat budiste	189	481	722	800	701	147	101	9	1 501
Shoqatat hinduiste	705	241	1 125	995	1 305	289	43	7	1 504
Kish. & bash. tjera	78	179	213	521	273	50	35	7	281
Pa përkatë.	8 159	14 500	33 244	58 334	38 167	9 471	4 482	395	28 786
Pa përgji.	4 162	9 502	7 135	9 501	8 148	2 411	1 728	118	14 386

	GR	AG	TG	TI	VD	VS	NE	GE	JU
Gjithsejt	187 058	547 493	228 875	306 846	640 657	272 399	167 949	413 673	68 224
Kish. e bashk. prot.	76 252	203 949	103 095	21 121	256 507	17 186	63 974	72 138	8 513
Kish. e reform. evan	74 031	189 606	96 060	17 730	242 272	15 433	59 000	66 695	7 266
Kish. e lira eva. dhe bashk. tjer. protest.	2 221	14 343	7 035	3 991	14 235	1 753	4 974	5 443	1 247
Kish. rom-katolike	87 245	219 800	81 541	233 023	215 401	221 146	51 257	163 197	51 092
Kisha krist-katolike	111	3 418	126	562	491	131	559	610	55
Kish. krist-ortodo.	2 929	11 523	3 924	7 236	10 560	3 092	1 102	7 166	270
Bashk. tjera krisht.	159	894	807	241	2 061	226	224	1 393	39
Bash. e besim. çifut	85	342	88	383	2 062	145	226	4 356	22
Bashkësitë islame	3 913	30 072	13 584	5 747	24 757	7 394	5 056	17 762	1 310
Kish. e bashk. tjera	1 047	4 047	1 244	1 009	4 979	813	779	3 200	192
Shoqatat budiste	247	1 463	624	432	1 677	378	328	1 430	74
Shoqatat hinduiste	686	2 089	486	440	2 007	205	221	921	59
Kish. & bash. tjera	114	495	134	137	1 295	230	230	849	59
Pa përkatë.	9 448	57 573	16 457	23 032	89 405	10 750	36 582	93 634	4 250
Pa përgji.	5 869	15 875	8 009	14 492	34 434	11 516	8 150	50 217	2 481

**Tabela 4: Popullsia e qyteteve të mëdha sipas fesë,
2000 (numri absolut)**

	Zür	Gjen	Bas	Ber	Loz	Winte	St. Gal	Luz
Gjithsejt	363 273	177 964	166 558	128 634	124 914	90 483	726 226	59 496
Kish. e bashk. prot.	116 630	26 020	42 045	63 105	36 084	40 135	20 961	9 227
Kish. e reform. eva	110 008	24 105	39 180	60 455	33 993	37 170	19 578	8 673
Kish. e lira eva. dhe bashk. tjer. protest.	6 622	1 915	2 865	2 650	2 091	2 965	1 383	554
Kish. rom-katolike	120 853	66 491	41 916	31 510	47 225	25 769	31 978	35 682
Kisha krist-katolike	562	220	459	229	65	83	112	140
Kish. krist-ortodok.	12 490	3 959	4 567	1 874	2 698	2 300	3 253	1 744
Bashk. tjera krisht.	762	507	599	231	255	168	119	95
Bash. e besim. çifut	4 903	2 601	1 325	324	849	81	133	196
Bashkësitë islame	20 888	8 698	12 368	4 907	7 501	6 612	4 856	1 824
Kish. e bashk. tjera	6 097	1 604	2 178	2 236	1 567	801	837	1 073
Shoqatat budiste	1 873	707	746	629	452	451	403	305
Shoqatat hinduiste	3 647	474	947	1 430	772	271	365	690
Ki. e bash. e mbetu.	577	423	485	177	343	79	69	78
Pa përkatë.	61 153	41 289	52 321	16 363	21 080	10 214	7 221	6 310
Pa përgji.	18 935	26 575	8 780	7 855	7 590	4 320	3 156	3 205

	Biel	Thun	Köniz	La Chaux	Freib	Schaff	Chur	Neuen
Gjithsejt	48 655	40 377	37 782	37 016	35 547	33 628	32 989	32 914
Kish. e bashk. prot.	20 579	28 120	23 076	11 425	3 082	14 502	12 710	10 296
Kish. e reform. eva	19 191	26 334	21 948	10 258	2 763	13 499	12 199	9 443
Kish. e lira eva. dhe bashk. tjer. protest.	1 388	1 786	1 128	1 167	319	1 003	511	853
Kisha rom-katolike	14 241	5 852	7 426	11 320	24 614	9 267	14 713	10 809
Kisha krist-katolike	87	37	42	300	13	48	15	80
Kish. krist-ortodok.	613	441	370	205	443	814	589	374
Bashk. tjera krisht.	94	37	80	31	30	61	21	50
Bash. e besim. çifut	61	17	45	129	62	18	13	58
Bashkësitë islame	3 156	1 365	980	1 369	1 676	2 450	917	1 723
Kish. e bashk. tjera	632	497	528	218	275	345	424	258
Shoqatat budiste	329	115	154	90	161	78	56	99
Shoqatat hinduiste	235	347	327	83	71	245	350	100
Ki. e bash. e mbet.	68	35	47	45	43	22	18	59
Pa përkatë.	6 012	2 765	3 661	10 059	2 843	4 907	1 998	7 549
Pa përgji.	3 180	1 246	1 574	1 960	2 509	1 216	1 589	1 717

Tabela 5: Kishat e lira evangjeliste dhe bashkësitë e tjera protestane, viti 2000, (numri absolut)

Kishat e lira evangjeliste dhe bashkësitë e tjera protestane	161 075
Kisha evangjeliste-metodiste	8 411
Bashkësitë Neopietiste dhe evangjelicale	31 780
Bashkësitë e lira evangjeliste FEG/EEL	14 045
Bashkësia-Krishona	9 039
Bashkësitë e lira misionare VFMG/FMG	3 876
Veprat e Bashkësisë evangjeliste EGW	1 055
Të tjerat	3 765
Bashkësitë Pfingst	20 062
Bashkësitë Pfingst (e rrëshajave)/ Pfingstmission Schweiz	9 741
Lëvizja Plus / Bashkësia e Krishterimit të hershëm	2 850
Bashkësia e lirë krishtere FCG	2 204
Eglise évangélique du Réveil EER	1 484
Të tjerat	3 783
Kishat Neoapostolike	27 781
Dëshmitarët e Jehovahs	20 330
Kishat dhe bashkësitë tjera protestane	52 711
Alttäufer (Pagëzorët e vjetër), Mennonitët MEN	2 725
Neutäufer (Pagëzorët e rinj), Mbështetësit e pagëzimit evangj. ETG	3 019
Kishat e lira me prejardhje baptiste	3 764
Heilsarmee (Armata e shpëtimit)	3 793
Klubi vëllazëror i evangjelistëve EBV / AEF	4 389
Adventistët e Ditës së Shtatë	2 809
Kisha Jezu Krishti e shenjtorëve të ditës së fundit (Mormonët)	3 436
Të tjerat	28 776

Tabela 6: "Grupet e reja fetare", viti 2000 (numri absolut)

"Grupet e reja fetare"	514 169
Kishat krishtere ortodokse	131 851
Bashkësitë tjera krishtere	14 385
Kishat anglikane	6 224
Shoqata St. Michael Dozwil	1 579
Bashkësia krishtere Antroposofi	2 520
Të tjerat	4 062
Bashkësitë Islame	310 807
Shoqatat Budiste	21 305
Shoqatat Hinduiste	27 839
Kishat dhe Bashkësitë e tjera fetare	7 982

Rreth disa autorëve:

1. Tariq Ramadan: Nip i të ndjerit Hasan el-Benna, dhe djali i të ndjerit jurist Said Ramadan, Tariq Ramadan është lindur në Zvicër në vitin 1962. Ligjeron filozofinë në Kolegjin e Gjenevës dhe Studimet Islame në Universitetin e Fribourgut (Zvicër). Nëpërmjet shkrimeve dhe ligjëratave të shumta të tij dukshëm ka kontribuar në debatet lidhur me çështjet e Islamit në Perëndim dhe në botën bashkëkohore. Ai aktivisht është i angazhuar si ekspert i përtërirjes islame, i identitetit dhe i sfidave të muslimanëve që jetojnë si pakicë. Është autor dhe koautor i shumë librave dhe artikujve, ndër të cilët: *Les musulmans dans la laïcité, responsabilités et droits des musulmans dans les sociétés occidentales*, Tawhid, Lyon, 1994, bot. i dytë 1998; *Islam, le face à face des civilisations, Quel projet pour quelle modernité?*, Les deux Rives, Lyon, 1995, bot. i dytë 1998; *Aux sources du renouveau musulman, Un siècle de réformisme islamique*, Bayard-Centurion, Paris, shtator 1998; *Peut-on vivre avec l'Islam?*, bisedë me Jacques Neiryck, Favre, Lausanne, mars 1999; *De la souffrance: Etudes Nietzscheéne et Islamique*, 1998; *Muslims in France: The Way Towards Coexistence*, The Islamic Foundation, Leicester, UK, 1999; *Péril islamiste?*, drejtuar nga Alain Gresh, Complexe, Brussels, 1995; *La tolérance ou la liberté? Les leçons de Voltaire et de Condorcet*, drejtuar nga Claude-Jean Lenoir, Complexe, Brussels, 1997; *Islam: Modernism and the West*, edit. Gema Martin Munoz, I.B.Tauris, Londër, janar 1999; *To Be a European Muslim, A Study of Islamic Sources in the European Context*, The Islamic Foundation, Leicester, UK, 1999; *Western Muslims and the Future of Islam*, Oxford Univ. Press, 2003.

2. Hamit Duran: është lindur në vitin 1965 në Zvicër dhe është rritur këtu. Me origjinë kombëtare turke, Durani ka kryer studimet e Elektroteknikës pranë ETH në Zürich, ku edhe doktoron (Dr. sc.techn.). Është i martuar dhe baba i 3 fëmijëve. Praktikues i Islamit dhe me vite të tëra aktiv në organizata të ndryshme islame, Durani është botues i revistës "Die Barmherzigkeit" ("Mëshira"), dhe përkujdesës i web-faqes: www.barmherzigkeit.ch.

3. Francis Piccand: në vitin 1983 magjistrin në gazetari, më 1984 në antropologjinë sociale pranë Universitetit të Fribourgut (Zvicër), kurse në vitin 1990 doktoron në shkencat politike (Marrëdhëniet Ndërkombëtare) pranë Institutit të Studimeve Ndërkombëtare në Gjenevë. Në vitin 1984-1985 punon pranë Komitetit të Kryqit të Kuq Ndërkombëtar-Gjenevë, në vitet 1989-1990 punon si hulumtues pranë Fondit të Kërkimeve Shkencore-Bern, në vitet 1988-1997 punon si bashkëpunëtor shkencor pranë Zyrës Federale Zvicerane për Refugjatë, në vitet 1997-1998 e gjejmë si këshilltar pranë Qendrës për Çështje Politike në Ottawa-Kanada dhe përfundimisht prej vitit 1999 e këndej punon si analist politik në Qendrën për Planifikim Politik pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme të Zvicrës, ku i ndjek zhvillimet ndërkombëtare në Lindjen e Mesme dhe në Afrikën Veriore, përgatit raporte për ministrin e Punëve të Jashtme, kujdeset për zhvillimin prospektiv të politikës zvicerane ndaj Lindjes së Mesme dhe Afrikës Veriore. Në fokus të interesimit të tij kërkimor gjejmë: qëndrimet e politikbërësve, rrjedhat e migrimit, presionet demografike, konfliktet etnike dhe fetare, Islami politik, siguria globale etj.

Deri më tani ka botuar: *The Syrian Policy in the Middle East: the Assad Doctrine*, bot. The Graduate Institute of International Studies, Gjenevë, 1993, *From Tribe To Nation in Africa*, punim magjistrature në Antropologjinë Sociale, Universiteti Fribourg, 1984; *The Gulf Crisis*, artikull i shkruar për një Konferencë të organizuar nga Shoqata "Zvicra / Lindja e Mesme dhe Kultura Islame", Universiteti i Gjenevës, janar 1991; *The Political Islam in Arab Countries*, artikull i shkruar për një Konferencë me qeveritarët zviceranë, Gjenevë, korrik, 1996; *The*

Peace Process: Where to?, artikull i shkruar për një ekspozitë me rastin e Konferencës Vjetore të Ambasadorëve, Bern, gusht, 2000; *Strategy for a Swiss Foreign Policy in the South and East of the Mediterranean Sea*, artikull i shkruar për Ministrinë e Punëve të Jashtme të Zvicrës, Bern, shkurt, 2001; *Al Qaida and the European Networks of the Radical Islam*, raport privat për autoritetet zvicerane, mars, 2002 dhe *The Islamic Fundamentalism after September 11 th*, artikull informues për Qeverinë Zvicerane, prill 2002.

4. Amira Hafner al-Jabaji: e lindur në Bern në vitin 1971, Amira është vajzë e një irakiani dhe një gjermaneje. Ka kryer Studimet Islame dhe gazetarinë në Universitetin e Bernit. Për momentin punon si gazetare dhe më se dhjetë vjet është anëtare e *Gemeinschaft Christen und Muslime in der Schweiz* (Shoqata Krishtero-Muslimane në Zvicër). Është e martuar dhe nënë e dy fëmijëve.